

KOMISIONI EUROPIAN

Bruksel, 12.10.2011
SEC (2011) 1205

DOKUMENT PUNE I STAFIT TË KOMISIONIT

PROGRES RAPORTI 2011 PËR SHQIPËRINË

që shoqëron

**KOMUNIKATËN E KOMISIONIT PËR PARLAMENTIN EUROPIAN
DHE KËSHILLIN**

Strategjia e Zgjerimit dhe Sfidat Kryesore 2011-2012

{COM(2011)666}

PASQYRA E LËNDËS

1.	HYRJE.....	5
1.1.	Parathënie.....	5
1.2.	Konteksti	5
1.3.	Marrëdhëniet ndërmjet BE-së dhe Shqipërisë	6
2.	KRITERI POLITIK.....	7
2.1.	Demokracia dhe shteti i së drejtës.....	7
2.2.	Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve	17
2.3.	Çështjet rajonale dhe detyrimet ndërkombëtare.....	25
3.	KRITERI EKONOMIK.....	26
3.1.	Ekzistenca e ekonomisë së tregut funksionale	27
3.2.	Aftësia për të përballuar presionet e konkurrencës dhe forcat e tregut brenda BE-së ...	32
4.	AFTËSIA PER TE MARRË PËRSIPËR DETYRIMET E ANËTARËSIMIT.....	34
4.1.	Kapitulli 1: Lëvizja e lirë e mallrave	34
4.2.	Kapitulli 2: Liria e lëvizjes së punëtorëve	36
4.3.	Kapitulli 3: E drejta e vendosjes dhe liria e ofrimit të shërbimeve	36
4.4.	Kapitulli 4: Lëvizja e lirë e kapitalit.....	37
4.5.	Kapitulli 5: Prokurimi publik.....	39
4.6.	Kapitulli 6: E drejta e shoqërive tregtare	39
4.7.	Kapitulli 7: Legjislacioni për pronësinë intelektuale	40
4.8.	Kapitulli 8: Politika e konkurrencës.....	41
4.9.	Kapitulli 9: Shërbimet financiare.....	42
4.10.	Kapitulli 10: Shoqëria e informacionit dhe media	44
4.11.	Kapitulli 11: Bujqësia dhe zhvillimi rural	45
4.12.	Kapitulli 12: Politika e sigurisë ushqimore, veterinare dhe fitosanitare.....	46
4.13.	Kapitulli 13: Peshkimi	48
4.14.	Kapitulli 14: Politikat e transportit.....	49

4.15.	Kapitulli 15: Energjia	51
4.16.	Kapitulli 16: Tatimet.....	52
4.17.	Kapitulli 17: Politika ekonomike dhe monetare.....	53
4.18.	Kapitulli 18: Statistikat	54
4.19.	Kapitulli 19: Politika sociale dhe Punësimi.....	55
4.20.	Kapitulli 20: Ndërmarrjet dhe politika industriale	57
4.21.	Kapitulli 21 : Rrjetet transeuropiane.....	58
4.22.	Kapitulli 22: Politikat rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore.....	59
4.23.	Kapitulli 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore	60
4.24.	Kapitulli 24: Drejtësia, liria dhe siguria	65
4.25.	Kapitulli 25: Shkenca dhe kërkimi	69
4.26.	Kapitulli 26: Arsimi dhe kultura.....	70
4.27.	Kapitulli 27: Mjedisi.....	71
4.28.	Kapitulli 28: Mbrojtja e konsumatorit dhe e shëndetit	73
4.29.	Kapitulli 29: Bashkimi doganor	75
4.30.	Kapitulli 30: Marrëdhëniet e jashtme	77
4.31.	Kapitulli 31: Politika e jashtme, e sigurisë dhe e mbrojtjes	77
4.32.	Kapitulli 32: Kontrolli financiar.....	78
4.33.	Kapitulli 33: Dispozitat financiare dhe buxhetore	79
	Shtojca Statistike	81

1. HYRJE

1.1. Parathënie

Që në mars 2002, Komisioni i ka raportuar rregullisht Këshillit dhe Parlamentit për progresin e bërë nga vendet e rajonit të Ballkanit perëndimor. Ky është i pari raport për progresin e Shqipërisë pas publikimit të Opinionit të Komisionit për aplikimin e Shqipërisë për anëtarësim në BE, i nxjerrë në nëntor 2010.

Ky raport për progresin e bërë nga Shqipëria në përgatitjet për anëtarësim në BE:

- përshkruan shkurt marrëdhëniet ndërmjet Shqipërisë dhe BE-së;
- analizon gjendjen në Shqipëri për sa i përket kriterit politik për anëtarësim;
- analizon gjendjen në Shqipëri mbi bazën e kriterit ekonomik për anëtarësim;
- shqyrton zhvillimet për sa i përket aftësisë së Shqipërisë për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit, domethënë *acquis* e shprehur në Traktate, legjislacionin dytësor dhe politikatat e Bashkimit European.

Ky raport mbulon periudhën nga tetori 2010 deri në shtator 2011. Progresi matet mbi bazën e vendimeve të marra, legjislacionit të miratuar dhe masave të zbatuara. Si rregull, ligjet apo masat që janë në fazat e përgatitjes ose që presin miratimin e parlamentit, nuk merren parasysh. Kjo përjasje garanton trajtim të barabartë në të gjitha raportet dhe mundëson vlerësim objektiv.

Raporti bazohet në informacionet e mbledhura dhe të analizuar nga Komisioni. Janë përdorur shumë burime, përfshi kontributet e qeverisë së Shqipërisë, të Shteteve anëtare të BE-së, raportet¹ e Parlamentit Evropian dhe informacionet e organizatave të ndryshme ndërkombëtare dhe joqeveritare.

Bazuar në analizën teknike që përmban ky raport, Komisioni ka përpiluar dy përfundime të detajuara për Shqipërinë në komunikatën e zgjerimit².

1.2. Konteksti

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit ndërmjet BE-së dhe Shqipërisë u nënshkrua në qershor 2006 dhe hyri në fuqi në prill 2009.

Më 28 prill 2009, Shqipëria dorëzoi aplikimin për anëtarësim në BE. Me kërkesë të Këshillit, Komisioni dorëzoi Opinionin për aplikimin e Shqipërisë në nëntor 2010. Në dhjetor 2010, Këshilloi miratoi rekomandimet e Opinionit të Komisionit. Në këto përfundime, Këshilli vëren se hapja e negociatave të anëtarësimit do të shqyrtohet nga Këshilli European, me praktikën e vendosur, pasi Komisioni të vlerësojë se Shqipëria ka realizuar kriteret e anëtarësimit në masën e duhur dhe se ka plotësuar prioritetet³ kyçe që parashtron Opinioni i Komisionit. Këshilli e ftoi Komisionin që raportin e progresit 2011 ta fokusojë në zbatimin e këtyre prioriteteve kyçe.

¹ Raportues për Shqipërinë është z. Nikolaos Chountis.

² Strategjia e Zgjerimit dhe Sfidat Kryesore 2011-2012. (COM (2011) 666.

³ Prioritet kyç përfshijnë këto fusha: funksionimi i duhur i parlamentit; miratimi i ligjeve me shumicë të cilësuar; procedurat e emërimit dhe emërimit në institucione kyçe; reforma zgjedhore; mbajtja e zgjedhjeve; reforma në

1.3. Marrëdhëniet ndërmjet BE-së dhe Shqipërisë

Shqipëria merr pjesë në **Procesin e Stabilizim-Asociimit**.

Në tërësi, Shqipëria ka vazhduar të zbatojë mirë detyrimet e saj në kuadrin e **Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA)**. Shqipëria ka marrë pjesë në dialogun e rregullt politik dhe ekonomik me BE-në përmes strukturave të MSA-së dhe ka kontribuar në funksionimin e shëndoshë të institucioneve të përbashkëta. Mbledhjet e Komitetit dhe Këshillit të Stabilizim-Asociimit u mbajtën përkatësisht në prill dhe korrik 2011. Gjatë periudhës së raportimit u zhvilluan mbledhjet të gjithë nënkomiteve. Për më tepër, dialogu ekonomik shumëpalësh ndërmjet Komisionit, Shteteve anëtare të BE-së dhe vendeve candidate potenciale në kontekstin e mbikëqyrjes fiskale të para-anëtarësimit u zhvillua në një takim ekspertësh në maj 2011.

Liberalizimi i vizave për qytetarët shqiptarë u akordua nga Parlamenti Europian dhe Këshilli që më 15 dhjetor 2010. Liberalizimi vlen për zotëruesit e personave biometrike që udhëtojnë në zonën Schengen. Ky vendim u bazua në përmbushjen e kushteve specifike të udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave. Regjimi pa vizave është zbatuar mirë deri tani. Mekanizmi për monitorimin pas liberalizimit të vizave u krijua për të garantuar zbatim të vazhdueshëm të angazhimeve, duke parë numrin në rritje të kërkesave për azil nga rajoni. Në qershor 2011, Komisioni i paraqiti raportin e parë monitorues Parlamentit Europian dhe Këshillit. Marrëveshja e ripranimit ndërmjet Bashkimit dhe Europian dhe Shqipërisë është në fuqi që në vitin 2006.

Asistenca financiare e para-anëtarësimit i jepet Shqipërisë në kuadrin e Instrumentit për Asistencën e Para-anëtarësimit (IPA). Përmes Programeve Kombëtare IPA, BE-ja ka akorduar gjithsej 83.2 milion euro në 2010 dhe 82.08 milion euro për 2011. Në vitin 2010 u bë progres me përgatitjen e Dokumentit të Planifikimit Indikativ Shumëvjeçar (MIPD) 2011-2-13, që ndjek një përfaqje sektoriale me fokus Drejtësia dhe Çështjet e Brendshme, Reforma në Administratën Publike, Transporti, Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike, Zhvillimi Social, Bujqësia dhe Zhvillimi Rural. MIPD 2011-2013 për Shqipërinë u miratua në korrik 2011. Asistenca IPA zbatohet nga Delegacioni i BE-së në Tiranë.

Shqipëria vazhdon të marrë pjesë në tre programe të **bashkëpunimit ndërkufitar** në “kufijtë e brendshëm” të Ballkanit Perëndimor (Mali i Zi, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Kosova⁴); në një program dypalësh bashkëpunimi ndërkufitar me një Shtet anëtar të BE-së (Greqinë); dhe në tre programe shumëpalëshe (përfshi Shtete anëtare të BE-së), d.m.th. në Programet Transnacionale Europiane ERDF, Hapësira e Europës Juglindore dhe Hapësira Mesdhetare, si edhe në programin rajonal Adriatik.

administratën publike, shteti i së drejtës dhe reforma në drejtësi; lufta kundër korrupsionit; lufta kundër krimit të organizuar adresimi i çështjeve të pronësisë; forcimi i të drejtave të njeriut dhe zbatimi i politika anti-diskriminim; përmirësimi i trajtimit të të ndaluarve dhe zbatimi i rekomandimeve të Avokatit të Popullit. Për tekstin e plotë të prioriteteve kyçe, mund të shihni Vendimin (2010)680.

⁴ në kuadrin e Rezolutës 1244/1999 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

Projektet IPA në mbështetje të **shoqërisë civile** për periudhën 2009-2011 fokusohen në organizatat e shoqërisë civile që merren me luftën kundër korrupsionit, krimin të organizuar dhe trafikimit të personave, me mbrojtjen e mjedisit dhe arsimin, si edhe me zbutjen e varfërisë. Komisioni ka krijuar Instrumentin e Shoqërisë Civile që të arrijë më me efikasitet te organizatat vendore komunitare, të shënjestrojë më të mirë nevojat në secilin vend dhe të japë financime afatgjata të qëndrueshme për OJF-të.

Shqipëria vazhdon të marrë pjesë në tre Programe të BE-së: në Programin e Shtatë (FP7) për kërkimin shkencor dhe zhvillimin teknologjik (2007-2013), në Programin e veçantë për Sipërmarrjen dhe Novacionin (EIP) të Programit Kuadër për Konkurrueshmërinë dhe Novacionin (2007-2013) dhe në Programin Europa për Qytetarët. Fondet e IPA-s përdoren për të përballuar pjesërisht koston e pjesëmarrjes në të tre këto programe.

2. KRITERI POLITIK

Kjo pjesë shqyrton përparimin që ka bërë Shqipëria në përmbushjen e kriterit politik të Kopenhagenit që kërkon stabilitetin e institucioneve që garantojnë demokracinë, shtetin e së drejtës, të drejtat e njeriut si dhe respektimin e mbrojtjen e minoriteteve.

Këtu monitorohet gjithashtu zbatimi i detyrimeve ndërkombëtare, bashkëpunimi rajonal dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë me vendet e zgjerimit dhe me Shtetet anëtare.

Kjo pjesë analizon kryesisht përmbushjen e prioriteteve kyçe të Opinionit të vitit 2010.

2.1. Demokracia dhe shteti i së drejtës

Skena politike në Shqipëri është dominuar nga vazhdimësia e ngërçit politik dhe bojkoti i pjesshëm i parlamentit nga opozita. Ky ngërç politik ka filluar që nga zgjedhjet e përgjithshme të qershorit 2009. Rezultati këtyre zgjedhjeve që sipas OSBE/ODIHR-it përmbushën pjesën më të madhe të standardeve ndërkombëtare, megjithëse kishte mangësi, u kontestua nga Partia Socialiste. Incidentet e dhunshme të 21 janarit 2011, që çuan në vdekjen e katër demonstruesve, amplifikuan klimën e mosbesimit jo vetëm mes forcave politike, por edhe ndaj institucioneve shtetërore. Zgjedhjet vendore të 8 majit, për shkak të numërimit të debatueshëm të votave të hedhura në kutitë e gabuara dhe rezultatit të kontestuar për Tiranën, thelluan edhe më tej polarizimin mes shumicës në pushtet dhe opozitës. Të gjitha këto e larguan vëmendjen nga reformat shumë të nevojshme për integrimin në BE. Në këto kushte, qeveria bëri disa përpjekje për të çuar përpara agjendën programin e integritit evropian dhe veçanërisht për të përgatitur një plan veprimi që adreson rekomandimet e Opinionit të Komisionit të vitit 2010. Këto përpjekje u pasqyruan në bashkëpunimin e mirë mes shumicës në pushtet dhe opozitës për Planin e Veprimit në Komisionin Parlamentar për Integrimin Evropian dhe në punën e përbashkët për të arritur marrëveshje për reformat e nevojshme. Përpjekje janë bërë edhe për krijimin e grupeve të punës për reformën zgjedhore, por këto ngelën në vend.

Parlamenti

Përparimi në organizimin e punimeve të parlamentit ka qenë modest. Këtu përfshihen një numër i kufizuar ndryshimesh në rregulloren e Kuvendit, si zhvendosja e debatit të lirë në fund të seancës parlamentare, përbëjnë përmirësim krahasuar me praktikën e mëparshme. Përmirësimet e tjera përfshijnë ndryshimet e bëra me urdhër të Kryetares së Kuvendit në janar 2011, si ato për kryetarët e komisioneve të përhershme parlamentare që të përcaktojnë agjendën e Kuvendit, si dhe transkriptimin e plotë dhe publikimin e procesverbaleve jo vetëm të seancave parlamentare, por edhe të të gjitha mbledhjeve të komisioneve parlamentare.

Në mars 2011, me nismën e një shumice të gjerë deputetësh, Kuvendi ngriti një komision hetimor për menaxhimin dhe veprimtarinë e shërbimeve dhe organeve drejtuese të Kuvendit gjatë periudhës nga shtatori 2005 deri në dhjetor 2010. Ky komision zhvilloi një mbledhje para zgjedhjeve vendore të muajit maj.

Megjithatë, punimet e parlamentit vazhduan të pengohen seriozisht nga ngërçi politik mes shumicës në pushtet dhe opozitës, mungesa e dialogut politik konstruktiv dhe retorika e intensifikuar konfrontuese e ndezur nga ngjarjet e 21 janarit dhe procesi dhe rezultati i debatueshëm i zgjedhjeve për bashkinë e Tiranës. Opozita i dha fund bojkotit të gjatë parlamentar më 5 shtator.

Për shkak të ngërçit politik, përparimi në fushën e shqyrtimit legjislativ dhe funksionit mbikëqyrës të ekzekutivit mbetet i pamjaftueshëm. Disa nga ndryshimet e rregullores, të propozuara dhe të miratuara me votat e shumicës në pushtet, përfshijnë masa më të ashpra disiplinore ndaj deputetëve. Komisioni hetimor për menaxhimin dhe veprimtarinë e shërbimeve dhe organeve drejtuese të Kuvendit nuk është mandatuar të kryejë një analizë të rregullores së Kuvendit.

Disa përpjekje serioze janë bërë për vendosjen e bashkëpunimit ndërpartiak në Komisionin për Integrimin Europian të kryesuar nga opozita, sidomos për punën mbi planin e veprimit në vijim të Opinionit. Ministri dhe zëvendësministri i Integritimit Europian kanë raportuar disa herë para Komisionit për çështjet e integritimit europian, gjë që nuk ka ndodhur më përpara. Ende nuk është arritur marrëveshja për hapat dhe masat kryesore të reformës për adresimin e prioritetëve kyç të Opinionit që ishin përfshirë në planin e veprimit.

Në tërësi, ende nuk është arritur funksionimi i duhur i parlamentit bazuar në dialog politik konstruktiv dhe të qëndrueshëm mes të gjitha palëve, që është prioritet kyç i Opinionit.

Gjatë periudhës së raportimit, parlamenti ka miratuar mbi njëqind ligje. Megjithatë, ka mbetur pezull miratimi i disa ligjeve të rëndësishme që kërkojnë tre të pestat e votave, që është prioritet kyç i Opinionit dhe ku nevojitet konsensusi mes shumicës dhe opozitës. Bashkëpunimi i kufizuar apo i ndërprerë mes shumicës në pushtet dhe opozitës në komisionet parlamentare, kufizimet e vazhdueshme të aksesit në ekspertizën e specialistëve, megjithëse ka pasur përmirësime në disa raste, si dhe konsultimet e kufizuara me palët e treta duke përfshirë shoqërinë civile, ngrenë pikëpyetje mbi cilësinë e ligjeve të miratuara.

Janë marrë disa masa për të forcuar kapacitetin administrativ të parlamentit, përfshi rekrutimin e punonjësve shtesë. Komisionit të Integritetit iu siguruan këshilltarë shtesë në mars 2011. Masa të mëtejshme janë marrë për të forcuar infrastrukturën parlamentare dhe për të lehtësuar komunikimin, si brenda parlamentit, ashtu edhe me publikun. Instalimi i një rrjeti të cilësisë së lartë dhe transmetimi *online* i seancave plenare si dhe modernizimi i ambienteve të tjera, kanë kontribuar në rritjen e transparencës. Megjithatë, parlamenti ka mungesë kapaciteti administrativ dhe politizimi i emërimeve të cilat pengojnë pavarësinë dhe profesionalizimin e punonjësve, mbeten çështje shqetësuese. Konsultimi me shoqërinë civile gjatë procesit legjislativ mbetet i pamjaftueshëm.

Në qershor 2011, një vendim i Gjykatës Kushtetuese i kërkuar nga shumica në pushtet arriti në përfundimin se kriteret për emërimet në Gjykatën Kushtetuese dhe Gjykatën e Lartë duhet të përcaktohen në bashkëpunim mes presidentit dhe parlamentit. Procesi i dëgjimit dhe i votimit për kandidatët e propozuar nga presidenti, i cili rifilloi pas një periudhe pezullimi, vazhdoi të përshkohet nga politizimi dhe retorika konfrontuese. Parlamenti ende nuk po siguron proces të rregullt dëgjimi dhe votimi për emërimet në Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatën e Lartë, i cili është prioritet kyç i Opinionit.

Asnjë përparim nuk është bërë në ndryshimin e kuadrit legjislativ për zgjedhjet sipas rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it, çka është përparësi kyçe e Opinionit. Në tetor 2010, qeveria ishte nismëtare e një tryeze të rrumbullakët ndërpartiake për të adresuar nevojën për reformë zgjedhore. U ftuan të gjitha partitë të propozonin ndryshime në përputhje me rekomandimet e OSBE/ODIHR-it. Në mars 2011, partitë politike të shumicës në pushtet nënshkruan një marrëveshje politike (pa opozitën) për krijimin e një komisioni parlamentar për reformën zgjedhore pas zgjedhjeve vendore të 8 majit. Ky komision ende nuk është krijuar. Reforma zgjedhore është bllokuar nga ngërçi politik dhe mungesa e dialogut politik mes partive kryesore.

Zgjedhjet e 8 majit për qeverisjen vendore u zhvilluan në një atmosferë politike tepër të polarizuar, që ndikoi në zhvillimin e përgjithshëm të procesit. Sipas vlerësimit përfundimtar të OSBE/ODIHR-it, megjithëse zgjedhjet ishin konkurruese dhe transparente, mbizotëroi mosbesimi mes partive politike që nuk i kanë kryer detyrimet e tyre zgjedhore në mënyrë të përgjegjshme. Kjo klimë ndikoi negativisht në administrimin e zgjedhjeve. Vlerësimi i OSBE-ODIHR-it vuri në dukje gjithashtu se, pavarësisht fushatës zgjedhore konkurruese, disa incidente të dhunshme u shënuan gjatë periudhës së fushatës. Partitë politike nuk e përmbushën kërkesën e kuotës gjinore, çka rezultoi në një nivel të ulët pjesëmarrjeje të grave. Përparim i dukshëm është bërë në përmirësimin e listave të votuesve. Megjithatë, vazhduan problemet lidhur me saktësinë e këtyre listave.

Misioni vëzhgues i OSBE/ODIHR-it vuri në dukje se, ndërsa votimet u zhvilluan relativisht mirë gjatë ditës së zgjedhjeve, probleme domethënëse kishte në rreth 10% të qendrave të votimit. Theksonte po ashtu edhe procesin përgjithësisht të mirë, megjithëse të gjatë, të numërimit. Në veçanti, përcaktimi i rezultatit të zgjedhjeve për kryetarin e bashkisë së Tiranës ishte një proces shumë i diskutueshëm dhe vendimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) u morën në frymë partizane, u mungonte arsyetimi dhe kishin

mospërputhje. Mosmarrëveshjet politike dhe ligjore u vunë re edhe në trajtimin e ankesave nga Kolegji Zgjedhor, veçanërisht për Tiranën.

Në tërësi, me gjithë disa aspekte, si konkurrueshmëria e procesit, përgatitjet teknike transparente, votimi relativisht i qetë në ditën e zgjedhjeve, procesi pozitiv i numërimit, mbulimi mediatik pluralist dhe i shumëllojshëm, zhvillimi i zgjedhjeve që është prioritet kyç i Opinionit përmbushi vetëm pjesërisht standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare. Megjithëse Kodi Zgjedhor mbetet një bazë e mirë ligjore dhe teknike për procesin zgjedhor, reforma zgjedhore është e nevojshme për përparim të mëtejshëm. Në këtë kontekst, roli i partive politike është i rëndësishëm, jo vetëm si aktorët kryesorë në procesin e reformës, por edhe për të siguruar që klima politike të mos ndikojë negativisht në proces dhe në shprehjen e vullnetit të votuesve. Zbatimi i rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it për këto zgjedhje si dhe për ato të 2009-ës duhet të jetë përparësi për institucionet dhe klasën politike shqiptare.

Në tërësi, me gjithë përmirësimet në rregulloren dhe praktikat parlamentare dhe rritjen e kapaciteteve administrative të parlamentit, performanca e parlamentit në funksionet legjislativ dhe mbikëqyrëse, që janë prioritetet kyçe të Opinionit, mbetet e pamjaftueshme. Ngërçi i gjatë politik, i cili u ndez më tej nga ngjarjet e 21 janarit dhe debati mbi zgjedhjet për bashkinë e Tiranës, ka penguar seriozisht si punën e parlamentit ashtu edhe dialogun e qëndrueshëm dhe konstruktiv politik. Ngërçi politik ka penguar gjithashtu arritjen e konsensusit për të mundësuar zbatimin e reformave të BE-së. Bojkoti i pjesshëm i opozitës ka penguar punën e parlamentit. Prandaj, fundi i bojkotit të opozitës dhe kthimi i tyre në parlament me 5 shtator është hap pozitiv drejt normalizimit të dialogut politik. Në parlament duhet nxitur një mjedis politik gjithëpërfshirës dhe i hapur ndaj konsensusit ndërpartiak. Klima e polarizimit dhe mosbesimi mes qeverisë dhe opozitës ka ndikuar edhe tek zgjedhjet vendore të 8 majit; ka fusha ku standardet ndërkombëtare u përmbushën, gjatë zhvillimit të këtyre zgjedhjeve, prioritet kyç i Opinionit, si dhe fusha ku kjo nuk ndodhi. Reforma zgjedhore, prioritet kyç i Opinionit, ka ngecur. Parlamenti ende nuk ka garantuar një seancë dëgjimore të rregullt dhe votim për emërimet në Gjykatën Kushtetuese dhe Gjykatën e Lartë, që është po ashtu prioritet kyç i Opinionit.

Qeveria

Koalicioni qeveritar mes Partisë Demokratike (PD) dhe Lëvizjes Socialiste për Integrim (LSI) vazhdoi gjatë periudhës së raportimit. Në janar 2011, Zëvendësministri dhe Ministri i Ekonomisë, Ilir Meta, dha dorëheqjen. Lulzim Basha, kandidat për bashkinë e Tiranës, dha dorëheqjen nga posti i tij si Ministër i Brendshëm.

Ministria e Integritimit Europian (MIE) ka bërë përpjekje domethënëse në përgatitjen e Planit të Veprimit që adreson prioritetet kyçe të Opinionit, të cilat u koordinuan me ministrinë e linjës dhe institucionet e tjera përkatëse. MIE është konsultuar në mënyrë aktive me të gjithë palët e interesuara dhe i ka raportuar për këtë Komisionit parlamentar për Integrimin Europian. Plani i Veprimit u miratua nga Këshilli i Ministrave në qershor. Ende nuk është miratuar nga parlamenti. Marrëveshja për Planin e Veprimit është tepër e rëndësishme, veçanërisht për reformat që kërkojnë vendime konsensuale.

Janë ndërmarrë hapa për vlerësimin e boshllëkut ligjor për sa i përket përputhjes me *acquis* si dhe për përgatitjen e ndryshimeve në Planin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së 2009-2014 (PKZMSA). Megjithatë, PKZMSA-ja ka disa mangësi, përfshi mungesën e mbulimit të plotë të kapitujve të *acquis*. Aty mungon edhe një vlerësim gjithëpërfshirës i kapaciteteve administrative për zbatimin e *acquis*.

Për të luajtur plotësisht rolin e saj, MIE do të ketë nevojë për burime shtesë për drejtimin dhe menaxhimin e procesit të përafrimit me BE-në, në konsultim të plotë me ministritë e linjës përkatëse. Përdorimi i një sistemi informatik për përmirësimin e procesit të planifikimit, i cili ka qenë gati që në prill 2011, është vonuar në pritje të miratimit të ndryshimeve të rregullores së Këshillit të Ministrave. Ecuria në përgatitjet për harmonizimin e legjislativitetit me *acquis* ka qenë e kufizuar, pjesërisht për shkak të zgjedhjeve vendore të cilat kanë tërhequr një pjesë të konsiderueshme të vëmendjes së politikanëve në nivel qendror.

Ministritë e linjës duhet të përmirësojnë hartimin e akteve ligjore duhet përmirësuar duke forcuar punën përgatitore dhe duke bërë konsultimet e duhura. Duhet të finalizohen rregullat specifike për përmirësimin e transparencës dhe konsultimeve gjatë procesit legjislativ, të cilat Shqipëria është zotuar t'i miratojë. Procesi i konsultimit me shoqërinë civile dhe partnerët e tjerë duhet forcuar më tej.

Koordinimi i politikave duhet zhvilluar më tej, veçanërisht për sa i përket Komitetit të Koordinimit Ndërinstitucional për Integrimin Europian (KKNIE). KKNIE shpesh nuk bën mbledhje me formatin e përcaktuar në rregulloren e qeverisë dhe përgatitja e vendimeve për qeverinë has pengesa. Anëtarët e grupeve ndërinstitucionale të punës emërohen në baza *ad-hoc*, gjë që ndikon në dobësimin e kujtesës institucionale. Disa nga grupet e punës nuk kanë bërë mbledhje që nga muaji tetor i vitit 2010. Pavarësisht nga këto mangësi, KKNIE-ja ka luajtur rol në përcaktimin e planit të veprimit që adreson prioritetet kyçe të Opinionit.

Ka pasur disa zhvillime në legjislativitetin e *qeverisjes vendore*. Në nëntor 2010, parlamenti miratoi ndryshime në Ligjin për Sistemin e Taksave Vendore, duke u dhënë njësisve të qeverisjes vendore mandat për të kompensuar bizneset e vogla për shpenzimet e blerjes dhe instalimit të pajisjeve fiskale. Marrëdhënia gjithnjë e më e vështirë mes qeverisjes qendrore të drejtuar nga PD-ja dhe shumicës së njësisve të qeverisjes vendore drejtuar nga PS-ja ka vazhduar të ndikojë në procesin e reformës së decentralizimit, i cili më parë ka qenë i suksesshëm.

Menaxhimi i taksave të qeverisjes vendore mbetet i dobët. Autoriteteve të qeverisjes vendore u mungon kapaciteti administrativ për të përmirësuar mbledhjen e taksave, për të rritur autonominë fiskale dhe për të përmirësuar performancën e tyre. Disa njësi të qeverisjes vendore nuk arritën të miratojnë buxhetin bashkiak për vitin 2010, situatë kjo që vazhdoi edhe gjatë vitit 2011. Aksesit i njësisve të qeverisjes vendore në hua, siç parashikohet nga ligji për huamarrjen e qeverisjes vendore, vazhdon të mbetet e kufizuar.

Në tërësi, qeveria dhe Komisioni Parlamentar për Integrimin Europian kanë bërë përpjekje të konsiderueshme për të çuar përpara dhe për të koordinuar reformat e integritit në BE dhe në veçanti për përgatitjen e një plan veprimi që adreson rekomandimet e Opinionit të Komisionit

European të vitit 2010. Cilësia e hartimit të legjislacionit dhe konsultimi me palët e treta kërkojnë përmirësime të mëtejshme. Marrëdhënia e vështirë mes qeverisjes qendrore dhe asaj vendore ka ndikuar negativisht në procesin e reformës së decentralizimit.

Administrata Publike

Përparim të kufizuar ka pasur në fushën e reformës së administratës publike, e cila është prioritet kyç i Opinionit. Qeveria ka miratuar një letër politikash që shqyrton një sërë ndryshimesh në Ligjin e ri për Shërbimin Civil. Mbi këtë bazë u përgatitën ndryshimet e Ligjit për Shërbimin Civil. Një letër politikash për Ligjin e ri për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Publike dhe një draft fillestar i këtij ligji u përgatitën dhe iu përcollën grupeve të interesit brenda sektorit publik. Në qershor 2011, si pjesë e reformës së inspektimit, parlamenti miratoi Ligjin për Inspektimin. Në të njëjtin muaj, një vendim i Këshillit të Ministrave përcaktoi standardet dhe metodat për krijimin e organeve publike për sa u përket strukturave dhe organizimit.

Megjithatë, në përgjithësi reforma e administratës publike nuk ka avancuar shumë. Akte të rëndësishme normative që kërkojnë tre të pestat e votave në parlament, si për shembull ligji për procedurat e përgjithshme administrative, ligji për funksionimin e administratës publike dhe ligji për gjykatat administrative, janë ende në pritje të miratohen.

Në pritje të miratimit të ndryshimeve të Ligjit për Shërbimin Civil, shërbimi civil po vuan nga mangësi të rëndësishme, veçanërisht në lidhje me parimin e meritokracisë gjatë procesit të rekrutimit, punësimin me kontrata të përkohshme, rregullat për ngritjen në detyrë, transferimin dhe shkarkimin e punonjësve civilë. Funksionimi i shërbimit civil vazhdon të vuajë nga politizimi, veçanërisht për sa u përket emërimeve. Zbatimi i Urdhrit të Kryeministrit të tetorit 2010 që vendos një kufi maksimal prej 2.5% të punësimeve me kontratë në shërbimin civil, vazhdon të jetë i dobët. Ende duhen dhënë prova për zbatimin e duhur të urdhrit të Kryeministrit.

Sistemi Kompjuterik për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore nuk është ende funksional dhe baza e të dhënave nuk është e plotë.

Kapaciteti i Departamentit të Administratës Publike (DAP) u rrit me katër punonjës dhe përgjithësisht mund të konsiderohet i përshtatshëm. Megjithatë, në kontekstin institucional, DAP-it i mungon autoriteti për të luajtur një rol efikas. Kapaciteti i DAP-it për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave nga ministrinë dhe për të përpiluar raportet përkatëse mbetet i pamjaftueshëm. Të dhënat për rekrutimin e punonjësve të shërbimit civil, që nga miratimi i urdhrit të Kryeministrit në tetor 2010, nuk janë të plota dhe të përditësuara.

Instituti i Trajnimit të Administratës Publike (ITAP) ka hasur vështirësi serioze në zbatimin e aktiviteteve të planifikuara të trajnimit dhe në të njëjtën kohë i është dashur të përballet me reduktime thelbësore të buxhetit operacional. Në qershor, me votat e shumicës në pushtet, parlamenti emëroi anëtarin e pestë të Komisionit të Shërbimit Civil. Ky post ka qenë vakant që nga viti 2009, çka ka sjellë vështirësi në procesin e vendimmarrjes.

Përparim i kufizuar është bërë në llojet e reja të auditimit, si auditimi i certifikimit dhe performancës, të cilat po zhvillohen gradualisht nga institucioni më i lartë i auditimit (KLSH). Megjithatë, raportimi para parlamentit për konstatimet e auditimeve dhe ndjekja e rekomandimeve ende kanë nevojë për përmirësim, në mënyrë që t'i mundësojnë KLSH-së të përmbushë rolin e vet brenda kuadrit të qeverisjes kombëtare.

Nuk ka pasur asnjë përparim në emërimin e *Avokatit të Popullit*, prioritet kyç i Opinionit, i cili ka mbetur pezull që në shkurt 2010. Duke pasur parasysh rëndësinë e këtij institucioni të pavarur, ekziston nevoja për një proces emërimi efikas, transparent dhe jo të politizuar. Megjithatë, institucioni ka treguar se është aktiv dhe reagues në hetimin e çështjeve dhe hartimin e raporteve vjetore *ad-hoc* dhe të raporteve vjetore gjithëpërfshirëse.

Në tërësi, pavarësisht nga disa masa reformash si Vendimi i qershorit 2011 i Këshillit të Ministrave për strukturën dhe organizimin e organeve publike, nuk janë bërë hapa domethënës në reformën e administratës publike, që është prioritet kyç i Opinionit, përfshi ndryshimet e ligjit për shërbimit civil. Miratimi i legjislacionit relevant ka mbetur pezull dhe varet nga kapërcimi i ngërçit politik. Zbatimi i ligjeve ekzistuese dhe akteve administrative mbetet i dobët. Në kontekstin institucional, DAP-i vazhdon të mos ketë autoritetin e duhur për të luajtur plotësisht rolin e vet. Ende nuk është arritur krijimi i një shërbimi civil të pavarur, të bazuar në meritokraci dhe profesionalizëm, të pandikuar nga ndërhyrjet politike. Emërimi i Avokatit të Popullit ende nuk është bërë.

Gjyqësori (shiko edhe Kapitullin 23 – Gjyqësori dhe të drejtat themelore)

Përparimi ka qenë i kufizuar në plotësimin e kuadrit ligjor për reformën në gjyqësor. Në korrik u miratua Strategjia për Reformën në Gjyqësor dhe Plani i Veprimit, në konsultim me një grup të gjerë interesi. Ata formojnë një bazë të mirë për përpjekjet e reformës. Miratimi, por edhe zbatimi i strategjisë dhe planit të veprimit janë prioritete kyçe të Opinionit. Zbatimi sapo ka filluar dhe kërkon sigurimin e burimeve të duhura njerëzore dhe financiare si dhe bashkëpunim të mirë ndër-institucional. Në shkurt 2011 u miratua Ligji i ri për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe aktet e tij nënligjore, që janë në linjë me standardet e BE-së. Përveç kësaj, janë miratuar tashmë aktet nënligjore të ligjit për policinë gjyqësore.

Megjithatë, legjislacioni përkatës si ligji për gjykatat administrative dhe ndryshimet në Kodin Penal, që kërkojnë tre të pestat e votave në parlament, janë ende pezull. Ligje të tjera të rëndësishme që kërkojnë 3/5 e votave në parlament, si ligji për administratën gjyqësore dhe ligji për Konferencën Gjyqësore Kombëtare, ende duhen hartuar dhe paraqitur në parlament.

Nuk ka pasur përparim të mëtjshëm në lidhje me pavarësinë e gjyqësorit. Ka pasur shqetësime për ndërhyrje të papërshtatshme apo pengim të hetimeve të pavarura dhe ndjekjes penale të veprave të mundshme penale pas ngjarjeve të 21 janarit, ku u vranë 4 demonstrues. Procesi i emërimit të gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë dhe Gjykatën Kushtetuese mbetet çështje shqetësuese për shkak të zgjatjes së procesit dhe mbi të gjitha, për shkak të rrezikut të politizimit. Paanshmëria dhe pavarësia e këtyre institucioneve nuk është ende e garantuar plotësisht.

Për sa i përket profesionalizmit në gjyqësor, janë bërë përpjekje për të përafruar punën e Këshillit të Lartë të Drejtësisë me standardet europiane përmes ndryshimeve në sistemin e vlerësimit të gjyqtarëve, përmirësimin e arsytimit të vendimeve për emërimin të marra nga KLD-ja dhe krijimin e një Komisioni për transferimet, ngritjet në detyrë dhe emërimin e gjyqtarëve. Efikasiteti i ndryshimeve të bëra në sistemin e vlerësimit, mbetet për t'u verifikuar në praktikë. Duhet të përcaktohet afati për zbatimin e sistemit të ri të vlerësimit.

Për sa i përket *paanshmërisë*, sistemi i kompjuterizuar i menaxhimit të çështjeve dhe caktimit të rastësishëm të çështjeve të procedurës penale dhe civile, është funksional në pjesën më të madhe të zyrave gjyqësore. Përpjekje të mëtejshme duhen bërë për të pasur një sistem të integruar, uniform dhe të harmonizuar të menaxhimit të çështjeve, që të funksionojë në të gjitha gjykatat, përfshi edhe për mbledhjen e shëndoshë të statistikave. Për gjyqtarët ekziston një kod etike, por zbatimi efikas i tij vazhdon të mbetet një sfidë.

Për sa i përket *llogaridhënies* në organet e gjyqësorit, mbivendosja e kompetencave të inspektimit mes inspektorateve të KLD-së dhe të Ministrisë së Drejtësisë (MD) mbetet ende e pazgjidhur. Në mungesë të rishikimit të ligjit për KLD-në, i cili do të kërkonte shumicë me tre të pestat e votave të parlamentit, Ministria e Drejtësisë dhe KLD-ja kanë miratuar një Memorandum Mirëkuptimi për sqarimin e disa aspekteve të mbivendosjes së sistemeve të inspektimit.

Nuk është bërë përparim në luftën kundër korrupsionit brenda sistemit gjyqësor. Imuniteti i plotë që gëzojnë gjyqtarët është një nga faktorët kryesorë që pengon hetimet për rastet e mundshme të korrupsionit brenda sistemit gjyqësor. Imuniteti i gjyqtarëve duhet të kufizohet apo të hiqet, gjë që kërkon ndryshime kushtetuese. Kushtet jo të mira të punës dhe rrogat relativisht të ulëta të gjyqtarëve, janë faktorë rreziku për korrupsion në sistemin gjyqësor.

Përparim i mëtejshëm nuk është bërë në lidhje me *efikasitetin* e sistemit gjyqësor. Janë vonuar reformat e Gjykatës së Lartë të planifikuara nga Ministria e Drejtësisë që synojnë përmirësimin e efikasitetit të gjykatës dhe reformimin e organizimit të brendshëm.

Kushtet e punës në gjykata janë ende të këqija në përgjithësi dhe seancat shpesh mbahen në zyrat e gjyqtarëve, çka pengon transparencën dhe efikasitetin. Ende nuk ekziston një sistem i shëndoshë dhe adekuat për trajnimin e administratorëve të gjykatave.

Menaxhimi i gjykatave vazhdon të mbetet i dobët për shkak të mungesës së burimeve njerëzore dhe financiare, veçanërisht në gjykatat e rretheve të shkallës së parë. Buxheti vjetor për sistemin gjyqësor është 69 milion euro, i cili përbën 0.7% të prodhimit të përgjithshëm bruto të Shqipërisë. Vazhdon të jetë problematik numri i çështjeve të akumuluar në pritje për t'u shqyrtuar dhe veçanërisht numri i madh i çështjeve më të vjetra se tre vjet. Vonesat e paarsyeshme të çështjeve gjyqësore, të cilat shkaktohen shpesh nga shtyrja e procedurave gjyqësore për shkak të mungesës së avokatëve apo gjyqtarëve, si dhe numri i pajustificueshëm i seancave gjyqësore për çështjet, mbetet ende shqetësim serioz. Dhoma Kombëtare e Avokatisë ka filluar hartimin e një propozimi për reformimin e mekanizmave të masave disiplinore për avokatët. Dobësitë në hartim dhe arsytimet e pamjaftueshme të

vendimeve vazhdojnë të mbeten shqetësim serioz. Procedimi penal në të ashtuquajturën çështja e Gërdecit (shpërthimi që vrau 26 njerëz në vitin 2008) ka përfshirë deri tani 152 seanca. Ekziston rreziku që vonesat e pajustificuara dhe të vazhdueshme në procedime të pengojnë përmbushjen e parimit të gjyqimit të drejtë, siç mishërohet në Kushtetutën e Shqipërisë.

Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore është i dobët, veçanërisht në rastet kur institucionet shtetërore janë palë e paditur. Sistemi i ri i përmbartimit privat ka filluar të funksionojë, por ka ende nevojë për përmirësimin e menaxhimit të çështjeve nga ana e përmbartuesve. Përpjekje të mëtejshme nevojiten për të rritur nivelin e zbatimit.

Ngarkesa e punës së Gjykatës Kushtetuese po rritet, veçanërisht për shkeljen e pretenduar të së drejtës për gjykim të drejtë. Përveç kësaj, gjykatës i mungojnë ambientet dhe pajisjet e nevojshme për funksionim efikas.

Në tërësi, përparim i kufizuar është bërë me reformën në drejtësi, e cila është prioritet kyç i Opinionit. Strategjia për reformën në sistemin e drejtësisë dhe plani i veprimit u miratuan në korrik. Ato vlejnë si një bazë e shëndoshë në përpjekjet për reforma. Zbatimi sapo ka filluar dhe do të ketë nevojë për akordimin e burimeve njerëzore dhe financiare të duhura, si dhe për bashkëpunim të shëndoshë ndër-institucional. Ligje të rëndësishme që kërkojnë tre të pestat e votave në parlament, si ligji për gjykatat administrative, janë ende në pritje të miratimit. Numri i çështjeve të akumuluar në pritje për t'u shqyrtuar në gjykata dhe zgjatja e tepërt e procedurave kërcënojnë efikasitetin e sistemit të drejtësisë. Buxheti për sistemin gjyqësor vazhdon të jetë i pamjaftueshëm. Përqindja e ekzekutimit të vendimeve vazhdon të mbetet i ulët. Asnjë hap nuk është ndërmarrë në luftimin e korrupsionit në sistemin gjyqësor, përfshi kufizimin apo heqjen e imuniteti të gjyqtarëve.

Politika anti-korrupsion (shiko dhe Kapitullin 23 – Gjyqësori dhe të drejtat themelore)

Disa përparime janë bërë në politikat qeveritare në luftën kundër korrupsionit. Në lidhje me përjasjen e politikave strategjike për korrupsionin, në qershor 2011 u miratua një plan veprimi i ri kundër korrupsionit për periudhën 2011-2013, i cili përmban plane veprimi të përmirësuar për secilën ministri dhe agjenci shtetërore. Është përmirësuar cilësia e planeve të veprimit, përfshi treguesit për monitorimin e progresit. Zbatimi i planeve të veprimit vazhdon.

Përparim është bërë në forcimin e kuadrit ligjor, duke zbatuar rekomandimet e Grupit të Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO) në lidhje me çështjen e inkriminimit dhe financimit të partive politike. Për sa i përket inkriminimit, rekomandimet janë zbatuar pjesërisht; ndryshimet e Kodit Penal presin miratimin në parlament me shumicë tre të pestat. Për sa i përket financimit të partive politike, të gjitha rekomandimet janë zbatuar, përveç njërit, kjo e fundit është zbatuar pjesërisht pasi nuk ka një afat të qartë për dorëzimin e raporteve financiare vjetore të partive.

Kuadri institucional për luftën kundër korrupsionit është zhvilluar më tej. Për të përmirësuar koordinimin në zbatimin e strategjisë anti-korrupsion, është bërë një ndarje më e qartë e

përgjegjësi mes grupit ndërministror të punës (GNP), Grupit Teknik ndërministror dhe Sekretariatit Teknik të GNP-së. Në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave është krijuar një departament i ri i kontrollit të brendshëm. Megjithatë, ashtu si edhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, ky departament përqendrohet më shumë te detyrat e kontrollit financiar sesa në masat anti-korrupsion. Numra telefoni pa pagesë janë instaluar në disa prej institucioneve në fjalë, në mënyrë që qytetarët të denoncojnë rastet e dyshuara.

Janë bërë përpjekje për përmirësimin e bashkëpunimit ndërinstitutional përmes nënshkrimit të Memorandumeve të Mirëkuptimi që parashikojnë veçanërisht rritje të shkëmbimit të informacionit dhe të bashkëpunimit në hetime. Departamenti i Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Anti-Korrupsionit (DKBAA) si dhe Inspektorati i Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit e Pasurive (ILDKP) kanë nënshkruar secila nga një memorandum të tillë me Këshillin e Lartë të Drejtësisë (KLD-në) dhe me një OJF kundër korrupsionit. Megjithatë, zbatimi dhe efikasiteti i një memorandumit të tillë mbetet për t'u verifikuar në praktikë.

Disa masa parandaluese të kufizuara janë marrë përmes nismave për rritjen e ndërgjegjësimit.

Megjithatë, zbatimi i përgjithshëm i masave anti-korrupsion mbetet i pamjaftueshëm. Korrupsioni është i përhapur në shumë fusha dhe mbetet një problem veçanërisht serioz.

Institucionet përgjegjëse kanë mangësi në kapacitetin administrativ dhe në mekanizmat e propozuara për të siguruar monitorimin e duhur të zbatimit të plan veprimeve kundër korrupsionit. Sidomos DKBAA nuk është forcuar sa duhet për sa i përket stafit dhe kompetencave monitoruese; prandaj, aftësia e saj për të koordinuar me efikasitet politikat anti-korrupsion mbetet e kufizuar. Duhet përmirësuar raportimi për masat anti-korrupsion si dhe zbatimi nga autoritetet përgjegjëse. Statistikat e së drejtës penale si dhe ato të çështjeve të konfliktit të interesit dhe masave parandaluese mbeten të pamjaftueshme dhe jo të besueshme.

Një sërë agjencish hetimore dhe të zbatimit të ligjit vazhdojnë të kenë mungesë burimesh njerëzore dhe infrastrukturës teknike. Njësitë e Përbashkëta Hetimore, megjithëse vazhdojnë të jenë instrumente të mira për hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit, kanë burime të pamjaftueshme njerëzore dhe teknike. ILDKP-ja, megjithëse luan rol të rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit, ka burime të kufizuara për të ndërmarrë inspektime të zgjeruara dhe auditime të plota të deklarimeve të pasurive nga zyrtarët. Në këtë drejtim, ILDKP-ja ka nevojë të forcojë më tej bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit me shërbimet e tjera si Njësia e Hetimit Financiar, shërbimet Doganore, ose me Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, në mënyrë që të jetë në gjendje të zhvillojë hetime administrative në mënyrë më efektive.

Hetimet për rastet e mundshme të korrupsionit pengohen edhe nga mungesa e aksesit në regjistra të ndryshëm (p.sh. regjistri i mjete motorike dhe regjistri i tokës) të agjencive hetimore dhe të zbatimit të ligjit, si dhe nga mungesa e një regjistri qendror të llogarive bankare.

Në Shqipëri mungojnë hetimet proaktive, d.m.th. hetimet sistematike, të fokusuara dhe mbi

baza kërcënimi në fusha dhe raste të mundshme të korrupsionit. Imuniteti i plotë i zyrtarëve të lartë vazhdon të mbetet pengesë e madhe për hetime të suksesshme. Gjyqtarëve rrallë u hiqet imuniteti dhe mosruajtja e konfidencialitetit në rastin e heqjes së imunitetit, pengon seriozisht efikasitetin e hetimeve. Me nismën e disa deputeteve të shumicës në pushtet, parlamentarët mund të heqin dorë nga imuniteti i tyre në rastet e ndjekjes penale për akuzat për korrupsion, duke nënshkruar vullnetarisht një deklaratë individuale në fillim të mandatit të tyre; kjo nismë pasoi ndryshimin e rregullores së parlamentit dhe procedurave për imunitetin ndaj ndjekjes penale. Edhe pse një hap i tillë shpreh vullnet politik për ta ndaluar korrupsionin në nivele të larta, vlefshmëria juridike e këtyre deklaratave ngre pikëpyetje. Kufizimi apo heqja e imunitetit të gjyqtarëve dhe deputetëve, mund të kërkojë ndryshim të dispozitave kushtetuese përkatëse.

Megjithëse bashkëpunimi ndërmjet agjencive, përfshirë trajnimet e përbashkëta, është përmirësuar më tej, shkëmbimi i informacioneve relevante është shpesh i vonuar ose joefikas. Bashkëpunimi mes agjencive të zbatimit të ligjit dhe prokurorisë nga njëra anë, si dhe gjykatave nga ana tjetër, mbetet i pamjaftueshëm.

Pak përparim është bërë në krijimin e një vijimësie (historiku) solid të hetimeve proaktive, ndjekjen dhe dënimet në çështjet e korrupsionit të të gjitha niveleve, që është prioritet kyç i Opinionit. Veçanërisht të rralla janë hetimet e rasteve të korrupsionit të niveleve të mesme dhe të larta. Prokurori i Përgjithshëm hapi një hetim me akuzat për korrupsion dhe abuzim me detyrën kundër ish-Zëvendëskryeministrit Ilir Meta, pas publikimit të një videoje të diskutueshme. Kjo rrjedhimisht çoi edhe në ngritjen e akuzave kundër ish-Ministrit të Ekonomisë, Dritan Prifti. Çështja kundër ish-Zëvendëskryeministrit Meta është deri tani e vetmja çështje e nivelit të lartë që ka shkuar në gjykatë.

Në tërësi, përparim të kufizuar ka pasur në fushën e politikave anti-korrupsion, që është prioritet kyç i Opinionit. Megjithëse kuadri ligjor dhe strukturat ndërinstitucionale janë krijuar, zbatimi i aksioneve specifike mbetet joefikas në tërësi dhe rezultatet janë të pamjaftueshme. Fushatat për ndërgjegjësimin e publikut sapo kanë filluar. Imuniteti i disa zyrtarëve të caktuar publikë, mungesa e një përjasjeje proaktive si dhe mungesa e burimeve dhe pajisjeve, vazhdojnë të pengojnë seriozisht hetimin efikas. Mungon një vijimësi (historik) solid i hetimeve, procedimeve penale dhe dënimeve në të gjitha nivelet. Korrupsioni është i përhapur në shumë fusha dhe vazhdon të jetë problem veçanërisht serioz.

2.2. Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve *(shiko edhe Kapitullin 23 – Gjyqësori dhe të drejtat themelore)*

Respektimi i të drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut

Shqipëria ka vazhduar procesin e ratifikimit të **instrumenteve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut**, pasi ka ratifikuar Konventën e Këshillit të Europës për të Drejtat e Njeriut dhe Biomjekësinë. Ratifikimi i Konventës së OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, e nënshkruar në dhjetor 2009, ka mbetur ende pezull. Vonesat në zbatimin dhe mospajtimin me vendimet e **Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut** (GjEDNj) vazhdojnë të jenë çështje shqetësuese. Vendimi i Shqipërisë për ekstradimin në

SHBA të një të dyshuari për vrasje, duke shkelur një vendim të përkohshëm të Gjykatës, është kritikuar nga Raportuesi i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës. Gjatë periudhës raportuese, GjEDNj-ja ka dhënë 5 vendime ku konstaton se Shqipëria ka shkelur të drejtat e garantuara nga Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj). Që në tetor 2010, pranë GjEDNj-së janë dorëzuar gjithsej 83 kërkesa të reja që i janë kaluar organit përkatës për marrjen e vendimit. Në shtator 2011, 321 kërkesa të caktuara në lidhje me Shqipërinë prisnin vendim nga GjEDNj-ja.

Për sa i përket **promovimit dhe zbatimit të të drejtave të njeriut**, emërimi i Avokatit të Popullit ka mbetur pezull që në shkurt 2010. Për shkak të këtij vakumi ligjor, procesi i emërimit të tre komisionerëve në Zyrën e Avokatit të Popullit në nëntor 2010 nuk ndoqi procedurat e parashikuara me ligj. Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka filluar funksionimin që nga janari 2011 dhe është zhvendosur në ambientet e përhershme në muajin gusht, ndërsa rekrutimi i stafit është pranë përfundimit. Kapaciteti i saj për të menaxhuar rastet dhe për të inkurajuar viktimat e mundshme që të dalin hapur, ka ende nevojë të forcohet. Organeve të të drejtave të njeriut nuk u janë akorduar ende burime të mjaftueshme për të garantuar pavarësinë e plotë të tyre. Respektimi i të drejtave të njeriut në Shqipëri vazhdon të monitorohet nga organet ndërkombëtare. Pas ngjarjeve të 21 janarit, vizita të veçanta janë bërë si nga Komisioni për Parandalimin e Torturës ashtu dhe nga Komisioneri i Këshillit të Europës për të Drejtat e Njeriut. Ky i fundit theksoi nevojën për hetime të hollësishme, të paanshme dhe të besueshme të këtyre ngjarjeve dhe bëri thirrje që personat përgjegjës të japin llogari.

Të drejtat civile dhe politike

Marrja e masave shtesë për të përmirësuar trajtimin e të ndaluarve në rajonet e policisë, në paraburgim dhe në burgje, forcimi i hetimeve gjyqësore për rastet e keqtrajtimit dhe përmirësimi i zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit në këtë fushë, është prioritet kyç i Opinionit.

Për sa i përket parandalimit të **torturës dhe keqtrajtimit dhe luftës kundër mosndëshkimit**, janë bërë disa përparime në sistemin e vuajtjes së dënimit, megjithëse ka ende shqetësime ndaj arrestimeve dhe ndalimeve nga policia. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka organizuar trajnime, inspektive tematike dhe shumëdisiplinore, si dhe ka bërë përpjekje për të adresuar rastet e denoncuara të keqtrajtimit. Një metodologji e re për trajtimin e të ndaluarve është miratuar në janar 2011. Janë bërë disa përparime edhe me procedurat e ndjekjes së rekomandimeve të Avokatit të Popullit në këtë fushë, me ngritjen e një grupi të posaçëm pune në Ministrinë e Drejtësisë. Megjithatë, mbetet për t'u parë nëse kjo do të çojë në zbatim më të mirë të rekomandimeve. Janë hartuar ndryshimet e manualit për rregullat e trajtimit dhe sigurimin e të arrestuarve dhe të ndaluarve në njësitë policore.

Ende raportohen raste të keqtrajtimit dhe të përdorimit të tepërt të forcës, veçanërisht gjatë arrestimit dhe ndalimit nga policia. Për shembull, abuzime të tilla u raportuan pas ngjarjeve të 21 janarit. Procedurat për përpunimin e personave të shoqëruar apo arrestuar nuk ndiqen sistematikisht. Nuk ka prova për ndonjë përparim thelbësor në ndjekjen gjyqësore të rasteve të keqtrajtimit. Buxheti i akorduar për Mekanizmin Kombëtar për Parandalimin e Torturës

mbetet i pamjaftueshëm. Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë në lidhje me kujdesin ndaj personave të dënuar me sëmundje mendore është duke u negociuar dhe ende nuk është nënshkruar. Personat e sëmurë mendorë të dënuar për një vepër penale dhe që janë nën trajtim të detyrueshëm, vazhdojnë të mbahen në Institutin e Krugës, në vend të një institucioni të specializuar të mjekësisë ligjore. Trajtimi i të dënuarve të sëmurë mendorë ka ende nevojë për përmirësim. Shqetësim serioz mbetet mungesa e një zgjidhjeje të përshtatshme dhe të përhershme për sistemimin e personave nën trajtim të detyrueshëm.

Gjakmarrjet dhe vrasjet jashtëgjyqësore vazhdojnë të prekin disa pjesë të popullsisë, ku disa familje ende zgjedhin ngujimin nga frika e hakmarrjes. Megjithëse mungojnë statistika të plota të besueshme për përmasat e këtij fenomeni, burimet tregojnë se ky fenomen vazhdon të ekzistojë dhe mbetet çështje shqetësuese.

Disa përparime janë bërë në **sistemin e burgjeve**. Përmirësimet në infrastrukturën e sistemit të vuajtjes së dënimit kanë vazhduar. Janë organizuar trajnime për forcimin e kapaciteteve të personelit të burgjeve dhe u është kushtuar vëmendje trajtimit të personave të cenueshëm në burgje. Në shkurt 2011, u miratuan ndryshimet në Vendimin e Këshillit të Ministrave për miratimin e rregullores së përgjithshme të burgjeve. Në prill 2011, u miratua vendimi për përfshirjen e të dënuarve dhe të ndaluarve në paraburgim në kategorinë e personave ekonomikisht joaktiv, duke iu mundësuar atyre akses në sigurim shëndetësor falas. Zhvillimi i shërbimit të provës dhe hapja e zyrave të reja (tani në 8 nga 12 qarqe) ka ndihmuar në uljen e mbipopullimit në burgje, që ishte rreth 10% në qershor 2011. Administrata në disa institucione të vuajtjes së dënimit ka bërë përpjekje për përmirësimin e kushteve të jetesës së personave që u është hequr liria, si për shembull duke shtuar pushimet e ajrosjes. Formimi profesional është në zhvillim e sipër.

Megjithatë, ende mbeten probleme të mëdha, veçanërisht në lidhje me kushtet e këqija në disa burgje më të vjetra dhe disa qendra paraburgimi, si dhe në komisariate policie. Për më tepër, planifikimi i infrastrukturës nuk është gjithmonë në nivelin e duhur. Ka pasur disa raste ankesash kolektive nga grupe të burgosurish për kushtet e jetesës dhe ushtrimin e dhunës fizike dhe psikologjike nga personeli i burgut. Këto raste duhen hetuar plotësisht. Kushtet e jetesës së të burgosurve varen kryesisht nga ato që u sigurojnë familjet e tyre, përfshi ushqimin. Kushtet në ambientet e kujdesit shëndetësor dhe mungesa e ngrohjes në shumë institucione, përfshi në disa ambiente të rinovuara, janë çështje shqetësuese. Përdorimi i drynave individualë në dyert e qelive përbën rrezik për të ndaluarit në rast evakuimi. Ekzaminimet mjekësore përpara sistemimit hyrjes në institucionet e vuajtjes së dënimit nuk janë kryer sistematikisht dhe ekziston shqetësimi për ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave mjekësore në burgje dhe komisaritet e policisë. Ekzistojnë edhe probleme të tjera në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit të telefonatave dhe mundësinë e dërgimit të formularëve të ankesave pranë Avokatit të Popullit. Shqetësim mbetet sistemimi i tejzgjatur dhe i vazhdueshëm i të dyshuarve me rrezikshmëri të ulët, sidomos i të miturve, në mjediset e paraburgimit.

Për sa i përket **aksesit në organet e drejtësisë**, në mars 2011 u nënshkrua një memorandum mirëkuptimi mes Komisionit Shtetëror për Ndhmën Juridike dhe Komisionerit për Mbrojtjen

nga Diskriminimi që përmban dispozita që garantojnë ndihmën juridike pa pagesë për viktimat e diskriminimit. Është krijuar Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike dhe janë miratuar aktet nënligjore, por mbetet që ligji të zbatohet plotësisht. Ende nuk janë krijuar mekanizmat e duhur për caktimin objektiv të çështjeve për avokatët. Aksesit në organet e drejtësisë për personat e cenueshëm dhe viktimat e dhunës në familje, po pengohet nga moszbatimi i Ligjit për Ndihmë Ligjore pa Pagesë. Vonesat e vazhdueshme të procedimeve gjyqësore vënë në pikëpyetje aksesin efektive të qytetarëve në organet e drejtësisë.

Liria e shprehjes vazhdon të respektohet në përgjithësi, edhe pse përparimi në këtë fushë ka qenë shumë i kufizuar. Zhvillim pozitiv është roli në rritje i gazetarisë investigative në zbulimin dhe denoncimin e korrupsionit. Media i mbuloi gjerësisht zgjedhjet vendore të majit 2011 dhe disa transmetues bënë një hap drejt pavarësisë në rritje duke mos transmetuar kasetat e gatshme të shpërndara nga partitë politike. Moratoriumi që ndalon zyrtarët qeveritarë të ngrenë padi për shpifje të medias, vazhdon të zbatohet. Edhe pse Gjykata e Apelit rrëzoi vendimin për gjobën e madhe të vënë ndaj një kanali televiziv në një rast ku përfshihej një politikan i nivelit të lartë, zbatimi i parimit të proporcionalitetit të gjobave ndaj rrjeteve mediatike apo gazetarëve nuk respektohet gjithmonë. Në disa raste janë ngritur shqetësime mbi atë që rrjetet mediatike e përshkruajnë si zbatim të njëanshëm të rregullave fiskale, presioneve financiare dhe njëanshmëri në procedimet gjyqësore. Ka pasur një rast dhune kundër një gazetari i cili është sulmuar nga persona të panjohur për arsye, siç raportohet, të lidhura me punën e tij. Pavarësia editoriale vazhdon të pengohet nga interesat politike dhe të biznesit, çka po ashtu çon në vetëcensurim. Asnjë masë nuk është marrë për rritjen e transparencës për sa i përket pronësisë së mjeteve të medias. Ndryshimet që dekriminalizojnë shpifjen dhe fyerjen kanë mbetur ende pa u miratuar në pritje të votimit me tre të pestat në parlament. Pavarësia e transmetuesit publik nuk është rritur, dhe me gjithë ekzistencën e tri shoqatave të gazetarëve apo sindikatave, media ende nuk ka një organ vetërregullator. Në tërësi, ka pasur përparim të kufizuar në plotësimin e kuadrit ligjor për median. Duhet më tepër përpjekje për të siguruar pavarësinë dhe lirinë e medias.

Liria e tubimit dhe e organizimit është respektuar në përgjithësi dhe nuk janë njoftuar raste ndalimi të qëllimshëm të tubimeve publike. Periudha e raportimit ka shënuar tubime dhe demonstrata me përkrahës të të dy partive kryesore politike. Edhe pse ato kanë qenë kryesisht paqësore, ekzistojnë shqetësime serioze për dhunën e ushtruar gjatë demonstratës së 21 janarit 2011, ku humbën jetën 4 persona. Hetimet mbi këto ngjarje vazhdojnë, megjithëse shumë ngadalë.

Strategjia për mbrojtësit e të drejtave të njeriut vazhdon të zbatohet. Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile është funksionale dhe ka shpallur dy thirrje për projekt-propozime. Shoqërisë civile në Shqipëri i mungon bashkëpunimi dhe kapaciteti; shumica e organizatave vazhdojnë të jenë të varura nga donacionet, gjë që shkakton konkurrencë të tepërt për fonde në këtë sektor. Shoqëria civile është konsultuar në disa prej nismave legjislativë, veçanërisht në fushën e të drejtave të njeriut. Megjithatë, nuk ka ende një dialog sistematik dhe konsultimi me OJF-të gjatë procesit legjislativ në përgjithësi mbetet i pamjaftueshëm.

Ka pasur zhvillime në fushën e **lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe besimit**, të cilat

vazhdojnë të respektohen. Në nëntor 2010, Aleanca Evangjeliste Shqiptare nënshkroi një marrëveshje me qeverinë sipas së cilës Protestantizmi u bë feja e pestë zyrtare përkrah fesë Myslimane Suni, Bektashi, Ortodokse dhe Katolike. Në bazë të kësaj marrëveshjeje, Aleanca Evangjeliste Shqiptare gëzon të drejtën të përfitojë mbështetje financiare nga buxheti i shtetit, siç ndodh edhe me grupet e tjera të besimeve zyrtare.

Të drejtat ekonomike dhe sociale (shiko edhe Kapitullin 19 - Politika sociale dhe punësimi)

Marrja e hapave konkretë për forcimin e të drejtave të njeriut, veçanërisht të grave, fëmijëve dhe romëve, si dhe zbatimi efikas i politikave anti-diskriminim, është prioritet kyç i Opinionit.

Disa përparime janë bërë në lidhje me të **drejtat e grave dhe barazinë gjinore**. Zgjatja e Strategjisë Kombëtare 2011-2015 për Barazinë Gjinore dhe Luftën kundër Dhunës në Familje, u miratua në qershor 2011. Mekanizmi Kombëtar i Referimit për viktimat e dhunës në familje u krijua në 17 bashki. Ndryshimet në Ligjin për Masat kundër Dhunës në Marrëdhëniet Familjare i ngarkuan qeverisjen vendore detyrimin që ta zbatojë këtë mekanizëm si dhe të sigurojë përmirësim të aksesit në organet e drejtësisë për viktimat e dhunës në familje. Streha kombëtare për viktimat e dhunës në familje është funksionale, standardet për kujdesin ndaj viktimave në qendrat rezidenciale publike dhe jo-publike janë miratuar dhe është bërë trajnimi i punonjësve të kujdesit shëndetësor për t'i aftësuar ata në trajtimin e rastet të dhunës gjinore. Janë zhvilluar disa fushata ndërgjegjësimi për të nxitur pjesëmarrjen e grave në jetën publike dhe për t'i fuqizuar ato ekonomikisht. Përparim është bërë në zbatimin e kuotës gjinore në krahasim me zgjedhjet e mëparshme.

Megjithatë, kuota gjinore nuk u respektua në të gjithë vendin gjatë zgjedhjeve vendore të majit 2011. Në raportin e vet, OSBE/ODIHR-i rekomandoi se duhej marrë parasysh rritja e gjobave për subjektet elektorale që nuk respektojnë kriterin gjinor dhe të kushtëzojë marrjen e fondeve publike nga respektimi i këtyre dispozitave. Vetëm pesë gra u zgjodhën kryetare bashkie dhe dy kryetare komune. Gratë vazhdojnë të mos përfaqësohen sa duhet në tregun e punës, në politikëbërje dhe në politikë. Zbatimi i instrumenteve ekzistuese legjislative dhe të politikave në këtë fushë vazhdon të jetë i dobët. Koordinimi mes institucioneve në nivelin vendor dhe qendror duhet rritur ndjeshëm. Tani për tani, rrjeti i zyrtarëve të barazisë gjinore në të gjithë Shqipërinë përbëhet prej vetëm 15 personave nëpër bashki.

Dhuna në familje vazhdon të jetë tejet e përhapur dhe mbrojtja e grave ndaj të gjitha formave të dhunës duhet forcuar në mënyrë të konsiderueshme në praktikë.

Janë bërë disa përparime në fushën e të **drejtave të fëmijëve**. Ligji për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës u miratua në nëntor 2010. Ky ligj vendos disa mekanizma institucionale për respektimin e të drejtave të fëmijëve nga familja, shteti dhe palë të treta në nivel qendror dhe vendor. Është krijuar Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve dhe janë emëruar anëtarët e Këshillit Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës. Megjithatë, Këshilli ende nuk ka filluar funksionimin. Janë ngritur Njësitë e të Drejtave të Fëmijës në 9 qarqe dhe Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve në 28 bashki dhe komuna. Këshilli i Ministrave miratoi aktet nënligjore për Komitetin Shqiptar të Birësimit dhe vazhdon të

zbatohet projekti pilot për kujdestarinë e përkohshme ku përfshihen 80 fëmijë. Pritet të miratohet Strategjia për drejtësinë e të miturve e cila adreson aspektet e shpërfillura si mbrojtja e fëmijëve viktime dhe dëshmitarë të një krimi, si dhe masat për të akuzuarit nën moshën e përgjegjësive penale. Policia e Shtetit ka filluar zbatimin e një plani operacional për parandalimin e trafikimit, keqtrajtimit, shfrytëzimit seksual dhe shtrëngimit të të miturve për të punuar apo lypur. Mbetet për t'u parë nëse zbatimi i tij do të sjellë përparim domethënës në reduktimin e punës së fëmijëve. Megjithatë Ligji për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës parashikon mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna fizike dhe psikologjike, ka ende shqetësime për ushtrimin e dhunës kundër fëmijëve, përfshi përdorimin e dhunës fizike sistematike.

Përparimi në trajtimin e **personave vulnerabël nga ana sociale dhe/apo me aftësi të kufizuara** është i pamjaftueshëm. Një grup pune i kryesuar nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta po përgatit një ligj për personat me aftësi të kufizuara. Vazhdon mungesa e aksesit në të drejtat e barabarta që rezulton nga diferencimi që u bëhet grupeve të caktuara. Individët me paaftësi mendore ende nuk kanë një status zyrtar. Zbatimi i strategjisë kombëtare për personat me aftësi të kufizuara vazhdon të mos jetë në nivelin e duhur dhe kuotat e punësimit nuk zbatohen. Në prill 2011, një grup personash me aftësi të kufizuara organizuan një grevë urie ku kërkonin kushte më të mira dhe rritje të asistencës sociale.

Përparim i kufizuar është bërë në lidhje me zbatimin e **politikave anti-diskriminim**. Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka zhvilluar disa fushata ndërgjegjësimi dhe trajnime. Kësaj zyre i është marrë mendimi gjatë hartimit të legjislacionit. Faqja e saj e internetit është funksionale dhe formularët e ankesave mund të gjenden *online*. Deri tani, pranë zyrës janë dorëzuar vetëm 8 ankesa për diskriminim dhe dy prej tyre janë finalizuar me rekomandime nga Komisioneri. Ndërgjegjësimi i përgjithshëm për dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi mbetet i ulët, sidomos në nivel vendor dhe në radhët e publikut dhe grupeve të rëndësishme profesionale (si forcat e rendit, gjyqtarët, punonjësit e arsimit dhe shëndetësisë). Nevojitet informim më i mirë për ligjin i qytetarëve dhe profesionistëve për të siguruar zbatim të suksesshëm të tij. OJF-të që punojnë me komunitetin e lesbikeve, homoseksualëve, biseksualëve dhe transeksualëve (LHBT) në Shqipëri janë forcuar gjatë vitit të fundit. Në korrik 2010, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta organizoi një aktivitet publik për të drejtat e njeriut të komunitetit LHBT në Shqipëri. Megjithatë, rritja e vizibilitetit publik e këtij komuniteti nuk e ka përmirësuar pranimin e përgjithshëm të këtyre personave dhe ata vazhdojnë të vuajnë diskriminimin dhe mënjanimin. Janë raportuar disa raste dhune dhe keqtrajtimi që kanë vënë në shënjestër persona të komunitetit transeksual. Homofobia vazhdon të jetë gjerësisht e përhapur, madje edhe në radhët e zyrtarëve të shërbimit publik.

Të drejtat e punës dhe e bashkimit në sindikata janë respektuar në përgjithësi dhe është bërë përparim drejt inkurajimit të dialogut social sektorial dhe dypalësh. Funksionimi i Këshillit Kombëtar të Punës është përmirësuar, por kriteret e anëtarësimit mbeten të paqarta. Është regjistruar një shoqatë e re ombrellë e punëdhënësve. Megjithatë, bisedimet për kontrata kolektive ende nuk janë zhvilluar në nivelin e sektorit privat.

E drejta e pronësisë vazhdon të jetë çështje shumë shqetësuese. Pak përparim të dukshëm ka

pasur në përgatitjen e një strategjie gjithëpërfshirëse të reformës së pronës, që është prioritet kyç i Opinionit, apo për reformimin e kuadrit ligjor dhe institucional përkatës. Struktura koordinuese në Ministrinë e Drejtësisë ende nuk është krijuar. Pavarësisht nga përparimi i bërë, procesi i regjistrimit fillestar të pronës së paluajtshme ende nuk ka përfunduar.

Për integrimin e bazave të të dhënave elektronike për tokën dhe pronën, qeveria është zotuar të krijojë Regjistrin e Territorit. Megjithatë, ende nevojiten masa specifike teknike dhe udhëzime ligjore. Në përgjithësi, bazat e të dhënave të tokës dhe pronës vazhdojnë të jenë të izoluara në Zyrën e Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme dhe nuk ka koordinim me bazat e të dhënave të institucioneve të tjera publike.

Çështje të tjera si taksat e pronës (zotim i Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim) dhe sqarimet ligjore për të bërë dallimin mes të drejtës së pronës dhe të drejtës së zhvillimit, kanë mbetur pa u adresuar. Si rezultat, rregullimi i tregut të tokës dhe zhvillimi i balancuar i tokës nuk kanë bërë ndonjë përparim domethënës.

Kërkesat e ish-pronarëve për kompensimin dhe rikthimin e pronave të konfiskuara gjatë regjimit komunist vazhdojnë të jenë të pazgjidhura. Disa masa janë marrë nga Agjencia për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave (AKKP) pas ristrukturimit të saj. Rregullat e fondit të posaçëm për kompensimin e pronave janë përmirësuar dhe burimet e tij financiare janë rritur. Nisma për rishikimin e metodologjisë së vlerësimit dhe hartës së vlerës për territorin e vendit është ende në fazën konceptimit. AKKP-ja ka planifikuar 7.3 milion euro për kompensimin e 1012 ish-pronarëve. Qeveria ende nuk ka përcaktuar një kalendar kohor për zbatimin e vendimeve të GjEDNj-së në lidhje me të drejtën e pronës.

Respektimi dhe Mbrojtja e Minoriteteve dhe të Drejtave Kulturore

Përparimi ka qenë shumë i kufizuar në fushën e mbrojtjes së **minoriteteve**. Në janar 2011, Shqipëria i dorëzoi Këshillit të Europës raportin e tretë kombëtar për zbatimin e Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Minoriteteve. Në maj 2011, Shqipëria ndryshoi formatin e certifikatave të gjendjes civile; në to nuk është më koncepti i kombësisë apo përkatësia etnike e individit, por vetëm shtetësia e tij. Disa përfaqësues të minoriteteve shprehën shqetësim rreth kësaj nisme. Nuk ka pasur ndonjë përparim në forcimin e kapacitetit të Komitetit Shtetëror të Minoriteteve. Asnjë masë nuk është marrë për rivlerësimin e dallimit mes pakicave kombëtare dhe atyre etnoghjësore. Shqipëria ende nuk ka miratuar Kartën Europiane për Gjuhët Minoritare dhe Rajonale. Edhe pse marrëdhëniet ndërtnike mbeten përgjithësisht të mira, ka pasur njëfarë përkeqësimi të klimës së minoriteteve, veçanërisht në lidhje me përgatitjen e censusit të popullsisë. Pas gjykimit në shkallë të parë dhe vendimit, rasti i vrasjes së një shtetasi shqiptar që fliste greqisht në Himarë në vitin 2010, po shqyrtohet nga apeli. Censusi i Popullsisë dhe i Banesave që ishte planifikuar të zhvillohej në prill 2011, u shty për në tetor 2011. Shqipëria vendosi të përfshijë në pyetësin e censusit pyetje fakultative për origjinën etnike dhe përkatësinë fetare. Mbledhja e këtyre të dhënave mund të shërbejë për formulimin e politikave të përshtatshme për minoritetet, bazuar në statistika të përditësuar. Respektimi i standardeve ndërkombëtare, përfshi parimin e vetidentifikimit të lirë, ka një rëndësi shumë të madhe.

Për sa u përket **romëve**, është zbatuar kuota për studentët romë dhe egjiptianë që vazhdojnë studimet universitare dhe pasuniversitare për vitin akademik 2010-2011. Një masë tjetër që synon shtimin e numrit të fëmijëve romë në arsimin e detyrueshëm shkollor ishte shpërndarja e librave shkollorë pa pagesë; megjithatë, zbatimi nuk ka justifikuar pritshmërinë, për shkak të defekteve në sistemin e rimbursimit. Niveli i regjistrimit parashkollor për fëmijët romë vazhdon të jetë më i ulët në krahasim me pjesën tjetër të popullsisë. Klasat përgatitore për fëmijët e moshës 5-vjeçare që nuk kanë shkuar në kopsht janë në zhvillim e sipër. Sekretariati Teknik për Romët ka bërë përpjekje për të vlerësuar ecurinë e zbatimit të politikave, përmes përgatitjes së raporteve monitoruese.

Megjithatë, zbatimi i Strategjisë për përmirësimin e kushteve të jetesës për romët vazhdon të jetë i ngadaltë, për shkak të burimeve dhe koordinimit të pamjaftueshëm të institucioneve përgjegjëse në nivelin lokal dhe qendror. Ende nuk janë përgatitur planet e veprimit për zbatimin e strategjisë në nivel vendor dhe ndarja e përgjegjësive nuk është e qartë. Pavarësisht përpjekjeve të Sekretariatit Teknik për Romët për të forcuar funksionimin e komiteteve rajonale në lidhje me planifikimin dhe vlerësimin e nevojave sociale duke përfshirë në agjendën e tyre Planin Kombëtar të Veprimit për Dekadën e Romëve, niveli vendor vazhdon të ketë mungesë të përgjithshme ndërgjegjësimi. Nuk është akorduar buxhet specifik për ofrimin e shërbimeve sociale bazë për romët dhe në këtë fushë ka varësi të tepruar tek shoqëria civile dhe donatorët ndërkombëtarë. Burimet e Sekretariatit Teknik për Romët pranë Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta nuk janë shtuar. Megjithëse janë zhvilluar fushata regjistrimi dhe ndërgjegjësimi, një numër romësh ende nuk janë të regjistruar zyrtarisht. Romët ende përballesh me kushte shumë të vështira jetese dhe diskriminim të shpeshtë, veçanërisht në lidhje me aksesin në arsim, mbrojtjen sociale, shëndetësinë, punësimin dhe strehimin e përshtatshëm. Shqetësime serioze u ngritën pas dëbimit me forcë në shkurt 2011 të rreth 45 familjeve romë nga qytetarët prej vendbanimeve të tyre pranë stacionit të trenit në Tiranë. Autoritetet kanë strehuar familjet e prekura në vendbanime alternative të përkohshme por të papërshtatshme, në çadra në një zonë të largët të qytetit. Ata janë ndihmuar nga komuniteti ndërkombëtar dhe organizatat joqeveritare, veçanërisht për sa i përket ndihmës juridike në çështjen ku dy persona u dënuan për shkatërrimin e vendbanimeve të tyre, por jo për dëmin fizik dhe psikologjik që u është shkaktuar romëve.

Në tërësi, përparimi në fushën e të drejtave të njeriut dhe respektimit dhe mbrojtjes së minoriteteve nuk ka qenë i njëtrajtshëm. E drejta e pronës vazhdon të jetë shqetësim serioz. Pak përparim është bërë për miratimin dhe zbatimin e një strategjie koherente për reformën e pronës dhe planin e veprimit. Kjo nismë është prioritet kyç i Opinionit dhe tepër e rëndësishme për konsolidimin e të drejtës së pronës. Fragmentimi i përgjegjësive dhe mungesa e koordinimit ndërmjet institucioneve pengon zbatimin efikas të politikave dhe krijon pasiguri juridike dhe rrezik sistematik për korrupsion.

Përparimi ka qenë i pjesshëm në adresimin e prioritetit kyç për forcimin e të drejtave të njeriut dhe zbatimin efikas të politikave kundër diskriminimit. Në këtë fushë ka pasur zhvillime të rëndësishme, veçanërisht me miratimin e Ligjit për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, miratimin e Strategjisë së re Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Luftën kundër Dhunës në Familje si dhe fillimin e zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Megjithatë, mbeten disa boshllëqe të mëdha legislative, përfshi ato për personat me aftësi të kufizuar, dhe zbatimi i mekanizmave ekzistues për zbatimin e ligjit dhe të politikave në këtë fushë ende nuk është në nivelin e duhur. Duhet të forcohet ndërjegjësimi i përgjithshëm për legjislacionin kundër diskriminimit dhe për mekanizmat e ankimit. Vazhdon të ketë shqetësim për diskriminimin e vazhdueshëm të disa grupeve të cënueshme si personat e komunitetit LHBT dhe romët. Zbatimi i mekanizmave të politikave që kanë në fokus minoritetin rom dhe aksesin e këtij komuniteti në shërbime dhe mbrojtje sociale, është ende i pamjaftueshëm, duke çuar në mënjanimin e tyre të vazhdueshëm.

Disa përparime janë bërë në adresimin e prioritetit kyç për përmirësim e trajtimit të të ndaluarve dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit në këtë fushë. Ministria e Drejtësisë ka marrë masa që të përmirësojë kushtet e ndalimit dhe të ndjekë në mënyrë sistematike rekomandimet e Avokatit të Popullit. Megjithatë, ende raportohen raste keqtrajtimi, veçanërisht gjatë arrestimit dhe ndalimit nga policia, dhe kushtet në disa burgje vazhdojnë të jenë të këqija. Për më tepër, trajtimi i të dënuarve të sëmure mendore duhet përmirësuar ende dhe shqetësim serioz mbetet mungesa e një zgjidhjeje të përshtatshme dhe të përhershme për sistemimin e personave nën trajtim të detyrueshëm.

2.3. Çështjet rajonale dhe detyrimet ndërkombëtare

Këshilli i Europës (KiE) ka vazhduar monitorimin e ecurisë së Shqipërisë në përmbushjen e detyrimeve për anëtarësim dhe ka ndjekur nga afër zhvillimet e lidhura me situatën politike në vend, nëpërmjet organeve të specializuara të KiE-së dhe zyrës së përhershme të jashtme të kryesuar nga përfaqësuesi special i Sekretarit të Përgjithshëm në Tiranë, e cila u hap në fillim të vitit 2011.

Shqipëria ka marrë angazhim të bashkëpunojë plotësisht me EULEX-in për hetime të plota mbi akuzat e ngritura në rezolutën e miratuar nga Asambleja Parlamentare e KiE-së për trajtimin çnjerëzor të njerëzve dhe trafikimin e paligjshëm të organeve në Kosovë, ndërkohë që njëkohësisht i ka hedhur poshtë këto akuza. Bashkëpunimi i mirë i vazhdueshëm i Shqipërisë është i rëndësishëm, sidomos për sa i përket lehtësimit të kërkesave për ndihmë juridike ndërkombëtare në territorin e saj.

Shqipëria ka rënë dakord me Vendimin e Këshillit për t'i dhënë mbështetje universale Gjykatës Penale Ndërkombëtare dhe për të promovuar pjesëmarrjen sa më të gjerë në të⁵. Megjithatë, Shqipëria ende mban marrëveshjen dypalëshe të imunitetit të vitit 2003 me Shtetet e Bashkuara, e cila parashikon përjashtime nga juridiksioni i **Gjykatës Penale Ndërkombëtare**. Kjo nuk është në pajtim me Qëndrimin e Përbashkët të BE-së mbi integritetin e Statutit të Romës dhe as me parimet udhëzuese të BE-së mbi marrëveshjet dypalëshe të imunitetit. Shqipëria duhet të renditet në krahun e qëndrimit të BE-së.

Bashkëpunimi rajonal dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë janë pjesë domethënëse e procesit të Shqipërisë në rrugën drejt Bashkimit European. Shqipëria ka vazhduar të marrë

⁵ Vendimi i Këshillit 2011/168/CFSP i 29 marsit 2011.

pjesë në mënyrë aktive në nismat rajonale, përfshirë Procesin e Bashkëpunimit të Europës Juglindore (SEECP), Këshillin e Bashkëpunimit Rajonal (RCC), Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Europës Qendrore (CEFTA), Traktatin e Komunitetit të Energjisë si dhe Marrëveshjen e Hapësirës së Përbashkët Europiane të Aviacionit (ECAA). Në kuadrin e SEECP-së, Shqipëria miratoi në mars *Dokumentin Strategjik Rajonal dhe Planin e Veprimit për Drejtësinë dhe Çështjet e Brendshme 2011-2013*. Shqipëria mbajti presidencën e MARRI-t (Nisma Rajonale për Migrimin, Azilin dhe Refugjatët) deri në maj 2011. Në këtë kontekst, Shqipëria mbështeti propozimin për krijimin e zonës pa viza mes vendeve pjesëmarrëse, që do t'u mundësonte qytetarëve të udhëtojnë vetëm me karta identiteti biometrike. Shqipëria e ka përfunduar procesin e vendosjes së regjimit pa viza me të gjitha vendet e rajonit.

Shqipëria është partner konstruktiv në rajon dhe ka vazhduar zhvillimin e **marrëdhënieve dypalëshe me vendet fqinje dhe ato të zgjerimit**.

Marrëdhëniet me *Bosnjë-Hercegovinën* kanë vazhduar të jenë të mira. Zbatimi i marrëveshjeve dhe protokolleve ekzistuese dypalëshe ka vazhduar pa probleme. Shqipëria ka vazhduar marrëdhëniet e saj të mira me *ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë*. Dy vendet kanë nënshkruar marrëveshjen për liberalizimin e plotë dypalësh të transportit transit. Shqipëria vazhdon të ketë marrëdhënie të mira me *Kroacinë dhe Malin e Zi*. Bashkëpunimi me *Malin e Zi* është përqendruar në marrëdhëniet ekonomike dhe tregtare. Shqipëria ka bërë hapa përpara në dialogun e saj me *Serbinë*. Shqipëria ka vazhduar të mbajë marrëdhënie shumë të mira me *Kosovën*.

Marrëdhëniet me vendet fqinje anëtare të BE-së, *Greqinë* dhe *Italinë*, vazhdojnë të jenë shumë të mira. Në shkurt 2011, Shqipëria dhe Italia nënshkruan një marrëveshje për përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të njëra-tjetrës në ato vende ku njëri palë i mungon përfaqësimi diplomatik.

Marrëdhëniet e Shqipërisë me *Turqinë* vazhdojnë të jenë të mira. Turqia i dha ndihmë humanitare Shqipërisë pas përmytjeve që prekën vendin në dhjetor 2010.

Në tërësi, Shqipëria ka vazhduar të përmbushë përgjithësisht kushtet e Procesit të Stabilizim-Asociimit dhe të kontribuojë në stabilitetin rajonal, duke mbajtur marrëdhënie pozitive me fqinjët dhe partnerët rajonalë.

3. KRITERI EKONOMIK

Për shqyrtimin e zhvillimeve ekonomike në Shqipëri, Komisioni është orientuar nga përfundimet e Këshillit European në Kopenhagen në qershor 1993, sipas të cilave anëtarësimi në BE kërkon ekzistencën e një ekonomie tregu funksionale dhe aftësinë për të përballuar presionet e konkurrencës dhe forcave të tregut të përbashkët european.

3.1. Ekzistenca e ekonomisë së tregut funksionale

Bazat e politikës ekonomike

Në shkurt 2011, Shqipëria dorëzoi Programin e pestë Ekonomik dhe Fiskal për periudhën 2011-2013. Objektivat kryesorë të tij mbeten po ato të programit të mëparshëm, ndërkohë që politika ekonomike vazhdoi të orientohet drejt stabilitetit makroekonomik, e shoqëruar me konsolidim të buxhetit bazuar në shpenzime. Përparimi me reformat strukturore ka qenë i kufizuar. Rritja ekonomike e parashikuar nga programi duket optimiste, nisur nga situata akoma e vështirë ekonomike e partnerëve tregtarë të Shqipërisë. Pavarësisht peizazhit politik më të polarizuar, ekziston konsensus i gjerë për aspektet themelore të ekonomisë së tregut. *Në tërësi*, është ruajtur konsensusi për bazat e ekonomisë së orientuar drejt tregut.

Stabiliteti makroekonomik

Aktiviteti ekonomik shënoi rritje të fuqishme prej rreth 3.8% në 2010, sipas të dhënave aktuale. Rritja e PBB-së në 2010 u nxit kryesisht nga kërkesa e huaj, pasi eksporti i mallrave u rrit me 63%, duke marrë hov nga eksporti i energjisë elektrike për shkak të rritjes së çmimit të energjisë dhe prodhimit me kapacitet të plotë të hidrocentraleve vendase, ndërkohë që kërkesa e brendshme ka mbetur e dobët. Rritja e konsumit privat ngadalësoi në 2.2%, për shkak se kanë rënduar besimi i ulët i konsumatorit, kushtet e dobëta të tregut të punës, rënia e remitancave dhe kreditimi i mefshtë familjar. Formimi bruto i kapitalit fiks u tkurr me 5.2%, duke pasqyruar shkurtimet e konsiderueshme të shpenzimeve publike në kuadrin e përpjekjeve të qeverisë për konsolidim fiskal. Të dhënat aktuale tregojnë se aktiviteti tregtar ka vazhduar të zgjerohet gjatë gjysmës së parë të 2011. Rritja reale e PBB-së me 3.4% në bazë vjetore në tremujorin e parë, ku sektori i ndërtimit doli nga periudha e gjatë e kontraktimit dhe regjistroi rritje pozitive me 4.8% në bazë vjetore, ndërkohë që rritja në industri dhe shërbime ishte e moderuar pas rikuperimit të shpejtë në 2010. PBB për frymë në raport me paritetin e fuqisë blerëse ishte sa 27.1% e mesatares BE-27 e vitit 2009, duke shënuar rritje nga 25.9% e 2008-ës. *Në tërësi*, ekonomia shqiptare vazhdoi të rritet, pavarësisht se nën normat e larta të mëparshme.

Deficiti i llogarisë korrente pësoi rënie në 11.9% i PBB-së në 2010, nga 15.1% në 2009, duke pasqyruar përmirësimin e të gjithë komponentëve të llogarisë korrente, e mbi të gjitha rikuperimin e fuqishëm të eksportit të mallrave. Deficiti tregtar ende i thellë u ul në 23.4% të PBB-së në 2010, nga 26.4% në 2009, duke pasqyruar rritjen e përgjithshme të eksporteve. Rritje të fuqishme shënoi eksporti i energjisë gjatë vitit 2010 - për shkak se hidrocentralet prodhuan me kapacitet të plotë - i ndjekur nga mineralet dhe materialet e ndërtimit. Eksportet shqiptare vazhduan të kenë varësi të theksuar ndaj industrisë së tekstileve dhe veshjeve-përkëmbën, të cilat përbëjnë 34% të eksporteve totale, megjithëse kjo përqindje është në rënie. Eksporti i produkteve minerare u rrit ndjeshëm në 2010 me vënien në punë të fushave të reja dhe rritjen e çmimeve globale. Remitancat ranë me rreth 11.7% në 2010, duke shënuar 7.8% të PBB-së, si rezultatet e kushteve të dobëta ekonomike të vendeve pritëse. Deficiti i llogarisë

korrente u përkeqësua në gjysmën e parë të 2011, pasi deficiti tregtar u thellua nga ngadalësimi i eksporteve të energjisë dhe rënia me 10% e remitancave.

Gjatë 2010, flukset hyrëse të IHD-së (Investimet e Huaja Direkte) u rritën me 17.2%, duke pasqyruar së pari investimet e reja në kërkimin dhe nxjerrjen e naftës dhe gazit si edhe koncesionet e reja në sektorin energjetik. IHD-ja neto në tremujorin e parë të 2011 ishin sa 1/3 krahasuar me të njëjtën periudhë të 2010. Edhe pse flukset hyrëse të IHD-së u rriten me bazë vjetore, një sasi e konsiderueshme kapitali të huaj është riatdhesuar duke çuar në rënie të fortë të IHD-së. Rritje ka pasur edhe portofoli i investimeve, falë emetimit të 300 milion EUR Eurobonde nga qeveria. Flukset hyrëse të kapitalit ranë me rreth 11%. Në tërësi, bilanci i pagesave pati suficit në 2010, gjë që çoi në rritjen e rezervave me rreth 179 milion EUR. Shqipëria ka ruajtur një nivel të mjaftueshëm rezerve valutore për të mbuluar rreth 4.8 muaj importe. *Në tërësi*, pavarësisht përmirësimit në vitin 2010, sfidë mbetet ulja e mëtejshme e deficitit të llogarisë korrente, sidomos nëse vazhdon rënia e remitancave.

Papunësia u rrit në 13.7% në 2010, aq sa një vit më parë. Punësimi privat jobujqësor është rritur gradualisht gjatë vitit, ndërsa punësimi në bujqësi u rrit në tremujorin e tretë. Kushtet e tregut të punës janë përmirësuar disi pas përkeqësimit në tremujorin e parë të 2011. Punësimi u rrit përkatësisht me 2.2% dhe 2.7% në tremujorin e parë të dhe të dytë, duke pasqyruar rritjen e punësimit privat jobujqësor. Papunësia në tremujorin e parë ra në 13.5% dhe në tremujorin e dytë ishte 13.3%. Statistikat e tregut të punës vazhdojnë të jenë të dobëta dhe të shtrembëruara nga sektori i madh informal. *Në tërësi*, papunësia vazhdon të jetë e lartë.

Inflacioni mesatar vjetor u rrit në 3.6% në vitin 2010, nga 2.3% në 2009, duke mbetur brenda objektivit prej 2-4% të Bankës së Shqipërisë (BSh). Faktorët kryesorë që kontribuuan në inflacion ishin çmimet ndërkombëtare të artikujve ushqimorë dhe karburanteve si edhe rritja e çmimeve të diktuar për ujin dhe energjinë elektrike. Inflacioni u përshpejtua dhe arriti në 4% në tremujorin e parë të 2011, duke shënuar kulmin 4.2% në maj, përpara se të binte në 3.1% në gusht. Rritja e inflacionit në tremujorin e parë të 2011 u shkaktua së pari nga çmimet e larta të artikujve ushqimorë, dhe në një masë më të vogël nga karburantet, për shkak të zhvillimeve në tregjet ndërkombëtare të mallrave ashtu edhe të rritjes së taksave indirekte në 2011 (TVSH për medikamentet dhe akcizat). Në përgjigje të rritjes së presioneve inflacioniste, Banka e Shqipërisë rriti në mars normën bazë të interesit nga 5% në 5.25%.

Niveli i euroizimit mbetet i lartë. Huat dhe depozitat në valutë përbëjnë përkatësisht 67% dhe 47% të stokut total. Edhe pse i nevojshëm për stabilitetin e monedhës, euroizimi kaq i lartë ngushton hapësirat e manovrimit të politikës monetare dhe mund të jetë burim potencial mos-stabiliteti në sistemin financiar, për shkak se mund t'i ekspozojë bankat në riskun e mospërputhjes valutore ose risqeve indirekte të kreditimit.

Shqipëria vazhdoi të ndjekë regjimin fleksibël të kursit të këmbimit. Në 2010, leku u zhvlerësua me 4.3% ndaj euros dhe në gusht 2011 u zhvlerësua edhe me 2.7%. *Në tërësi*, politika monetare mbetet e shëndetshme duke ruajtur stabilitetin e çmimeve, ndërsa inflacioni është mbajtur brenda objektivit.

Gjatë vitit 2010, përparim i mëtejshëm është bërë në përmirësimin e administrimit të taksave, si në mbledhjen e përgjithshme të të ardhurave, edhe në reformat administrative. Deklarimi elektronik është bërë i detyrueshëm për taksapaguesit e TVSH-së, ndërsa legjislacioni u mundëson taksapaguesve të mëdhenj të deklarojnë tatim fitimin *online*. Gjatë 2011 janë marrë masa të ndryshme për të zgjeruar bazën e tatimpaguesve, përfshi futjen e TVSH-së 10% për ilaçet, sistemin e ri të pullave fiskale për mallrat të akcizës, vendosjen e TVSH-së për shërbimet profesionale si edhe shtimi i produkteve që janë objekt akcize. Gjithashtu, qeveria miratoi një amnisti fiskale që synon të legalizojë prona dhe të ardhura të padeklaruara. Pavarësisht këtyre përpjekjeve, ka akoma boshllëqe si në mbledhjen e të ardhurave ashtu edhe në reformën administrative. Mungon një sistem tatimor i plotë shtrëngues për pagimin e taksave, dhe mbledhja e të ardhurave nga pushteti vendor mbetet i dobët.

Trendi në rritje i imbalancës fiskale vitet e fundit bëri kthesë në 2010, kur deficit buxhetor u ul në 3% të PBB nga 7% vitin pararendës. Ky përmirësim i bilancit buxhetor është orientuar kryesisht nga shpenzimet. Shpenzimet totale përbënë 29.6% të PBB, ose 3.4 pikë përqindje më pak se në 2009. Mbi 4/5 e uljes së shpenzimeve ishte rezultat i shkurtimit të shpenzimeve kapitale (me pothuaj 1/3 të nivelit të vitit 2009). Të ardhurat totale ishin 26.6% të PBB në 2010, ose 0.6 pikë përqindje më lart sesa viti pararendës. Buxheti 2011 parashikon një deficit fiskal prej 3.5% të PBB, bazuar në rritjen reale të supozuar të PBB prej 5.5%. Parashikimi për rritjen e deficitit fiskal bazohet kryesisht në rritjen e planifikuar të investimeve kapitale, pasi qeveria po rinovon infrastrukturën gjithnjë e më shumë. Në periudhën janar-korrik 2011, të ardhurat totale buxhetore u rritën me 1/3 krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit pararendës. Këto zhvillime e shtynë qeverinë të ribalancojë buxhetin në korrik, duke ulur shpenzimet në nivel të përbalueshëm nga të ardhurat, me qëllimin që të mbajë deficitin e vitit 2011 në nivelin 3.5% të PBB. U ulën projeksionet për realizimin e të ardhurave tatimore dhe shpenzimet, për shkak të uljes së investimeve kapitale dhe shpenzimeve për mirëmbajtjen. Në të njëjtën kohë, në korrik 2011 u rritën pagat e shërbimit publik dhe pensionet.

Burimin kryesor të financimit të deficitit në vitin 2010 e përbënë huat e brendshme, ndërsa, ndryshe nga vitet e tjera, të ardhurat nga privatizimet ishin të kufizuara. Financimi i brendshëm i deficitit fiskal prek nivelin e normave të interesit të huave për biznesin dhe konsumatore, dhe devijon kursimet drejt sektorit publik. Gjithashtu, Shqipëria emetoi Eurobondin e parë në tregjet ndërkombëtare me vlerë 300 milion EUR, me normë interesi 7.5% dhe me maturim 5-vjeçar. Pjesa më e madhe e të ardhurave nga Eurobondet u përdoren për të shlyer një hua të përbashkët, ndërsa me pjesën tjetër pritet të financohen investime publike. Raporti i borxhit ndaj PBB ishte 58% në vitin 2010, në rënie nga 59% vitin pararendës. Borxhi publik relativisht i lartë vazhdon të ketë bazë afatshkurtër, gjë që kërkon ri-financim të shpeshtë, edhe pse rreth 3/5 e borxhit është i brendshëm. Sidoqoftë, në rast se rriten normat e interesit, hapësira fiskale kufizohet edhe më tepër, çka bën që borxhi publik në nivele kaq të larta të mbetet burim vulnerabiliteti makrofinanciar. *Në tërësi*, deficitin fiskal është ulur ndjeshëm, por prioritet mbetet ndjekja dhe forcimi i konsolidimit buxhetor që garanton ulje afatgjatë të borxhit publik.

Në tërësi, Shqipëria e ka ruajtur stabilitetin makroekonomik, pasi i përballoi mirë kushtet e vështira ekonomike që vazhdojnë të jenë të pranishme në rajon dhe përtej. Politika monetare

ka kontribuar me sukses për ta mbajtur inflacionin stabël. Niveli i lartë i euroizimit vazhdon të kufizojë efektivitetin e kanaleve të transmetimit monetar. Borxhi publik relativisht i lartë kufizon hapësirën fiskale dhe mbetet burim vulnerabiliteti, gjë që nënvizon rëndësinë e konsolidimit buxhetor.

Ndërveprimi i forcave të tregut

Spektori privat kontribuon me 80% të PBB dhe me rreth 82% të punësimit. Pjesëmarrja e shtetit në ekonomi mbetet e ulët, por përparimi i reformës së planifikuar të privatizimeve ndaloi në vitin 2010. Nuk ka përparim të raportuar në lidhje me shitjen e kuotave/aksioneve shtetërore në disa shoqëri tregtare strategjive. Në tërësi, përfshirja e Shtetit në ekonomi është e ulët.

Hyrja dhe dalja nga tregu

Shqipëria ka bërë përparim të mirë duke lehtësuar procedurat për regjistrimin dhe licencimin e bizneseve. Qendra Kombëtare e Licencimit e ka shtrirë rrjetin e shërbimeve në qytete përtej Tiranës. Megjithatë, procedurat për dhënien e lejeve të ndërtimit mbeten të zgjatura, duke penguar rikuperimin e sektorit të ndërtimit që gjendet në vështirësi. Nënshkrimi elektronik që mundëson aplikimet *online* për regjistrim, u bë funksional në mars 2011. Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, që shërben si *one-stop-shop* për investitorët e huaj, u bë funksionale në qershor 2011. Është ndryshuar ligji për investimet e huaja direkte për t'iu dhënë investitorëve të huaj mbrojtje të posaçme, me disa kushte të caktuara, në rast mosmarrëveshjesh për pronësinë e tokës. Megjithatë, impakti që ka te investimet e huaja nuk mund të vlerësohet, sepse legjislacioni i ri ende nuk po zbatohet në praktikë.

Janë bërë disa përparime në procedurat e falimentimit, me miratimin e legjislacionit për ngritjen e Agjencisë së Mbikëqyrjes së Falimentimit. Megjithatë, ende nuk është funksionale. Gjatë vitit 2010 janë dorëzuar rreth 130 deklaratime falimentimi, nga të cilat 75% janë analizuar dhe vetëm 6 janë pranuar që të ndjekin procedurën e falimentimit. Në tërësi, janë bërë disa përparime me hyrjen në treg. Megjithatë, procedurat e falimentimit mbeten të ngadalta.

Sistemi juridik

Edhe pse janë marrë disa nisma për legalizimin e pronave dhe regjistrimin e të drejtave të pronësisë në zonat bregdetare dhe urbane, ende nuk është miratuar një strategji gjithëpërfshirëse dhe një plan veprimi për të adresuar çështjen e tejzgatur të të drejtave të pronësisë. Mungesa e sigurisë e të drejtës së pronës dhe zbatimi i dobët i shtetit ligjor mbeten shqetësuese. Për më tepër, komuniteti i biznesit vazhdon të përballet me vonesa në procedurat gjyqësore, si dhe me ekzekutimin e dobët të kontratave dhe kolateralit. Vazhdojnë të jenë të përhapura metodat informale të ekzekutimit të kontratave, duke anashkaluar sistemin juridik. Janë marrë nisma për të ngritur përmbartimin privat, por trajnimi dhe kapacitetet administrative mbeten të dobëta. Përveç kësaj, vonesa e ngritjes së gjykatës administrative nga mungesa e konsensusit politik, vazhdon të jetë pengesë për investimet.

Përparim është arritur në fushën e reformës rregullatore dhe forcimin e institucioneve mbikëqyrëse. Në vitin 2010, qeveria miratoi një sistem për Vlerësimin e Ndikimit Rregullator që synon të forcojë efikasitetin dhe efektivitetin e vendimmarrjes rregullatore. Zbatimi gradual i një versioni të thjeshtuar të Vlerësimit të Ndikimit Rregullator pritet të fillojë në 2011, dhe më pas do të merret vendimi nëse do të kalohet në një sistem të plotë nga viti 2013. Në qershor 2011 u miratua ligji i ri për inspektimin që hodhi themelet për ristrukturimin e inspektorateve. *Në tërësi*, dobësitë e shtetit ligjor dhe korrupsioni i përhapur vazhdojnë të ndikojnë negativisht në mjedisin e biznesit.

Zhvillimi i sektorit financiar

Sistemi financiar mbetet i dominuar nga sektori bankar që përbën rreth 95% të aktiveve totale të sistemit. Pavarësisht dominimit të bankave, huadhënia bankare për sektorin privat dhe familjarët në vitin 2010 ishte i ulët, 38.7% të PBB, por me rritje nga 37.5% vitin pararendës, gjë që tregon se ka hapësirë të madhe për ndërmjetësim financiar. Sektorin bankar mbetet i mirëkapitalizuar, ku raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit në fund të vitit 2010 arriti në 15.4% dhe pësoi rënie të lehtë në 14.8% në tremujorin e dytë të 2011, ndjeshëm më lart se minimumi ligjor i BSh-së prej 12%. Përfitueshmëria e sektorit bankar gjatë vitit 2010 ishte pozitive, por treguesit e përfitueshmërisë u përkeqësuan në tremujorin e parë të 2011. Ndërkohë që provigjonet janë rregulluar siç duhet, niveli i kredive me probleme (NPL) mbetet shqetësim për sektorin bankar. Në fund të vitit 2010, kreditë me probleme vlerësohet se përbënin 13.6% të totalit të kredive, përqindje kjo që u rrit ndjeshëm në 16.6% në tremujorin e dytë të 2011.

Shqetësimet nga përkeqësimi i cilësisë së portofolit të kredive dhe rënia e kërkesës së brendshme, i shtynë bankat të mos zgjerojnë huadhënien. Rritja e kreditimit ngadalësoi dhe ra në 8.6% në 2010 nga 20.5% vitin pararendës. Portofoli i kredive për sektorin privat u rrit në 10.6% në vitin 2010, i orientuar kryesisht drejt biznesit, ndërsa kreditimi për familjet mbeti pothuaj i pandryshuar si në vitin 2009. Rritja e kreditimit u rrit lehtë në tremujorin e parë të 2011 de ishte 12.5% në qershor. Normat e interesit të bankave tregtare për huat e biznesit dhe konsumatore vazhduan të udhëhiqen nga interesi që paguhet për letrat me vlerë të emetuara nga qeveria. Pas tërheqjeve të mëdha në vitin 2009, rritja e depozitave rifilloi gjatë vitit 2010 duke arritur mesatarisht 15.5% për të gjithë vitin, për shkak se besimi publik në sistemin bankar u konsolidua gradualisht, sidomos në gjysmën e dytë të vitit. Në gjysmën e parë të 2011, rritja e depozitave ishte 15.8% në bazë vjetore. Huamarrja e jashtme e sektorit bankar arriti 4.9% në fund të vitit 2010 dhe u rrit në 6.4% deri në korrik 2011. *Yield*-i mesatar i bonove të thesarit 12-mujore ishte 7.2% në fund të vitit 2010 - duke shënuar rënie nga 9.2% vitin pararendës - dhe u rrit në 7.7 në gusht 2011.

Stress-test-et periodike të Bankës së Shqipërisë tregojnë impaktin e moderuar të riskut direkt të normës së interesit, për shkak se pozicioni i hapur valutor i sektorit bankar është i ulët. Në lidhje me riskun e likuiditetit, sektori bankar duket se gëzon një situatë likuiditeti shumë të mirë për operacionet në monedhën vendase, ndërsa operacionet në euro kërkojnë monitorim konstant. *Në tërësi*, sektori bankar vazhdon të jetë i mirëkapitalizuar dhe likuid. Megjithatë, niveli i lartë i kredive me probleme është çështje shqetësuese.

3.2. Aftësia për të përballuar presionet e konkurrencës dhe forcat e tregut brenda BE-së

Ekzistenca e ekonomisë së tregut funksionale

Është ruajtur stabiliteti makroekonomik. Rritja e PBB-së është përshpejtuar, por mbeti nën mesataret historike. Pritshmëria e inflacionit mbeti e ankoruar dhe deficitet buxhetorë është ulur. Megjithatë, borxhi publik mbetet relativisht i lartë. Programi i privatizimeve të planifikuara ka pasur vonesa, ritmi i reformave për lehtësimin e hyrjes dhe nga tregu ka ngadalësuar dhe shteti i së drejtës vazhdon të ketë dobësi, sidomos në lidhje me ekzekutimin e kontratave dhe të drejtave të pronësisë. Imbalancat strukturore në tregun e punës dhe në llogarinë e jashtme mbeten të larta. *Në tërësi*, edhe pse janë bërë disa përpjekje për reformim të një ekonomie tregu funksionale, Shqipëria duhet të ndër marrë reforma strukturore të mëtejshme, ku, mes të tjerash, duhet të forcojë sundimin e politikave ekonomike, të përmirësojë performancën e tregut të punës dhe të mbrojë të drejtat e pronësisë.

Kapitali njerëzor dhe fizik

Gjatë vitit 2010, shpenzimet buxhetore për arsimin ishin rreth 3.4% të PBB. Buxheti për 2011 është parashikuar të jetë 3% i PBB. Shpenzimet në sektorin e arsimit gjatë vitit 2011 synojnë të përmirësojnë cilësinë e përgjithshme të shërbimit në të gjitha nivelet e arsimit, me fokus të veçantë teknologjinë e informacionit dhe përshtatjen më të mirë të arsimit profesional me kërkesat e tregut. Në buxhetin e vitit 2011, shpenzimet publike për kërkimin shkencor dhe zhvillimin zënë 0.05% të PBB. Me gjithë përpjekjet e qeverisë për ta konsideruar arsimin dhe shëndetësinë si sektorë prioritarë, vazhdon të ketë mungesa punëtorësh të kualifikuar si rezultat i mangësive të sistemit arsimor dhe profesional. TIK është futur në programin mësimor të 17 shkollave profesionale dhe teknike. Disa përmirësime janë bërë nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit në përmirësimin e sistemit të informimit për vendet vakante të punës. Instrumenti 'Brain Gain' që u jep bonuse nëpunësve publike të shkolluar jashtë shtetit, është pezulluar për shkak të shkurtimeve në buxhet në korrik 2011.

Investimet në 2009 ishin 36.8% e PBB-së, pak më poshtë sesa 38.2% në 2008. Investimet e sektorit privat ishin sa 27.2% e PBB-së. Flukset hyrëse të IHD janë shtuar me rreth 17% në 2010, ose me 8.8% të PBB-së, duke pasqyruar rritjen e investimeve, kryesisht në sektorin e hidrokarbureve. Investimet publike u përqendruan në infrastrukturën rrugore. Ka filluar ndërtimi i një segmenti të ri rrugor Tiranë-Elbasan me vlerë rreth 270 milion euro, i financuar kryesisht me hua të buta nga Institucionet Financiare Ndërkombëtare (IFN). Transporti hekurudhor ka mbetur i nënzhvilluar. Nevojiten investime të mëtejshme për të përmirësuar infrastrukturën dhe logjistikën, me qëllim që të tërhiqen investitorë dhe të stimulohet turizmi. Mirëmbajtja rrugore e pamjaftueshme dhe ndërtimet e paligjshme përgjatë rrugëve janë çështje shqetësuese. Në sektorin energjetik, janë miratuar disa marrëveshje koncesioni për ndërtimin dhe shfrytëzimin e hidrocentraleve, dhe humbjet në shpërndarje janë ulur lehtë në total. Megjithatë, arkëtimi mbetet i ulët në rreth 77%. *Në tërësi*, shpenzimet për kapitalin njerëzor dhe fizik janë rritur. Megjithatë, duhen investime të mëtejshme për të përmirësuar konkurrueshmërinë e ekonomisë.

Struktura sektoriale dhe e ndërmarrjeve

Përqindja relative kundrejt PBB-së e bujqësisë, industrisë dhe shërbimeve mbeti në 2010 pothuaj njësoj si vitet e kaluara, ku pothuaj 3/5 e PBB-së është gjeneruar nga sektori i shërbimeve. Bujqësia zuri 19% të PBB-së, por mbetet sektori më punëdhënës me 55% të punësimit total në tremujorin e dytë 2011. Kontributi i ndërtimit në PBB ra në 11% në 2010 nga 14.4% në 2009, ndërsa kontributi i industrisë u rrit në 11% në 2010 nga 9.5% vitin pararendës. Industria e përpunimit të brendshëm pati performancë të mirë gjatë vitit 2010, duke rritur eksportet e veta krahasuar me 2009.

Politikat e dobëta tatimore dhe të shpenzimeve si dhe zbatimi i dobët i ligjit, përfshi luftën kundër korrupsionit, nxisin sektorin e konsiderueshëm informal. Gjatë vitit janë marrë disa nisma për të adresuar informalitetin, si vendosja e detyrimit që taksapaguesit e mëdhenj të deklarojnë taksat *online* dhe instalimi i kasave. Megjithatë, ritmi është i ngadaltë përderisa pothuaj vetëm gjysma e bizneseve kanë instaluar kasa deri tani. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme vazhdojnë të përfitojnë fonde nga një skemë kreditimi e financuar nga qeveria italiane. Deri në dhjetor 2010, 49 biznese kanë përfituar afërsisht 11 milion EUR nga kjo skemë. Në prill 2011, qeveria nënshkroi një marrëveshje me 6 banka tregtare që u lehtëson bizneseve aksesin në një skemë garantimi të kredive me vlerë 2.5 milion EUR. Që nga nëntori 2010, në regjistrin e kreditimit janë shtuar 5 institucione mikro-kreditimi.

Për industrinë në rrjet, norma e lartë e humbjeve në sistemin e shpërndarjes të energjisë elektrike mbetet sfidë persistente për furnizimin me energji. Licenca e dytë 3G u shit në shtator 2011. Kompania e katërt celulare filloi funksionimin gjatë 2010. Çmimet në këtë sektor përcaktohen nga autoriteti rregullator, dhe në mars 2011 hyri në fuqi një skemë e rishikuar për uljen e tarifave, me synim rregullimin e çmimeve të tregut. *Në tërësi*, nuk ka ndryshime domethënëse në strukturën e ekonomisë. Edhe pse janë marrë disa masa për të luftuar sektorin e konsiderueshëm, informaliteti mbetet akoma sfidë.

Ndikimi i Shtetit në konkurrueshmëri

Subvencionet në 2010 ranë në 0.3% të PBB, kundrejt 0.4% në 2009. Ndërkohë që nuk jepet asistencë financiare specifike për shoqëritë tregtare, subvencionet aplikohen në një numër të kufizuar sektorësh, konkretisht në hekurudha dhe furnizim me ujë. Ndihma shtetërore që i është dhënë sektorit energjetik ka pësuar rënie nga viti 2009. *Në tërësi*, ndërhyrja e shtetit mbetet e kufizuar.

Integrimi ekonomik në BE

Hapja e ekonomisë shqiptare vazhdoi të rritet. Në vitin 2010, shuma e importit dhe eksportit të mallrave e shërbimeve ishte pak mbi 86% të PBB-së, në rritje krahasuar me 82% në 2009. Totali i tregtisë së jashtme të mallrave dhe shërbimeve u rrit me 12% në 2010, kundrejt 1.5% në 2009. Si importi (7%) edhe eksporti (21%) i mallrave dhe shërbimeve u rritën me ritëm më të shpejtë sesa në 2009. BE mbetet partneri tregtar kryesor i Shqipërisë duke zënë rreth

3/4 të eksportit dhe importit në 2010, ku Italia dhe Greqia përbëjnë 70% të vëllimit tregtar total. Në tërësi, BE mbetet partneri kryesor i tregtisë dhe i investimeve i Shqipërisë gjatë vitit 2010. Tregtia me vendet CEFTA është rritur. Megjithatë, baza e prodhimit është përqendruar në pak sektorë me vlerë të shtuar të ulët dhe tregje eksporti, duke e lënë ekonominë vulnerabël ndaj tronditjeve specifike.

4. AFTËSIA PER TE MARRË PËRSIPËR DETYRIMET E ANËTARËSIMIT

Ky seksion merr në shqyrtim aftësinë e Shqipërisë të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit, që do të thotë ato të *acquis*-së si shprehet në Traktate, të akteve nënligjore dhe politikave të Bashkimit. Gjithashtu, analizon kapacitetin administrativ të Shqipërisë për të zbatuar *acquis*-në. Analiza ndahet sipas listës së 33 kapitujve të *acquis*-së. Në çdo sektor, vlerësimi i Komisionit trajton përparimin e arritur gjatë periudhës raportuese dhe bën një përmbledhje të nivelit të përgjithshëm të përgatitjes së vendit.

4.1. Kapitulli 1: Lëvizja e lirë e mallrave

Nuk ka zhvillime të raportuara në lidhje me **parimet e përgjithshme**.

Për sa i përket **masave horizontale**, ka pasur zhvillime pozitive në kuadrin legjislativ për akreditimin dhe standardizimin.

Drejtoria e Përgjithshme e *Standardizimit* (DPS) ka vazhduar përgatitjet për të aplikuar për anëtarësim të plotë në Komitetin Europian të Standardizimit (CEN) dhe në Komitetin Europian për Standardizim Elektroteknik (CENELEC) në vitin 2012. Miratimi i standardeve europiane (ENs) si standarde shqiptare vazhdoi të përparojë. Numri i ENs të miratuara është 17 442, brenda objektivit të normës së miratimit prej 95% të vendosur për vitin 2011. Megjithatë, numri i standardeve të përkthyer mbetet i ulët në krahasim me numrin e standardeve të miratuara, pasi shumica e ENs janë miratuar me metodën e faqes së parë.

Ligji për standardizimin u ndryshua në shkurt 2011 që të bëhej i mundur botimi dhe miratimi i standardeve të përgatitura nga Instituti Europian i Standardeve të Telekomunikacionit (ETSI). Është krijuar bordi drejtues për standardizimin që filloi të funksionojë normalisht në nëntor 2010. Që atëherë, ai ka zhvilluar dy mbledhje dhe ka marrë vendimet e tij të para, p.sh. për rregulloren e brendshme dhe planin e punës, si edhe për organizimin dhe funksionimin e Forumit Kombëtar të Standardizimit.

Nuk ka pasur zhvillime legjislative në lidhje me *vlerësimin e konformitetit*. Ligji për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve joushqimore ende nuk është në linjë me *acquis*. Përdorimi i shënjitimit CE në rastet kur nevojitet vlerësimi i konformitetit i palëve të treta, nuk është në linjë me *acquis*.

Në fushën e *akreditimit*, janë akredituar tre trupa të rinj të vlerësimit të konformitetit (TVK). Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA) ka akredituar 16 TVK në total. DPA ka rishikuar dokumentacionin në lidhje me sistemin e menaxhimit të cilësisë, me qëllim që të reflektojë konstatimet e vlerësimit që bëri EA (Bashkëpunimi Europian për Akreditimin) në vitin 2010. Bordi Këshillimor i Akreditimit ka filluar të funksionojë normalisht. Gjatë 2010, DPA mbështeti organizimin e testeve të zotësisë në fushën e produkteve të ndërtimit, meqenëse numri më i madh i laboratorëve të akredituar janë laboratorë testues të kësaj fushe. Janë krijuar dy komitete të reja teknike: komiteti teknik i laboratorëve dhe komiteti i inspektimit dhe certifikimit. Megjithatë, nuk ka zhvillime në lidhje me ndryshimin e ligjit ekzistues për akreditimin për ta sjellë në linjë me *acquis* horizontale të vitit 2008.

Është ngritur një qendër rajonale e *metrologjisë* në Lezhë, e cila filloi të funksionojë nga gjysma e dytë e vitit 2010, por Qendra Kombëtare e Metrologjisë në Tiranë ende nuk është funksionale. Transpozimi i Direktivave të Përqasjes së Re për instrumentet peshuese joautomatike dhe instrumenteve matëse joautomatike pritet ende të realizohet.

Janë shënuar disa përparime për sa i përket *mbikëqyrjes së tregut*. Janë shtuar aktivitetet e mbikëqyrjes së tregut (kryesisht për lodrat, pajisjet elektrike, tekstilet dhe veshjet për këmbën) dhe produktet e rrezikshme janë hequr nga tregu. Me hyrjen në fuqi të ligjit të ri për Inspektoratin e Përgjithshëm në korrik 2011, po realizohet reforma që synon të krijojë një strukturë më të efektshme të mbikëqyrjes së tregut. Megjithatë, legjislacioni ekzistues nuk pasqyron plotësisht kërkesat e *acquis* horizontale.

Përparim është bërë në fushën e **legjislacionit të produkteve të ‘Përqasjes së Vjetër’**. Ligji për plehrat kimike i marsit 2011 transponon pjesërisht *acquis*. Është miratuar legjislacion për farmakovigjilencën dhe për praktikën e mira të prodhimit në fushën e farmaceutikëve, përkatësisht në nëntor 2010 dhe janar 2011. Në korrik 2011 u miratuan aktet nënligjore me qëllim transpozimin e mëtejshëm në fushën e mjeteve motorike. Shqipëria miratoi legjislacionin për aderimin në Konventën UNECE për Rregulloret e Mjeteve Motorike të viteve 1958 dhe 1998.

Ka pasur përparim të kufizuar në përafrimin legjislativ me *acquis* në fushën e **legjislacionin e produkteve të ‘Përqasjes së Re dhe të Vjetër’**. Janë miratuar rregullore teknike për teleferikët për transport njerëzor, për pajisjet radiofonike dhe për pajisjet terminale të telekomunikacionit, si edhe është rishikuar ligji për përdorimin civil të lëndëve plasëse.

Në fushën e **masave procedurale**, nuk ka përparim të raportuar për harmonizimin e legjislacionit me *acquis* për kthimin e objekteve kulturore dhe për armët e zjarrit për përdorim civil.

Përfundim

Janë bërë përparime në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave, veçanërisht me miratimin e standardeve EN si standarde shqiptare dhe krijimin e bordit drejtues të standardizimit. Duhet përparime të mëtejshme për të harmonizuar legjislacionin shqiptar me direktivat e Përqasjes së Re dhe të Vjetër, për të harmonizuar legjislacionin horizontal me *acquis*, si edhe për të krijuar

infrastrukturën adekuatë të mbikëqyrjes së tregut. Në tërësi, përgatitjet në këtë fushë kanë avancuar në masë të moderuar.

4.2. Kapitulli 2: Liria e lëvizjes së punëtorëve

Nuk është bërë përparim për sa i përket **aksesit në tregun e punës**. Ligji për të Huajt nuk është ndryshuar siç ishte planifikuar për vitin 2011, për t'iu dhënë përparësi qytetarëve të BE-së në lidhje me kërkesën në tregun e punës. Legjislacioni shqiptar në këtë fushë nuk është në linjë me *acquis*.

Nuk është bërë përparim me përgatitjet për pjesëmarrjen në rrjetin **EURES** (Sistemi Europian i Shërbimeve të Punësimit).

Është bërë përparim i kufizuar për sa i përket **koordinimit të sistemeve të sigurimeve shoqërore**. Marrëveshja dypalëshe me Turqinë për sigurimet shoqërore vazhdon të zbatohet dhe janë duke u zhvilluar negociatat për marrëveshje të tjera me Hungarinë, Belgjikën dhe ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Shqipëria ka përmirësuar menaxhimin e sistemit të sigurimeve shoqërore. Është krijuar databaza e pensioneve dhe databaza e kontributeve për të vetëpunësuarit në bujqësi dhe personat e siguruar vullnetarisht; po kështu, po realizohet administrimi elektronik i kontributeve mujore dhe llogarive personale të kontribuuesve; gjithashtu, është krijuar një databazë e kontribuuesve të qytetit dhe një databazë për periudhat kur janë siguruar personat që kanë punuar në ish-kooperativat bujqësore.

Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor ende nuk ka planifikuar një strategji për futjen e **Kartës Europiane të Sigurimit Shëndetësor** pas aderimit.

Përfundimi

Është bërë përparim i pakët në lidhje me lirinë e lëvizjes së punëtorëve. Janë bërë përpjekje për koordinimin e sistemeve të sigurimeve shoqërore. Megjithatë, Shqipëria duhet të ndryshojë legjislacionin për sa i përket aksesit në tregun e punës. Nuk kanë filluar përgatitjet për EURES dhe për Kartën Europiane të Sigurimit Shëndetësor. Në tërësi, përgatitjet në fushën e lirisë së lëvizjes së punëtorëve janë në fazë të hershme.

4.3. Kapitulli 3: E drejta e vendosjes dhe liria e ofrimit të shërbimeve

Përparimi në lidhje me **të drejtën e vendosjes** ka qenë i kufizuar në thjeshtimin e procedurave të regjistrimit dhe licencimit. Legjislacioni dhe procedurat nuk janë diskriminuese për sa i përket operatorëve të huaj apo degëve të tyre.

Nuk ka përparim të raportuar **në lirinë e ofrimit të shërbimeve ndërkufitareve**. Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës është ngarkuar me koordinimin ndërministror për

transpozimin e Direktivës së Shërbimeve. Megjithatë, përgatitjet janë në fazë paraprake, përfshi zhvillimin e kapaciteteve të nevojshme institucionale.

Ka pasur disa përparime në fushën e **shërbimeve postare**. Këshilli i Ministrave miratoi një rregullore e cila përcakton procedurat për dhënien e licencave të përgjithshme, përmbajtjen e këtyre licencave dhe kushtet për ndryshimin, pezullimin ose anulimin e tyre. Gjithsesi, pritet të miratohet një strategji postare dhe një vendim për përcaktimin e tarifave dhe peshën e shërbimeve të rezervuara për operatorin publik postar. Nuk është ngritur ende departamenti rregullator për shërbimet postare pranë Agjencisë së Komunikimeve Elektronike dhe Postare që është organi rregullator kombëtar, dhe kjo pengon ndarjen efektive të funksioneve rregullatore nga funksioni politikëbërës në sektorin postar.

Ka pasur disa zhvillime legjislative në fushën e **njohjes së ndërsjellë të kualifikimeve profesionale**. Qeveria miratoi dispozita administrative për provimet e detyrueshme shtetërore për profesionet e rregulluara sipas *acquis* të doktorit, dentistit, farmacistit, infermierit, mamisë, veterinerit dhe arkitektit. Agjencia Kombëtare e Provimeve e themeluar në dhjetor 2010 dhe që vepron nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, është përgjegjëse për organizimin dhe monitorimin e këtyre provimeve. Profesionistët plotësisht të kualifikuar nga vendet e huaja janë të përjashtuar nga provimet dhe kanë të drejtë të ushtrojnë profesionin e tyre në Shqipëri në përputhje me kuadrin e zbatueshëm ligjor dhe nën të njëjtat kushte si shtetasit shqiptarë.

Përfundim

Legjislacioni dhe procedurat në fushën e të drejtës së vendosjes nuk janë diskriminuese ndaj operatorëve të huaj apo të degëve të tyre. Janë hartuar rregullat që lehtësojnë njohjen e ndërsjellë të kualifikimeve profesionale. Gjithsesi, transpozimi i Direktivës së Shërbimeve, përfshi zhvillimin e kapaciteteve adekuate administrative, mbetet në fazë të hershme. Në sektorin postar janë të nevojshme përpjekje të mëtejshme për të siguruar kapacitetet rregullatore, të pavarura nga politikëbërja. Në tërësi, përgatitjet nuk janë shumë të avancuara, veçanërisht në fushën e lirisë për të ofruar shërbime ndërkufitare.

4.4. Kapitulli 4: Lëvizja e lirë e kapitalit

Nuk është bërë përparim në fushën e **lëvizjes së kapitalit**. Dispozitat që rregullojnë blerjen e pasurive të paluajtshme nga të huajt mbetën të pandryshuara dhe pasiguria në lidhje me të drejtat e pronësisë vazhdon të dekurajojë investimet.

Ligji për investimet e huaja u ndryshua për t'i dhënë investorëve të huaj mbrojtje të posaçme, por sipas disa kushteve të caktuara, ndaj dëmtimeve potenciale nga pretendimet e pronësisë në fushat e infrastrukturës publike, turizmit, energjetikës dhe bujqësisë. Megjithatë, impakti i investimeve të huaja nuk mund të vlerësohet, meqenëse legjislacioni i ri nuk është zbatuar ende në praktikë.

Përparim i kufizuar është bërë në lidhje me **sistemet e pagesave**. Banka e Shqipërisë (BSh) krijoi një grup pune që të analizojë masat e përafrimit legjislativ, përfshi dispozitat për pagesat ndërkufitare. Banka e Shqipërisë ka miratuar rregulloren për funksionimin e sistemit të pagesave ndërbankare me vlerë të madhe (AIPS) dhe funksionimin e sistemit të klerimit të pagesave me vlerë të vogël (AECH), me qëllim që të promovojë pagesat jo në *cash*, duke përcaktuar komisionet e bankës dhe duke shtuar seancat e klerimit të pagesave. Në lidhje me pagesat elektronike, volumi i pagesave nëpërmjet AIPS pati rritje krahasuar me vitin 2010, por si vlerë transaksionesh pësoi ulje të lehtë. Rritje shënuan si volumi i pagesave ashtu edhe vlera e transaksioneve të kryera nëpërmjet AECH. Numri i kartave të kreditit dhe debitit në qarkullim vazhdoi të rritet, duke arritur në 712 575 karta në gjysmën e parë të 2011, nga të cilat 96% janë karta debiti. Megjithatë, 95% e transaksioneve me kartë janë tërheqje parash, që tregon se ekonomia shqiptare bazohet akoma gjerësisht në *cash*. Nuk ekziston një sistem ankimi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet klientëve dhe ofruesve të shërbimit me pagesë, por ekzistojnë disa mekanizma për arbitrazh jashtëgjyqësor. Nuk është bërë përparim në lidhje me krijimin e Ombudsmanit të Bankave të rekomanduar nga Autoriteti i Konkurrencës.

Disa përparime janë bërë në **luftën kundër pastrimit të parave**. Ligji i ndryshuar kundër pastrimit të parave që përfshin rekomandimet e MONEYVAL-it, hyri në fuqi në prill 2011. Ligji i ri hedh themelet për rritjen e aftësisë për të diktuar transaksionet e dyshimta bankare. Gjithashtu, ligji adreson çështjet që lidhen me kujdesin e duhur ndaj klientit (due diligence), personat e ekspozuar politikisht, rregullat e trasfertave me tel, shoqëritë tregtare e profesionet e caktuara jofinanciare, bankat fantazmë dhe transaksionet e pazakonta. Megjithatë, Kodi Penal nuk është ndryshuar akoma për të pasqyruar rekomandimet e MONEYVAL-it në lidhje me financimin e terrorizmit dhe pastrimin e parave. Njësia e Inteligjencës Financiare ka vazhduar të përforcojë bashkëpunimin me Prokurorinë, Policinë e Shtetit dhe Shërbimin Informativ Shtetëror. Megjithatë, duhen përpjekje të mëtejshme që të përforcohet bashkëpunimi ndërinstytucional, kapaciteti analitik, mjetet TI dhe ekspertiza e të gjitha institucioneve të përfshira në luftën kundër pastrimit të parave dhe krimit financiar. Raportimi i transaksioneve të dyshimta pati rritje të lehtë (13%), por numri i raportimeve nga sektori bankar dhe jobankar për transaksionet e dyshimta mbetet i ulët dhe cilësia e tyre kërkon vëmendje të mëtejshme. Ndjekjet penale dhe masa e dënimeve mbetet e ulët, dhe duhen përpjekje të mëtejshme për zbatimin e Strategjisë kombëtare për luftën kundër pastrimit të parave dhe krimit financiar, përfshi forcimin e kuadrit ligjor ekzistues. Duhet përpjekje të mëtejshme për të përmirësuar performancën kombëtare kundër pastrimit të parave dhe parandalimit të financimit të terrorizmit, duke zbatuar dispozitat e Konventës së Këshillit të Europës për Pastrimin, Kërkimin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimit dhe për Financimin e Terrorizmit. Statistikat për aplikimin e këtyre dispozitave janë të pamjaftueshme.

Përfundim

Janë bërë disa përparime në lidhje me kuadrin legjislativ të sistemeve të pagesave dhe luftës kundër pastrimit të parave. Megjithatë, zbatimi i efektshëm i Strategjisë kombëtare për luftën kundër pastrimit të parave dhe krimit financiar kërkon përpjekje të mëtejshme dhe rritje të

bashkëpunimit ndërinstytucional. *Në tërësi*, përgatitjet në fushën e lëvizjes së lirë të kapitalit kanë avancuar në masë të moderuar.

4.5. Kapitulli 5: Prokurimi publik

Nuk ka pasur përparim në lidhje me **parimet e përgjithshme**. Nuk ka pasur zhvillime të mëtejshme në përafrimin me standardet e BE-së të sistemit të koncesioneve, mekanizmave të mbrojtjes së prokurimit dhe mekanizmave të shqyrtimit.

Ka pasur disa përparime në fushën e **dhënies së kontratave publike**. Dhënia e kontratave për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit të financuara nga fondet publike është përfshirë në kuadrin legjislativ të prokurimit publik. Megjithatë, Ligji për Koncesionet nuk përfshin dispozita për dhënien me koncesion të punimeve dhe shërbimeve dhe nuk arrin të bëjë një dallim të qartë ndërmjet koncesioneve dhe kontratave të tjera publike. Procedurat e dhënies së koncesioneve kanë vazhduar të bazohen në propozime të pakërkuara. Dispozitat që përcaktojnë ofertat e ulëta anormale nuk janë në linjë me *acquis*. Kjo, bashkë me detyrimin për të bërë publik fondin limit nga autoriteti kontraktues, ngushton fushën për procedura konkurruese të përzgjedhjes së fituesit.

Ka pasur përparim në fushën e **masave korrigjuese**. Këshilli i Ministrave ka miratuar vendime për funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe në lidhje me rishikimin e procedurave të ankimit dhe përcaktimin e pagesës së tarifave.

Agjencia e Prokurimit Publik (APP) ka mjete të kufizuara për të mbikëqyruar respektimin e legjislacionit të prokurimit publik. Aktet nënligjore të parashikuara nga ligji i prokurimit publik për këtë qëllim nuk janë miratuar ende dhe numri aktual i stafit të APP-së nuk i mundëson të kryejë detyrat siç duhet. Ende nuk janë përcaktuar qartë rolet dhe përgjegjësitë e të gjitha institucioneve të përfshira në prokurimin publik (APP, Komisioni i Prokurimit Publik dhe Avokati i Prokurimeve). Përqindja e procedurave jokonkurruese dhe jotransparente vazhdon të jetë e lartë.

Përfundim

Kuadri ligjor për prokurimin publik dhe koncesionet nuk është plotësisht në linjë me *acquis*. Kërkohen përpjekje për të forcuar kuadrin institucional si dhe për të përcaktuar dhe ndarë qartë kompetencat e secilit institucion të prokurimit publik, në mënyrë që të shmanget mbivendosja e detyrave dhe të adresohen boshllëqet e mbetura në sistem. Nuk ka ende një sistem gjithëpërfshirës për monitorimin dhe kontrollin të zbatimit të rregullave dhe kontratave të prokurimit publik. *Në tërësi*, përgatitjet në fushën e prokurimit publik kanë avancuar në masë të moderuar.

4.6. Kapitulli 6: E drejta e shoqërive tregtare

Nuk ka pasur përparim në fushën e **shoqërive tregtare** për sa i përket përafrimit të mëtejshëm të legjislacionit shqiptar me *acquis* për bashkimet ndërkufitare, për kërkesat e raportimit dhe dokumentacionit për bashkimet dhe ndarjet, si dhe për kërkesat e kapitalit minimal të regjistruar për shoqëritë tregtare publike me përgjegjësi të kufizuar.

Ka pasur përparim të kufizuar në lidhje zbatimin e nënshkrimit elektronik. Në shkurt 2011, Posta Shqiptare mori certifikatën e parë elektronike që mundëson identifikimin e dërguesit/marrësit, fshehtësinë, kriptimin dhe nënshkrimin digjital. Megjithatë, *në tërësi*, infrastruktura teknike është e mangët. Nuk është miratuar ende Kodi për Qeverisjen Korporative.

Progres i kufizuar është bërë në fushën e **kontabilitetit**. Ende nuk është bërë transpozimi i Direktivave të Katërt dhe të Shtatë të BE-së për të Drejtën e Shoqërive Tregtare. Stafi i Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit (KKK) ka marrë trajnim dhe KKK ka vazhduar fushatat e ndërgjegjësimit për zbatimin e auditimit dhe të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Megjithatë, kapacitetet inspektuese të KKK-së janë të pamjaftueshme për monitorimin e zbatimit të tyre.

Ka pasur përparim në fushën e **auditimit**. Bordi i Mbikëqyrjes Publike (BMP) për profesionin e audituesit miratoi Kodin e etikës për profesionistët auditues dhe rregulloren e brendshme të tij për kontrollin e cilësisë së auditimit të subjekteve të interesit publik. Gjithashtu, miratoi rregullore për hetimin dhe disiplinën dhe kontrollin e cilësisë për audituesit. Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar vazhdon të shërbejë si sekretariati teknik i Bordit dhe është angazhuar në hartimin e disa prej këtyre rregulloreve. Kërkohen përpjekje të mëtejshme që të rriten kapacitetet administrative, burimet dhe buxheti i BMP, me qëllim që të garantohet pavarësia e tij.

Përfundim

Ka pasur përparim të pakët në fushën e të drejtës së shoqërive tregtare. Kapacitetet e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit dhe pavarësia operationale e Bordit të Mbikëqyrjes Publike për profesionin e audituesit vazhdojnë të jenë të dobëta. *Në tërësi*, përgatitjet në fushën e të drejtës së shoqërive tregtare po avancojnë në masë të moderuar.

4.7. Kapitulli 7: Legjislacioni për pronësinë intelektuale

Nuk është shënuar sukses në lidhje me harmonizimin e *acquis në* fushën e **së drejtës të autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të**. Ligji i ri për të Drejtën e Autorit është ende në pritje të miratimit.

Nuk mund të raportohet përparim për sa i përket harmonizimit për **të drejtat e pronësisë industriale**. Nuk është mbledhur ende ndonjë takim ndërinstitucional për monitorimin e zbatimit të strategjisë kombëtare lidhur me zbatimin e ligjit për të drejtat e pronësisë industriale

(DPI).

Në lidhje me **sundimin ose zbatimin e ligjit**, përparimi ka qenë i kufizuar. Zyra Shqiptare për të Drejtën e Autorit (ZSHDA) zhvilloi fushata informuese nëpërmjet veprimtarive trajnuese për personelin e saj dhe për Agjencitë e Menaxhimit të Përbashkët, autoritetet shtetërore, përfshi administratën e tatimeve dhe doganave, policinë, Këshillin Kombëtar të Radio-Televizionit, gjyqësorin dhe prokurorinë.

Në nëntor 2010 u nënshkrua Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave (DPPM) me synim forcimin e bashkëpunimit. Sistemi për pranimin dhe përpunimin e aplikimeve për patentat, patentat e shpikjeve, dizenjove industriale, markave tregtare dhe treguesve gjeografikë tani bëhet automatikisht si rezultat i përmirësimit të TI në DPPM. Kapacitetet e DPPM-së duhet të forcohen për të siguruar më tej sistemin TI dhe për të rritur shërbimet *online*. Numri i personelit të DPPM-së nuk ka ndryshuar.

Numri i rasteve të shkeljes së ligjit të paraqitura në gjykatë është rritur, por ende është në nivel shumë të ulët. ZSHDA dhe zyrat rajonale duhet të ristrukturohen dhe forcohen, në pritje të miratimit të ligjit të ri për të drejtat e autorit dhe zbatimin e reformës së inspektorateve. Krijimi i një strukture të mbikëqyrjes së tregut që mbulon çështjet e DPI-së është duke pritur zbatimin e ligjit të ri për Inspektoratin e Përgjithshëm i cili hyri në fuqi në korrik 2011. Nevojiten ende përpjekje të konsiderueshme për të adresuar dobësitë kryesore në këtë sektor si për shembull kapacitetet e pamjaftueshme administrative, niveli i ulët i mbledhjes së gjobave, mungesa e eksperiencës së duhur si dhe kualifikimet ndërmjet gjyqësorit, në përgjithësi ndërgjegjësimi i pamjaftueshëm dhe zbatimi i ligjit. Shqipëria nuk arriti të plotësojë detyrimet e MSA-së, për të garantuar nga 1 dhjetori 2010 një nivel të mbrojtjes së të drejtave të pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare të njëjtë me atë të BE-së, përfshi zbatimin ose sundimin e ligjit.

Përfundim

Në tërësi, përparimi ka qenë i kufizuar në fushën e legjislacionit të pronësisë intelektuale dhe Shqipëria nuk arriti të plotësojë detyrimet e MSA-së në kohë. Nevojiten përpjekje substanciale për të adresuar mungesat e shumta të mbetura të cilat pengojnë zbatimin e ligjit me efektshmëri të të drejtave të pronësisë intelektuale dhe industriale. Përgatitjet nuk kanë avancuar shumë.

4.8. Kapitulli 8: Politika e konkurrencës

Janë bërë disa përparime në fushën **anti-kartel, përfshi bashkimet**. Qeveria miratoi akte normative për Procedurat e Hetimit, për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës (AK), për Marrëveshjet me Rëndësi të Vogël ("de minimis") dhe akte normative për përjashtimin në grup për marrëveshjet e transferimit të teknologjive, marrëveshjet për kërkimin dhe zhvillimin dhe marrëveshjet e specializimit. Këto akte janë të harmonizuara me *acquis* në të gjitha aspektet themelore. Parlamenti miratoi një rezolutë që detyron të gjitha organet

ekzekutive të konsultohen me Autoritetin e Konkurrencës kurdo që hartohet legjislacion parësor ose dytësor.

Nuk janë bërë përparime për sa i përket kapaciteteve administrative të AK-së. Vazhdon të ketë një staf prej 35 personash dhe kërkohen përpjekje për ta forcuar në raport me detyrat që i ngarkohen AK-së.

AK miratoi dy vendime për marrëveshjet anti-kartel dhe dy vendime për abuzimin me pozitën dominuese. AK vuri gjoba me vlerë rreth 245 500 euro për shkelje të rregullave të konkurrencës. Shtatë bashkime të propozuara i janë njoftuar AK-së që i ka autorizuar pa kushte. AK përfundoi hetimin në sektorët bankarë, farmaceutikë dhe energjetikë dhe i përcolli rekomandimet përkatëse qeverisë. Gjithashtu, AK filloi një hetim të thelluar në tregjet e bukës dhe në tregjet e ngarkim/shkarkimit dhe depozitave të gazit të lëngshëm natyror në objektet portuale.

Janë bërë disa përparime në fushën e **ndihmës shtetërore**. Komisioni i Ndhmës Shtetërore (KNSh) miratoi vendim për ndihmën shtetërore në favor të Postës Shqiptare si edhe Udhëzime për ndihmën shtetërore në sektorin postar, duke i sjellë politikat e shërbimeve postare më afër *acquis*. U revokua një vendim për subvencionimin e hekurudhave shqiptare, i cili u gjykua në mospërputhje me *acquis*. Nuk kanë nisur hetime *ex officio*. Harta rajonale e ndihmës shtetërore ende nuk është finalizuar.

Kapacitetet administrative të autoritetit të ndihmës shtetërore kanë mbetur po ato dhe kërkohen përpjekje për të forcuar sektorin e ndihmës shtetërore në raport me përgjegjësitë e tij. Pavarësia operationale *de facto* e Komisionit të Ndhmës Shtetërore kërkon monitorim të vazhdueshëm.

Përfundim

Shqipëria ka bërë përparim të moderuar në fushën e konkurrencës. Megjithatë, autoriteteve përgjegjëse u mungojnë kapacitetet administrative dhe nevojiten masa për të garantuar pavarësinë operationale të Komisionit të Ndhmës Shtetërore. Përgatitjet janë përgjithësisht në rrugën e duhur.

4.9. Kapitulli 9: Shërbimet financiare

Janë bërë disa përparime në fushën e **bankave dhe konglomerateve financiare**. Në dhjetor 2010, Banka e Shqipërisë miratoi legjislacion për riskun e bankave nga ekspozimi i lartë, për mjaftueshmërinë e kapitalit dhe për menaxhimin e riskut gjatë aktivitetit të institucioneve financiare jobankare. Këto zhvillime e çuan më përpara përafrimin legjislativ me *acquis*. Ligji i janarit 2011 për menaxhimin e riskut operacional e sjell kuadrin rregullator për bankat, degët e bankave të huaja, institucionet financiare jobankare, kursimet dhe shoqëritë e kreditit dhe bashkimet e tyre më afër *acquis* dhe praktikave të Bazelit për mbikëqyrjen dhe

menaxhimin e riskut operacional. BSh miratoi edhe rregulloren për menaxhimin e riskut të kredisë.

BSh ka vazhduar përpjekjet për të përmirësuar kapacitetet administrative, duke rritur numrin e punonjësve të Departamentit të Mbikëqyrjes nga 32 në 49 persona. Po rishikohen manualat për mbikëqyrjen e riskut bazuar në menaxhimin e riskut operacional.

Janë bërë disa përmirësime në sektorin financiar jobankar. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) miratoi disa rregullore për sipërmarrjet e investimeve kolektive.

AMF është zhvendosur në ambiente të reja, infrastruktura teknike është përmirësuar dhe stafi ka vazhduar të trajnohet. Megjithatë, disa anëtarë të Bordit të AMF-së qëndruan në post edhe pas përfundimit të mandatit të tyre. Gjithashtu, kapacitetet administrative të AMF-së janë të pamjaftueshme dhe kërkohet rekrutim stafi.

Janë bërë disa përpjarime në harmonizimin me *acquis* në fushën e **sigurimeve dhe pensioneve të punës**. AMF licencoi dy shoqëritë e para për menaxhimin e fondeve të pensioneve vullnetare. Është në proces licencimi i një shoqërie të tretë. AMF ka vazhduar përpjekjet për të përmirësuar kuadrin rregullator në fushën e pensioneve vullnetare, duke nxjerrë aktet nënligjore të ligjit për fondet e pensionit vullnetar.

Ligji për ekspertët kontabël të miratuar u ndryshua për ta bërë të zbatueshëm si për shoqëritë e sigurimeve, ashtu edhe për fondet e pensioneve. Janë bërë disa përpjarime në fushën e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit. Parlamenti miratoi ligje për të liberalizuar sigurimin e mjeteve motorike, duke i lejuar shoqëritë e sigurimit të vendosin vetë tarifatat e primeve. Përgatitjet për krijimin e Qendrës së Informimit të Sigurimit të Detyrueshëm kanë përpjaruar, dhe planifikohet të përdoret sistemi *bonus malus*. Rritje pozitive prej 4% është shënuar në tregun e sigurimeve dhe prania e huaj është rritur. Edhe tregu i pensioneve private po rritet, por mbetet ende i pazhvilluar.

AMF ka vazhduar përpjekjet për të forcuar mbikëqyrjen mbi tregun e sigurimeve, duke futur metodologjinë e mbikëqyrjes me fokus riskun, dhe duke përmirësuar zbatimin e Sistemit të Menaxhimit të Informacionit. Megjithatë, duhen përpjekje të mëtejshme në këtë fushë.

Nuk ka zhvillime të raportuara në **infrastrukturën e tregut financiar**.

Përpjarim i pakët është bërë në harmonizimin me *acquis* në lidhje me **tregjet e letrave me vlerë dhe shërbimet e investimit**. Në dhjetor 2010 rregullorja për afatat, kushtet dhe procedurat për autorizim të bankave si kujdestare të obligacioneve u miratua si legjislacion zbatues, pasi u miratua miratimit të Ligjit për obligacionet e qeverisë vendore.

Megjithatë, bursa e letrave me vlerë mbetet treg i pazhvilluar, pasi asnjë shoqëri tregtare nuk është e listuar në bursë. Nuk ka sistem shkëmbimi financiar shumëpalësh (MTF) dhe as rregulla specifike për to. Harmonizimi me direktivën Prospectus, me direktivën për tregjet e instrumenteve financiare (MiFID), me direktivën për abuzimin me tregut dhe me direktivën për sipërmarrjet e investimeve kolektive në letrat me vlerë të transferueshme (UCITS) janë në

fazë të hershme. Procedura e autorizimit nuk ka sistem për ankimin gjyqësor dhe nuk ka legjislacion për skemat e kompensimit të investitorit.

Përfundim

Janë bërë disa përpertime në fushën e shërbimeve financiare. Përpertime është bërë në përafrimin e legjislacionit me *acquis* në fushën e bankave, konglomerateve financiare, sigurimeve dhe pensione të punës. Megjithatë, sektori vazhdon të ketë kapacitete administrative të pamjaftueshëm për të zbatuar mbikëqyrjen e tregut dhe të legjislacionit. Nevojiten përpjekje të mëtejshme në lidhje me tregun e letrave me vlerë. Infrastruktura dhe legjislacionit për shërbimet e investimit janë në fazë të hershme. Në tërësi, përgatitjet kanë avancuar në masë të moderuar.

4.10. Kapitulli 10: Shoqëria e informacionit dhe media

Janë bërë disa përpertime në fushën e **komunikimeve elektronike dhe teknologjive të informacionit**. Agjencia e Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) miratoi një vendim për të rishikuar tarifat e telefonisë celulare në vitin 2015. Konkurrenca në tregun e telefonisë celulare është intensifikuar me futjen e një operatori të katërt. Përpertime janë bërë me futjen e disa garancive konkurruese si mbartja e numrit, dhe me vendimet për ofertat referencë të interkonjeksionit dhe për llogaritjen e kostove mesatare (LRIC). Përzgjedhja e operatorit dhe parazgjedhja do të zbatohet në vjeshtën e vitit 2011 për thirrjet ndërkombëtare dhe në 2012 për thirrjet e brendshme. Licenca e dytë UMTS/3G u dha në shtator 2011, por nuk është shpallur ndonjë kalendar për nxjerrjen e licencave të tjera (3G) për të shfrytëzuar të gjitha mundësitë e spektrit.

Megjithatë, reforma të rëndësishme të tilla si miratimi i ndryshimeve të Ligjit të vitit 2008 për komunikimet elektronike dhe akteve nënligjore ende nuk po realizohen. Për më tepër, aksesit hapur në rrjetin lokal (LLU) dhe ribalancimi i tarifave nuk është bërë. Liberalizimi i aksesit në spektër është i pamjaftueshëm. Nuk është dhënë asnjë licencë për shërbimet fikse pa tel (*wireless*). Ndërkohë që penetrimi i shërbimit celular është i lartë, tregjet për telefoninë fikse dhe brezin e gjerë (*broadband*) mbeten të zhvilluara nën potencialin real, krahasuar me standardet europiane dhe rajonale (që kanë penetrim përkatësisht 11% dhe 3.5%). Në të njëjtën kohë, planet dhe procesi i tenderimit për të ndërtuar një rrjet mbarëkombëtar të brezit të gjerë po krijojnë shqetësime për sa i përket fizibilitetit dhe konkurrencës. Kapacitetet administrative dhe burimet e AKEP-it mbeten të dobëta. Rrjedhimisht, zbatimi i pamjaftueshëm i rregullimit dhe pasiguria juridike vazhdojnë të jenë pengesë për krijimin e konkurrencës së efektshme.

Përpertime në fushë e **shërbimeve të shoqërisë së informacionit** kanë qenë jo i njëtrajtshëm. Rrjeti i infrastrukturës GovNet është përmirësuar dhe zgjeruar. Me licencimin e agjencisë së parë për dhënie të certifikatave elektronike në shkurt 2011, pranë Postës Shqiptare kanë filluar aplikimet për nënshkrimin elektronik. Është miratuar plani i rishikuar i veprimit për zbatimin e Strategjisë së shoqërisë së informacionit. Megjithatë, kapacitetet administrative

për të zbatuar politikat dhe legjislacionin në këtë fushë mbeten të dobëta. Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit vazhdon të ketë mungesë kapacitetesh administrative e teknike dhe burimesh njerëzore. Harmonizimi me direktivën e tregtisë elektronike (*e-commerce*) nuk është arritur plotësisht. Shqipëria po punon për të ndryshuar Ligjin për tregtinë elektronike me synim harmonizimin e plotë me Direktivën e Tregtisë Elektronike. Rregullimi i aksesit të kushtëzuar, komunikimit të pakërkuar dhe faturimit zë për zë janë të gjitha të parashikuara në Projektligjin për Shërbimet e Medias Audiovizuale që pret të miratohet. Shqipëria ende nuk ka miratuar një strategji për brezin e gjerë dhe norma e penetrimit të brezit të gjerë është e ulët.

Pak përparime janë bërë në fushën e **politikës audiovizuale**. Legjislacioni shqiptar është akoma pjesërisht i harmonizuar me standardet europiane për rregullimin e medias dhe me Direktivën e Shërbimeve të Medias Audiovizuale. Projektligji për Shërbimet e Medias Audiovizuale ende nuk është miratuar. Është ngritur shqetësimi që disa dispozita nuk janë në përputhje me standardet europiane të pavarësisë së autoritetit rregullator. Afati për kalimin në sistemin dixhital është shtyrë nga fundi i vitit 2012 në fund të 2015; deri tani nuk janë marrë masa konkrete për këtë kalim, si dhe nuk është miratuar ende strategjia e dixhitalizimit.

Këshillit Kombëtar i Radios dhe Televizionit vazhdon të mos ketë kapacitete të mjaftueshme administrative e teknike dhe ekzistojnë shqetësime lidhur me pavarësinë e tij. Transmetuesi publik ende nuk e ka rritur pavarësinë e tij redaksionale. Nuk ka pasur përparim në lidhje me miratimin e ndryshimeve në Kodin Penal që dekriminalizojnë shpifjen dhe fyerjen, gjë që kërkon shumicë të përforsuar prej 3/5 në parlament. Nuk është siguruar zbatimi i plotë dhe i efektshëm i ligjit ekzistues për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare.

Përfundim

Përparim në fushën e shoqërisë së informacionit dhe medias ka qenë jo i njëtrajtshëm. Janë marrë disa masa për të përmirësuar konkurrencën në tregun e komunikimeve elektronike, por ka shqetësime në lidhje me liberalizimin e tregut, përfshi menaxhimin e spektrit, si edhe për kapacitetet dhe pavarësinë e autoritetit rregullator kombëtar. Harmonizimi me *acquis* nuk ka përfunduar, sidomos në lidhje me tregtinë elektronike dhe aksesin e kushtëzuar. Për më tepër, ende nuk janë miratuar disa akte të rëndësishme legjislative, kryesisht në fushën e politikës audiovizuale dhe për përmirësimin e lirisë së medias. Kapacitetet për zbatimin e legjislacionit dhe të politikave mbeten të dobëta. Në tërësi, përgatitjet në fushën e shoqërisë së informacionit dhe medias po avancojnë ngadalë.

4.11. Kapitulli 11: Bujqësia dhe zhvillimi rural

Ka pasur përparime në çështjet **horizontale**.

Në 2010, rreth 7,5 milion euro u angazhuan për bujqësinë në *skemat e mbështetjes së drejtpërdrejtë*. Ndihmë u dha për prodhimet bimore dhe blegtorale, agro-përpunimin, makineritë bujqësore dhe ngritjen e fondit të garantimit të kredisë.

Janë miratuar rregulla për përmirësimin e administrimit dhe mbrojtjes së tokës. Ligji për përdorimin e tokave bujqësore të pakultivuara është miratuar. Përgatitjet për regjistrimin e tokës bujqësore që do të kryhet në 2012 janë në rrugën e duhur. Mbledhja e të dhënave për përfundimin e regjistrimit të tokës bujqësore ka vazhduar. Megjithatë, kadastra elektronike e tokës nuk është krijuar akoma, edhe regjistrat për fermat dhe kafshët ende nuk janë përfunduar. Duhet të zhvillohet më tej aksesi në shërbimet e kredisë dhe të këshillimit.

Vihet re përparim i vogël në lidhje me harmonizimin me **Organizatën e Tregut të Përbashkët**. Në fushën e **prodhimeve blegtorale**, janë futur masa për matjen dhe vlerësimin e prodhimeve si dhe metoda për vlerësimin e vlerave gjenetike për mbarështim të gjedhit, të të imtave dhe derrave. Përparim i mirë vërehet në **zhvillimin rural**. Është bërë përparim i mirë në ngritjen e strukturave për zbatimin e Programit IPA për Zhvillimin Rural (IPARD), ndarjen e detyrave në Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit Rural (ARDA) dhe kapacitetet e personelit janë përmirësuar. Si strategjia e zhvillimit rural dhe strategjia e bujqësisë dhe ushqimit duhet të përditësohen. Duhet të forcohen kapacitetet për kryerjen e analizës së politikave si dhe formulimi i politikave të zhvillimit rural.

Janë bërë disa përparime në fushën e **politikës së cilësisë**, sidomos me përgatitjet e autoriteteve për futjen dhe promovimin e treguesve gjeografikë.

Edhe pse, **mbarështimi organik** është subvencionuar nëpërmjet skemave të drejtpërdrejta, shumica e veprimtarive në sektor janë kryer nga financime donatore.

Përfundim

Në tërësi, janë bërë disa përparime në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural. Strukturat themelore zbatuese për programet e zhvillimit rural janë ngritur. Burimet financiare kanë vazhduar të akordohen me efekt pozitiv në produktet bujqësore dhe konkurrueshmërinë bujqësore. Megjithatë, kapacitetet për kryerjen e analizës së politikave dhe për formulimin e politikave zhvillimore rural mbeten të dobëta. Zbatimi i IPARD-it kërkon rol udhëheqës dhe zotërim të Ministrisë së Bujqësisë për të mundur përdorimin më të mirë të dijes si dhe mbështetjen teknike.

4.12. Kapitulli 12: Politika e sigurisë ushqimore, veterinare dhe fitosanitare

Disa përparime vihen re në **sigurinë e përgjithshme të artikujve ushqimorë**. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU) ka rritur ndjeshëm kapacitetin e punës së tij dhe ka shtrirë veprimtarinë në 12 qarqet e vendit. Megjithatë, përcaktimi i kompetencave ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (MBUMK) dhe AKU-së duhet të qartësohet dhe të vendoset një hierarki e qartë përgjegjësie. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ende nuk ka zhvilluar kapacitetet për vlerësimin e riskut, si edhe nuk është ngritur ende Komiteti Shkencor dhe Panelet.

Në **politikën veterinare** përparimi ka qenë i kufizuar. Është e nevojshme të miratohet një kuadër i ri ligjor për veterinarinë. Nuk janë qartësuar përgjegjësitë për shëndetin edhe mirëqenien e kafshëve ndërmjet MBUMK dhe AKU. Nuk ka ende një hierarki të unifikuar dhe përgjegjësitë mbeten të fragmentuara mes institucioneve të ndryshme. Niveli i personelit, në veçanti në nivelin qendror, vazhdon të jetë joadekuat. Në fushën e identifikimit dhe regjistrimit të kafshëve, pjesa më e madhe e gjedhit është e regjistruar dhe lëvizjet e tyre raportohen. Megjithatë, raportimi jo gjithmonë është i besueshëm dhe në kohën e duhur. Është duke u përpunuar databaza e harmonizuar e kafshëve (e cila përfshin gjithashtu databazën e shëndetit të kafshëve) dhe pritet të përmirësojë kohën e duhur të raportimit. Janë marrë disa masa përgatitore për regjistrimin e bagëtive të imta.

Mbeten të kufizuara kapacitetet për menaxhimin e transpozimit të legjislacionit të BE-së dhe zbatimit të programeve të çrrënjësjes së sëmundjeve, dhe për përcjelljen në kohë të informacionit. Për sa i përket **hedhjes në treg të ushqimit për kafshët dhe njerëzit dhe i nënprodukteve shtazore**, është miratuar Paketa e Higjienës së ushqimeve dhe është hartuar legjislacioni për higjienën e ushqimeve me qëllim për afrimin me *acquis*. Është përgatitur dokumentacioni teknik për të mbështetur kapacitetet e mjaftueshme të menaxhimit të riskut në lidhje me kontrollet zyrtare. Infrastruktura TI dhe databaza për regjistrimin elektronik të stabilimenteve ushqimore, regjistrimi i kontrolleve zyrtare, dhe aksesimi në Sistemin e Paralajmërimit të Shpejtë për Ushqimet për Njerëzit dhe për Kafshët është zhvilluar dhe testuar. Nevojitet të rekrutohet personel i specializuar për të kryer kontrollet zyrtare për ushqimin dhe higjienën ushqimore. Megjithatë, zbatimi i legjislacionit të miratuar është i dobët për shkak të mungesës së burimeve financiare për kontrollet zyrtare. Vetëm disa stabilimente në sektorët e mishit, peshkut dhe baxhove aplikojnë procedura HACCP (Analiza e Riskut dhe Kontrolli i Pikës Kritike) dhe vetëkontrolle. Kapacitetet e laboratorëve duhet të përmirësohen.

Ende nuk janë siguruar kapacitetet administrative për zbatimin e kontrolleve të mbetjeve pesticide në ushqimet për njerëzit dhe kafshët me origjinë bimore e shtazore, megjithëse legjislacioni përkatës është transponuar. Shtrirja e mëtejshme e AKU në fushën e mbrojtjes së shëndetit të bimëve planifikohet gjatë 2011.

Për sa i përket **rregullave të sigurisë ushqimore**, janë bërë disa përparime me miratimin e akteve nënligjore në fusha të ndryshme.

Përparim i kufizuar është arritur në sektorin **fitosanitar**. Përgjegjësia për shëndetin e bimëve i është caktuar AKU-së dhe për mbrojtjen e bimëve i është caktuar Drejtorisë për Politikën e Prodhimit të Drithërave.

Nuk është bërë përparim me transpozimin dhe zbatimin e *acquis* për organizmat gjenetikisht të modifikuar.

Përfundim

Në tërësi, janë bërë disa përparime si krijimi i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, regjistrimi i gjedhit, miratimi i rregullave të higjienës dhe rregullores zbatuese për sigurinë ushqimore.

Megjithatë, duhet të garantohen burimet financiare për të garantuar zbatimin e duhur të legjislacionit. Kërkohen përpjekje të konsiderueshme në lidhje me harmonizimin e legjislacionit kombëtar me *acquis*, përcaktimi i kompetencave, komunikimi dhe bashkëpunimi mes strukturave, si edhe forcimi i burimeve njerëzore.

4.13. Kapitulli 13: Peshkimi

Spektori vazhdon të jetë i fragmentuar për sa i përket përgjegjësive dhe komunikimit, pasi prodhimi i peshkut dhe inspektimet kryhen nga dy departamente të ndryshme në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (MMPAU), ndërkohë që me sëmundjet e peshkut merret Drejtoria e Shëndetit të Kafshëve në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (MBUMK) dhe produktet e përpunimit të peshkut mbulojnë nga Departamenti i Sigurisë Ushqimore në MBUMK dhe nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit. Ka avancuar puna për hartimin e ligjit të ri të peshkimit me synimin për të forcuar sistemin e mbikëqyrjes dhe monitorimit në peshkim, për të mundësuar sektorin të zbatojë sistemin e monitorimit satelitor të mjeteve lundruese dhe të luftojë peshkimin e paligjshëm, të padeklaruar dhe të parregulluar.

Për sa i përket **menaxhimit të burimeve dhe flotës**, flota e peshkimit është regjistruar dhe mjetet lundruese janë klasifikuar sipas kategorive. Megjithatë, aplikimi i regjistrimit operacional të flotës së peshkimit, sipas rekomandimeve të Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun, është ende në pritje.

Për sa i përket **inspektimit dhe kontrollit**, kapaciteti administrativ vazhdon të jetë i dobët, vetëm me një numër të vogël personeli administrativ, përgjegjës në nivel qendror për peshkimin dhe akuakulturën. Parlamenti ka miratuar një ligj të ri inspektimi, i cili parashikon shkrirjen e inspektorateve të Pyjeve, Peshkimit dhe Mjedisit. Është rritur organika e rojës bregdetare. Megjithatë, inspektorëve vendorë të kualifikuar dhe me eksperiencë vazhdon t'ju ngarkohen detyra në lidhje me akuakulturën, veterinarinë dhe çështjet zooteknike. Mundësia e sigurimit të fondeve për programin e monitorimit vazhdon të jetë shumë e pakët.

Shumica e inspektimeve janë kryer në liqenet kryesore për të ndaluar peshkimin e palicencuar dhe përdorimin e mjeteve të paligjshme të peshkimit. Pothuajse nuk janë raportuar shkelje sa i përket peshkimit në det. Mungesa e mjeteve dhe burimeve për inspektorët e peshkimit e ka bërë të vështirë inspektimin dhe zbatimin e legjislacionit, sidomos për sa i përket peshkimit të vogël bregdetar. Sistemi i kontrollit për aktivitetet e peshkimit duhet të forcohet në mënyrë të konsiderueshme si dhe të shtohet personeli i specializuar. Zbatimi dhe mbledhja e gjobave mbetet një sfidë.

Sistemi monitorues i mjeteve lundruese ("Kutitë blu") është instaluar në të gjitha mjetet lundruese mbi 12 metra për të forcuar mbikëqyrjen e flotës së peshkimit. Sigurimi i të dhënave të besueshme, sistematike dhe të përmirësuar për flotën e peshkimit, sasitë e peshkut të zënë, sasitë e peshkut të dorëzuar dhe gjendja biologjike e rezervave të peshkut në ujërat shqiptare vazhdon të jetë një çështje me interes. Mbulimi i zonës kryesore të peshkimit

nuk është përfunduar ende dhe operacionet varen në një shkallë të madhe nga burimet e projekteve donatore.

Në përgatitjet për menaxhimin e **aksioneve strukturore**, kërkohet përforsimi dhe trajnimi i personelit, me mbështetjen e ekspertizës së BE-së. Shqipëria ende jep **ndihmë shtetërore** për të mbështetur zhvillimin e infrastrukturës së peshkimit në katër portet e peshkimit dhe naftë pa akcizë për mjetet e peshkimit.

Masat për **politikën e tregut** janë në një fazë paraprake, sidomos sa i takon organizatave të prodhuesve dhe mbledhjes së të dhënave të tregut.

Për sa i përket zbatimit të **marrëveshjeve ndërkombëtare**, Shqipëria është anëtare e Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun dhe merr pjesë në projektin AdriaMed. Shqipëria nuk ka paraqitur as raportin e kapacitetit të peshkimit dhe planeve të inspektimit për periudhën e 2011, as planet e saj vjetore të peshkimit në ICCAT në lidhje me Planin e Rigjenerimit për Tonin e kuq.

Përfundim

Në tërësi, ka pasur disa përparime në fushën e inspektimit, të kontrollit, si dhe shenja pozitive lidhur me rëndësinë që ka roli dhe e ardhmja e sektorit të peshkimit në zhvillimin ekonomik. Janë përmirësuar kapacitetet teknike që përforsojnë mbikëqyrjen dhe sistemin e monitorimit në fushën e peshkimit dhe luftën kundër peshkimit të paligjshëm, të padeklaruar dhe të parregulluar. Megjithatë, zbatimi i rregulloreve në ujërat e brendshme dhe zonat bregdetare mbetet i dobët për shkak të mungesës së burimeve. Do të duhet të përmirësohet bashkëpunimi ndërinstytucional.

4.14. Kapitulli 14: Politikat e transportit

Në shkurt, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit përfundoi rishikimin 5-vjeçar të Planit Kombëtar të Transportit, si instrumenti kryesor për vendimmarrjen dhe planifikimin strategjik të sektorin e transportit në Shqipëri.

Në **transportin rrugor** ka pasur përparim. Përafrimi legjislativ me *acquis* ka përparuar mirë, përfshi kërkesat e peshës dhe përmasave të mjeteve motorike. Nuk është vënë re përparim me kontrollet teknike, lejet për drejtim automjeti dhe dokumentet e regjistrimit. Zbatimi ka nisur në të gjitha fushat e tjera. Janë ndërmarrë disa veprim për transpozimin e legjislacionit për inspektimin e automjeteve. Megjithatë, siguria rrugore mbetet një çështje shumë shqetësuese. Rritja e qëndrueshme e trafikut rrugor, bashkë me mirëmbajtjen e pamjaftueshme të rrugëve, ndërtimet e paligjshme përgjatë rrugëve dhe mungesa e lartë e disiplinës në drejtimin e automjeteve, vazhdojnë të paraqesin probleme. Në shkurt, qeveria miratoi Strategjinë Kombëtare të Sigurisë Rrugore dhe Planin e Veprimit të Sigurisë Rrugore 2011-2015, që konfirmoi rëndësinë e takografëve digjitalë dhe të kufizuesve të shpejtësisë. Megjithatë, mbetet sfida zbatimi si i strategjisë ashtu edhe i planit të veprimit përmes një programi pune. Legjislacioni për mallrat e rrezikshme ende nuk është miratuar.

Në **transportin hekurudhor** ka pasur pak përparim. Shoqëria publike “Hekurudha Shqiptare” (HSh) po funksionon në katër njësi pune; hapi i parë në ndarjen e llogarive sipas rregullave të BE-së. Shteti e kompenson HSh-në për shërbimet e udhëtarëve. Përparim është bërë në bisedimet me Malin e Zi për marrëveshjen e kalimit të kufirit. Trafiku hekurudhor i mallrave, në veçanti shërbimi ndërkombëtar me Malin e Zi fqinj, është rritur. Ka pasur pak përparim në përgatitjen e reformës së legjislacionit hekurudhor. Nuk ka përparim të raportuar në lidhje me krijimin e institucioneve të pavarura hekurudhore, menaxherët e infrastrukturës si dhe operatorët hekurudhorë, të cilat janë parakushte për akses të hapur në rrjetin hekurudhor shqiptar. Ende nuk është botuar drafti i ‘deklaratës së rrjetit’. Problemet në ruajtjen e cilësisë së infrastrukturës hekurudhore janë të pranishme për shkak të fondeve të pamjaftueshme për mirëmbajtje.

Në **transportin detar** raportohet ka pasur disa përparime. Drejtoria e Përgjithshme Detare e krijuar në 2010 në Durrës, tashmë është funksionale dhe me staf të plotë. Ndërkohë që janë bërë përparime me krijimin e një regjistri anijesh dhe të një autoriteti për sigurinë, riorganizimi i Kontrollit Portual dhe krijimi i Kontrollit Shtetëror të Flamurit janë ende në proces. Sipas statistikave të vitit 2010 në kuadrin e Memorandumit të Mirëkuptimit të Parisit për Kontrollin Shtetëror Portual, ndalimi i mjeteve të lundrimit që lundrojnë me flamur shqiptar ishte 16%, e cila është shumë poshtë mesatares së BE-së prej 1.78%. Kabotazhi vazhdon të jetë i rezervuar për mjetet që mbajnë flamurin kombëtar, ndërsa ende vazhdon të jetë e detyrueshme që kapitenët e anijeve të jenë shtetas shqiptarë.

Transporti i brendshëm ujor është i kufizuar në vetëm një linjë të rregullt në liqenin e Komanit.

Shqipëria është në fazat e hershme të zhvillimit në **transportin e kombinuar**,

Në **transportin ajror**, Shqipëria ka bërë përparim të kufizuar në zbatimin e fazës së parë të Marrëveshjes për Hapësirën e Përbashkët Europiane të Aviacionit. Janë bërë disa përparime në transpozimin e legjislacionit për Menaxhimin e Trafikut Ajror. Përparim është bërë edhe në sigurinë e aviacionit, më përjashtim të Programit Kombëtar të Sigurisë së Aviacionit Civil. Përpjekje të mëtejshme nevojiten gjithashtu në përmirësimin e zbatimit të *acquis* për përpunimin në tokë dhe shpërndarjen e vendeve të caktuara. Është krijuar Autoriteti Kombëtar Mbikëqyrës dhe trajnimi i stafit është në vazhdim. Megjithatë, nuk ka pasur përparim me zbatimin e legjislacionit për sigurinë ajrore. Autoriteti i Aviacionit Civil ka mungesë inspektorësh të kualifikuar, prandaj nuk ka arritur të përmbushë përgjegjësitë e veta në lidhje me mbikëqyrjen e sipërmarrjeve të miratuara dhe mbajtësve të licencave. Programi Shtetëror i Sigurisë së Aviacionit nuk është zhvilluar dhe ende nuk është siguruar një nivel i mbikëqyrjes së sigurisë në përputhje me standardet ndërkombëtare të sigurisë.

Për sa i përket **navigimit satelitor**, Shqipëria nuk ka planifikuar të marrë pjesë në programin e navigimit satelitor Galileo kur të bëhet funksional.

Përfundim

Ndërkohë që ka pasur përparim në fushën e transportit rrugor dhe detar, përparimi në fushat e transportit ajror dhe hekurudhor ka qenë i kufizuar. Legjislacioni për sigurinë e aviacionit mbetet për t'u zbatuar në mënyrë të efektshme. Strukturat administrative në sektorë të ndryshëm të transportit duhet të bëhen më të efektshme. Në tërësi, përgatitjet nuk janë shumë të avancuara.

4.15. Kapitulli 15: Energjia

Janë bërë disa përparime në lidhje me **sigurimin e furnizimit me energji**. Linja e re e interkonjesionit 400 kV me Malin e Zi u bë funksionale në prill 2011. Megjithatë, furnizimi me energji mbetet i brishtë dhe vulnerabël ndaj kushteve hidrologjike, për shkak se prodhimi i brendshëm varet pothuaj plotësisht nga hidrocentralet. Duhet përpjekje të mëtejshme për zbatimin e *acquis* në lidhje me sigurinë e furnizimit me energji, siç e kërkojnë detyrimet e Shqipërisë në kuadrin e Traktatit të Komunitetit të Energjisë.

Që nga 1 janari 2011, ligji parashikon detyrimin që rezervat e naftës të rriten për të mbuluar 90 ditë, në linjë me direktivën e BE-së për rezervat e naftës. Qeveria ka marrë masa për të vënë sanksione dhe për të pezulluar licencat apo aktivitetin e operatorëve që nuk përmbushin detyrimet e tyre. Respektimi i kërkesave ligjore mbetet për t'u demonstruar.

Përparim i kufizuar është bërë në **tregun e brendshëm të energjisë**. Vazhdojnë përgatitjet për ristrukturimin e kompanisë shtetërore të prodhimit dhe shitjes me shumicë, KESH. Autoriteti i Konkurrencës gjykon se mosndarja efektive funksionale dhe financiare e furnitorit publik të shitjes me shumicë si dhe të elementëve të prodhimit të KESH-it po pengon konkurrencën. Ligji për Sektorin Energjetik, që rregullon sektorin energjisë elektrike, dhe aktet e tij nënligjore ende nuk janë në linjë me *acquis*. Një pjesë e konsiderueshme e kapaciteteve transmetuese dhe prodhuese ende i rezervohet furnitorit me shumicë. Humbjet e sistemit të shpërndarjes janë ulur lehtë në total. Norma e arkëtimit të faturave mbetet rreth 77%. Ende duhen përpjekje të fuqishme në këto drejtime. Modeli i tregut duhet të adaptohet për të garantuar rentabilitet ekonomik të sektorit të energjisë elektrike. Shqipëria nuk ka treg gazi dhe ende nuk janë miratuar aktet nënligjore të Ligjit për Sektorin e Gazit Natyror të vitit 2008. Duhet përpjekje të mëtejshme që të forcohen kompetencat monitoruese dhe imponuese të entit rregullator ERE, si edhe pavarësia e tij.

Nuk ka pasur përparim në fushën e **energjisë së rinovueshme**. Kuadri legjislativ dhe rregullator nuk janë në linjë me *acquis*. Pengesat administrative ekzistuese dhe mungesa e rregullave për koston e lidhjes me rrjetin apo përforcimin e rrjetit, po pengojnë afrimin e prodhuesve të rinj të energjisë së rinovueshme. Nuk ka pasur përparim në lidhje me zbatimin e objektivit që Shqipëria ka vendosur për biokarburantet. Ende nuk është përgatitur Plani kombëtar i Veprimit për Energjinë e Rinovueshme që të mundësojë arritjen e objektivit për përqindjen e energjisë së rinovueshme ndaj konsumit final të energjisë në vitin 2020.

Shqipëria duhet të bëjë përpjekje të mëtejshme për të përmirësuar përdorimin e energjisë së rinovueshme.

Nuk ka pasur përparime në fushën e **efiçencës së energjisë**, për sa i përket sjelljes së Ligjit për Efiçencën e Energjisë në linjë me *acquis*. Qeveria miratoi Planin kombëtar të Veprimit për Efiçencën e Energjisë 2011-2018, por kuadri ligjor dhe shpërndarja ndërinstitucionale e përgjegjësiave për zbatimin e tij, ende nuk është realizuar.

Janë bërë disa përparime në fushën e **sigurisë bërthamore dhe mbrojtjes nga rrezatimet**. Shqipëria ratifikoi Konventën për Sigurinë Bërthamore dhe Konventën e Përbashkët për sigurinë e menaxhimit të karburanteve të përdorura dhe të sigurisë së menaxhimit të mbetjeve radioaktive, e cila hyri në fuqi në shtator. Janë miratuar vendime për mbrojtjen e personave të ekspozuar në punë ndaj rrezatimeve jonizuese dhe niveleve të përqendrimit të radonit dhe radionuklidëve. Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet (KMRr) ka nxjerrë dy vendime në lidhje me Kodin e Praktikes për përdoruesit e mjekësisë bërthamore dhe për nivelet dozimetrisë për ekspozimet mjekësore. Për sa i përket zbatimit të ligjit, KMRr ka miratuar rregulloret për raportimin e inspektimeve dhe për procedurat e miratimit të tregtisë, transferimit dhe transportit të burimeve radioaktive. Megjithatë, duhen përpjekje të mëtejshme për transpozimin dhe zbatimin e *acquis* Euratom. Mbetet për t'u verifikuar nëse zhvillimet e fundit rregullatore janë në përputhje me *acquis*. Kapacitetet e autoritetit rregullator janë ende të pamjaftueshme për zbatimin dhe sundimin e ligjit sipas standardeve ndërkombëtare. Përgatitjet për hartimin e strategjisë kombëtare dhe politikave për menaxhimin e mbetjeve radioaktive janë në fazë të hershme. Magazinimi i mbetjeve të neutralizuara nuk është licencuar sipas standardeve ndërkombëtare dhe shqetësim përbën vendndodhja e saj pranë zonave të populluara.

Përfundim

Përparimi në sektorin energjik është i kufizuar. Ligji për sektorin energjetik nuk është në linjë me *acquis*. Reforma e tregut në sektorin e energjisë elektrike ende nuk është e efektshme dhe duhen përpjekje të mëtejshme për të garantuar rentabilitetin e saj ekonomik. Përpjekje shtesë kërkohen në fushën e energjisë së rinovueshme, si edhe duhet të forcohen kapacitetet dhe pavarësia institucionale e autoriteve rregullatore të energjisë elektrike, gazit dhe mbrojtjen nga rrezatimet. *Në tërësi*, përgatitjet në fushën e energjisë po avancojnë ngadalë.

4.16. Kapitulli 16: Tatimet

Ka pasur disa përparime në fushën e **tatimit indirekt**. Janë miratuar disa ndryshime legislative për përjashtimet nga TVSH-ja dhe normat tatimore të ulura. Deklarimi elektronik është bërë i detyrueshëm për taksapaguesit e TVSH-së dhe vënia e pajisjeve fiskale (kasave) ka përparuar. Procedurat e rimbursimit të TVSH-së janë përmirësuar, por duhen përpjekje të mëtejshme për të shkurtuar vonesat, si edhe për analizën e riskut. Ligji për TVSH-në nuk është ende në linjë me *acquis*.

Përafrimi me *acquis* në fushën e *akcizës* ka përparuar lehtë me miratimin e listës së re të produkteve të akcizës dhe normave të akcizës, përfshi normat minimale për cigaret. Megjithatë, duhen përpjekje të mëtejshme për të sjellë strukturën dhe normat e akcizës në linjë me *acquis*, përfshi normat e ulura për birrën e prodhuesve të vegjël.

Përparim i pakët është bërë në fushën e **tatimit direkt**. Janë bërë disa ndryshime në tatimin mbi të ardhurat personale, duke mundësuar të dhëna të hollësishme për deklarimin e të ardhurave dhe qëllimin e tyre, si edhe deklarimin e shpenzimeve të zbritshme. Megjithatë, nevojiten përpjekje të mëtejshme në lidhje me transpozimin e legjislacionit dhe zbatimin e duhur të parimeve të qeverisjes së mirë.

Nuk është bërë përparim në lidhje me **bashkëpunimin administrativ dhe asistencën e ndërsjellë**.

Përparim i kufizuar është bërë në lidhje me **kapacitetet administrative dhe operacionale**. Bashkëpunim me taksapaguesit po përmirësohet. Janë marrë masa për të mbështetur deklarimin me formularë elektronikë dhe në dhjetor 2010 filloi punën Qendra e Shërbimit të Tatimpaguesve për Tiranën. Megjithatë, Avokati i Tatimpaguesve vazhdon të ketë kapacitete të kufizuara dhe nuk është kryer asnjë vlerësim për funksionimin e Këshillit Tatimor. Mbetet e kufizuar transparenca dhe konsultimi me përfaqësuesit e shoqërive tregtare gjatë procesit legjislativ. Është miratuar Kodi i Etikës në shkurt 2011, por masat anti-korrupsion kërkojnë përpjekje të mëtejshme, meqë perceptimi për korrupsionin në administratën tatimore mbetet i lartë. Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore nuk ka nisur punë, gjë që pengon aktivitetet trajnuese. Kapacitetet e administratës tatimore, përfshirë kapacitetet TI, kanë mbetur pothuajse të njëjta. Sistemi i decentralizuar i TI-së nuk është më adekuat për nevojat e administratës tatimore. Ky sistem është i vjetruar dhe funksionet e tij për analizën e riskut dhe kontabilitetin janë të kufizuara. Duhet bërë përpjekje të mëtejshme për të përmirësuar kapacitetet e auditimit, hetimit dhe inteligjencës si edhe për luftën kundër mashtrimit dhe shmangies tatimore.

Përfundim

Në fushën e tatimeve, përparimi është i kufizuar. Duhet përpjekje të mëtejshme për përafrimin me *acquis* për taksat direkte dhe indirekte, si edhe përmirësimin e sistemit të rimbursimit të TVSH-së. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për forcimin e kapaciteteve teknike dhe administrative si dhe për luftën kundër korrupsionit në administratën tatimore. Përgatitjet kanë avancuar në masë të moderuar.

4.17. Kapitulli 17: Politika ekonomike dhe monetare

Ka pasur përparim të kufizuar në përafrimin e kuadrit ligjor shqiptar me *acquis* për **politikën monetare**. Ende nuk është miratuar projektligji i ri për Bankën e Shqipërisë që synon përafrimin e mëtejshëm me *acquis*, përfshi dispozitat për procedurat e shkarkimit të

Guvernatorit, pavarësinë personale të anëtarëve të Këshillit dhe llogaridhënien e Bankës së Shqipërisë.

Përparim i pakët është bërë në përafrimin e *acquis* në fushën e **politikave ekonomike**. Në shkurt 2011, Shqipëria nxori Programin e saj Ekonomik dhe Fiskal (PEF) që i referohej Kuadrit Makroekonomik dhe Fiskal 2012-2014. PEF mbulon gjerësisht të gjitha të dhënat përkatëse, por ka dobësi në lidhje me statistikat për tregun e punës dhe pagat. Po ashtu, nuk adresoi mjaftueshëm çfarë ndikimi ka pasur në Shqipëri gjendja ekonomike e partnerëve tregtarë. PEF nuk është i qartë për masat e parashikuara fiskale afatmesme dhe kostot e tyre buxhetore. Gjithashtu, është i turbullt në lidhje me strategjinë e përgjithshme dhe nuk është e qartë lidhja mes reformave dhe objektivave fiskale. Të dhënat e financave publike në PEF nuk janë në përputhje me sistemin evropian të llogarive ESA95.

Kapacitetet për hartimin dhe koordinimin e politikave ekonomike janë të pamjaftueshme.

Përfundim

Përparim i kufizuar është bërë në përafrimin e *acquis* në fushën e politikës ekonomike dhe monetare, ndërkohë që politikat ekonomike dhe fiskale vazhdojnë të kenë dobësi. Në tërësi, përgatitjet në këtë fushë nuk janë shumë të avancuara.

4.18. Kapitulli 18: Statistikat

Është bërë përparim në përafrimin me *acquis* në fushën e **infrastrukturës statistikore**. Ka pasur rritje të buxhetit dhe stafit të Institutit të Statistikave (INSTAT) duke i paraprirë censusit të 2011 për popullsinë dhe banesat. Infrastruktura është përmirësuar me teknologjinë e fundit të përpunimit dhe shpërndarjes së të dhënave. Megjithatë, dispozitat e Ligjit për statistikat që lidhen me rolin e INSTAT-it si koordinues të sistemit kombëtar të statistikave, janë të pamjaftueshme. Gjithashtu, ligji nuk siguron përfaqësim të gjerë të të gjithë ofruesve dhe përdoruesve të statistikave zyrtare në këshillin statistikor. Kuadri ligjor që rregullon punësimin dhe shkarkimin e Drejtorit të Përgjithshëm të tij nuk garanton mjaftueshëm pavarësinë profesionale të INSTAT-it.

Disa përparime janë bërë në lidhje me **klasifikimet dhe regjistrat**. Botimi i parë i regjistrit të përditësuar të biznesit dhe të dhënat e regjistrimit ekonomik janë bazuar në Nomenklaturën e Veprimtarive Ekonomike e njehsuar me Klasifikimin Evropian (NACE) Rev.1.1. Kodifikimi i njësive në regjistrin e biznesit sipas NACE Rev.2 ka filluar dhe do të botohet kur të miratohet ligji që përmban NACE Rev.2. INSTAT ra dakord për ndarjen e vendit në rajone statistikore në përputhje me Nomenklaturën e Njësive Territoriale për Statistikat sipas nivelit NUTS II të Bashkimit Evropian. Rezultatet e Regjistrimit të Sipërmarrjeve janë përdorur për përditësimin e regjistrit të biznesit.

Në fushën e **statistikave sektoriale**, ka pasur përparim të mirë dhe janë bërë përpjekje për përmirësimin e disa domeneve statistikore. Në lidhje me statistikat e biznesit, INSTAT

realizoi regjistrimin e sipërmarrjeve ekonomike në nëntor e dhjetor 2010. Pati përmirësime të statistikave të llogarive kombëtare tremujore në fushën e llogaritjes së statistikave bazë si dhe metodologjisë statistikore.

Disa përparime janë bërë në lidhje me publikimin në kohë të indeksit të çmimeve të mallrave të konsumit, statistikave të tregtisë së huaj dhe statistikave afatshkurtra. Në fushën e statistikave të çmimeve, ka pasur përmirësime në lidhje me rishikimin e indeksit të kostos së ndërtimit dhe përpilimin e çmimeve të importit. Statistikat bujqësore dhe agromonetare kanë nevojë për përmirësim shumë më të madh.

Kuadri metodologjik i censusit të tokave bujqësore, i planifikuar të zhvillohej në qershor 2012, po përgatitet dhe një regjistrim provë do të zhvillohet në nëntor 2011. Aktivitetet përgatitore për regjistrimin e popullsisë dhe banesave të tetorit 2011 po përparojnë, por nevojiten ende përpjekje të mëtejshme për të siguruar mbarëvajtjen e suksesshme të regjistrimit.

Përfundim

Ka pasur përparim në përafrimin me *acquis*, kryesisht në fushën e statistikave sektoriale dhe nëpërmjet modernizimit të infrastrukturës statistikore. Megjithatë, ka ende dobësi, veçanërisht në fushën e statistikave bujqësore, shoqërore, të biznesit dhe makroekonomike. Nevojiten më shumë përpjekje për përafrimin me *acquis*. Pavarësia profesionale e INSTAT-it nuk bazohet mjaftueshëm në ligj dhe kërkohen përpjekje për të siguruar që ai ka burime financiare dhe njerëzore të mjaftueshme. Në tërësi, përgatitjet kanë avancuar në masë të moderuar.

4.19. Kapitulli 19: Politika sociale dhe Punësimi

Nuk është bërë përparim në fushën e **të drejtës së punës**.

Janë bërë disa përparime në fushën e **shëndetit dhe sigurisë në punë**. Është miratuar strategjia për sigurinë dhe shëndetin në punë, dhe në shkurt 2011, Këshilli i Ministrave miratoi dy vendime që janë pjesë e masave për zbatimin e Ligjit për Shëndetin dhe Sigurinë në punë. Në dhjetor 2010 u miratua një vendim që harmonizon Direktivën e BE-së në lidhje me kërkesat e tabelave/shenjave të sigurisë dhe shëndetit në punë. Janë zhvilluar aktiviteteve sensibilizuese dhe informuese për shëndetin dhe sigurinë në punë. Procesi i transpozimit të direktivave të BE-së vazhdon të jetë i ngadaltë.

Inspektorati Shtetëror i Punës e ka përsheptuar bashkëpunimin me institucionet e tjera, sidomos me Ministrinë e Shëndetësisë, me të cilën ka realizuar një sërë inspektimesh të përbashkëta. Megjithatë, Inspektorati Shtetëror i Punës nuk është forcuar më tej në kuptimin e burimeve njerëzore dhe financiare, dhe nuk është bërë përparim për hapjen e 24 zyrave vendore, pasi deri tani ekziston vetëm një zyrë vendore në Sarandë.

Disa përparime janë bërë në lidhje me **dialogun social**. Këshilli Kombëtar i Punës ka zhvilluar mbledhjet periodike me synimin që të trajtojë kryesisht çështje të rrafshit kombëtar. Në nëntor 2010, Këshilli miratoi ndryshimet në rregulloren për organizimin dhe funksionimin e vet dhe në shkurt 2011 u nënshkrua një Memorandum Social Mirëkuptimi midis qeverisë dhe shoqatave të punëdhënësve dhe punëmarrësve. Megjithatë, ende nuk janë finalizuar kritere të qarta dhe të matshme përfaqësimi për anëtarësimin në Këshill. Janë marrë masa për të promovuar dialogun social sektorial dhe dypalësh, dhe është regjistruar një shoqatë ombrellë e punëdhënësve. Megjithatë, përparimi drejt kontratave kolektive të punës në sektorin privat mbetet i pakët.

Është bërë përparim i kufizuar në lidhje me **politikën e punësimit**. Ka filluar monitorimi i strategjisë së punësimit. Megjithatë, nuk është miratuar një plan veprimi për punësimin. Vihen re përmirësime shumë të kufizuara në situatën e tregut të punës. Niveli i inaktivitetit mbetet i lartë dhe shkalla e papunësisë, edhe pse në rënie, vazhdon të qëndrojë në 13.7%. Papunësia prek kryesisht personat me më pak aftësi profesionale, të rinjtë dhe banorët e zonave të largëta. Edhe pse Shqipëria ka vazhduar zbatimin e një sërë masash për tregun e punës aktiv, ekziston akoma shqetësimi për rastet e raportuara të abuzimit me programet e subvencionimit të punësimit, dhe shpenzimet për tregun e punës aktiv mbeten të ulëta. Marrëveshjet informale të punës vazhdojnë të jenë të përhapura. Statistikat për tregun e punës vazhdojnë të jenë të dobëta.

Kanë vazhduar përpjekjet për trajnimin e personelit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe të zyrave vendore dhe rajonale, dhe po vazhdon puna për hartimin e rregullave të konsulencës. Buxheti për strukturat rajonale dhe vendore të ShKP-së është rritur ndjeshëm. "Banka e pozicioneve vakante" është finalizuar me qëllim që të përmirësohet informacioni i postuar në faqen e internetit të ShKP-së. Megjithatë, ekziston nevoja e vazhdueshme për trajnim të mëtejshëm të personelit, kompjuterizim të shërbimeve në mbarë vendin, pastrimin e regjistrave, komunikimin me punëdhënësit, formalizimin e punës dhe rritjen e efektivitetit të shërbimeve të konsulencës.

Përgatitjet për **Fondin Social European** nuk kanë avancuar (*Shiko edhe Kapitullin 22 - Politika rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore*).

Në fushën e **përfshirjes sociale** përparimi ka qenë jo i njëtrajtshëm. Raporti i parë monitorues i Strategjisë kombëtare për përfshirjen sociale 2007-2013 pasqyron përparimin e bërë me vlerësimin dhe adresimin e faktorëve-risk që shoqërojnë rritjen ekonomike. Disa përparime janë bërë në uljen e varfërisë, megjithatë, vazhdon të ketë 'xhepa' varfërie persistente në zonat rurale dhe malore. Progres i kufizuar është bërë me zbatimin konkret të Strategjisë për përmirësimin e kushteve të jetesës të minoritetit rom.

Përparim i kufizuar është bërë në lidhje me personat me aftësi të kufizuara, sidomos në kontekstin e masave të tregut të punës që zbatohen nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit në nivel qendror dhe vendor. Nuk është zbatuar punësimi me kuota i personave me aftësi të kufizuara. Për më tepër, është ndryshuar sistemi i indeksimit të ndihmës së invaliditetit, duke rezultuar në ulje të nivelit të jetesës.

Janë bërë disa përparime në lidhje me **mbrojtjen sociale**. Ligji për Asistencën dhe Shërbimet Sociale është ndryshuar, duke shtuar kategoritë që përfitojnë ndihmë ekonomike. Është miratuar Ligji për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, i cili krijon një skemë të sigurimit të detyrueshëm shëndetësor, administrimin e të cilit ia ngarkon Fondit të Sigurimeve Shëndetësore. Ligji i ndan të siguruarit në kategori ekonomikisht aktive dhe joaktive, ku kontributet e kategorisë joaktive mbulohen nga shteti. Shqipëria po punon për të përmirësuar menaxhimin e sistemit të sigurimeve shoqërore, duke përfunduar databazën e pensioneve dhe duke riorganizuar dhe forcuar administrimin e sistemit të sigurimeve shoqërore. Në mars 2011 u krijua një sistem ndihme për fëmijët e familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike. Megjithatë, skema ekzistuese e ndihmës sociale nuk po funksionon mirë, pasi pagesat për familjet përfituese janë shumë të ulëta për të pasur impakt pozitiv, sidomos ato për fëmijët. Skema e pensioneve përballet me probleme serioze financiare, në kuptimin e deficitit dhe numrit të ulët të kontribuuesve. Evazioni me kontributet e sigurimeve shoqërore mbetet i përhapur. Pjesëmarrja e popullsisë ekonomikisht aktive në këtë skemë ka qenë e ulët. Kuadri ligjor i skemës së pensioneve, sidomos për dallimet mes gjinive, nuk është rishikuar.

Është bërë përparim i kufizuar në lidhje me **anti-diskriminimin**. Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi është përgjithësisht në linjë me *acquis*. Megjithatë, zbatimi i tij po procedon ngadalë. Pavarësisht organizimit të një sërë fushatash sensibilizuese nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ndërgjegjësimi i përgjithshëm rreth dispozitave të ligjit mbetet i ulët. Për më tepër, këto fushata kanë pasur në fokus publikun, duke lënë grupet kyçe profesionale të painformuara mjaftueshëm rreth ligjit.

Përparim i pakët është bërë në fushën e **mundësive të barabarta**. Ekziston hendek mes kuadrit ligjor dhe nivelit real të barazisë mes meshkujve dhe femrave në aspektin e punësimit. Aksesit i femrave në sipërmarrje dhe huadhënie është inferior dhe vazhdon të ketë hendek të konsiderueshëm në paga mes meshkujve dhe femrave.

Përfundimi

Përparimi në fushën e politikës sociale dhe punësimit ka qenë jo i njëtrajtshëm. Janë marrë disa masa për të zbatuar legjislacionin në fushën e shëndetit dhe sigurisë në punë dhe janë bërë disa përparime në dialogun social dhe në reformën e ndihmës dhe mbrojtjes sociale. Qëndrueshmëria e financimeve do të jetë vendimtare për të garantuar zbatim të suksesshëm të këtyre reformave. Tregu i punës vazhdon të jetë i karakterizuar nga inaktiviteti dhe informaliteti i lartë; edhe zbatimi i politikave mbetet i pamjaftueshëm, sidomos për sa i përket kategorive në nevojë dhe përfshirjes sociale. Në tërësi, përgatitjet në fushën e politikës sociale dhe punësimit nuk janë shumë të avancuara.

4.20. Kapitulli 20: Ndërmarrjet dhe politika industriale

Përparim është bërë në **parimet e ndërmarrjeve dhe të politikës industriale**. Zbatimi i Kartës së Biznesit të Vogël ka përparuar. Qendra Kombëtare e Licencimit e shtriu shërbimin në 9 qytete. Procedurat e bizneseve u thjeshtuan edhe më tepër për sa i takon prokurimit

publik dhe tatimeve. Ka vazhduar puna me reformën rregullatore, me krijimin e sistemit për vlerësimin e ndikimit rregullator (RIA Light) që u konsiderua më i përshtatshëm për rrethanat e Shqipërisë.

Strategjia e Inovacionit dhe Teknologjisë së Biznesit 2011-2016 u miratua në shkurt 2011. Strategjia parashikon ngritjen e një Qendre të Ndërmjetësimit dhe Inovacionit të Biznesit (BRIC) si pjesë e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA). Kjo qendër do të shërbejë si ndërmjetëse kryesore dhe facilituese për nxitur novacionin dhe zhvillimin teknologjik të bizneset dhe do të jetë ndërlidhëse me Agjencinë e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit, me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, me universitet dhe qendrat e ekselencës. Si BRIC ashtu edhe AIDA u bënë funksionale në qershor 2011. Nuk ka përparim në lidhje me transpozimin e direktivës për vonimin e pagesave.

Në fushën e **ndërmarrjeve dhe instrumenteve të politikës industriale**, përparim është bërë për sa i përket aksesit në financim për NVM-të përmes një skeme granti të financuar prej qeverisë italiane, Fondit European për Europën Juglindore dhe përmes krijimit të Skemës së Garantimit të Kredive për NVM-të. Në prill 2011 u nënshkrua marrëveshja me një grup prej 6 bankash të nivelit të dytë për të lehtësuar aksesin e bizneseve në Skemën e Garantimit të Kredive me vlerë 2.5 milion euro.

Shqipëria merr pjesë në Rrjetin European të Ambasadoreve Sipërmarrëse, nismë kjo e financuar në kuadrin e Programit të Konkurrueshmërisë dhe Novacionit.

Për sa i përket **politikave sektoriale**, Këshilli i Ministrave dhe Ministri i Ekonomisë miratuan aktet nënligjore për minierat. Strategjia e re e minierave u miratua në korrik 2011.

Përfundim

Ka pasur disa përmirësime në thjeshtimin e kuadrit rregullator për bizneset dhe në lehtësimin e aksesit të NVM-ve në financim. Janë krijuar institucione për të lehtësuar novacionin dhe zhvillimin teknologjik. Përgatitjet kanë avancuar në masë të moderuar.

4.21. Kapitulli 21 : Rrjetet transeuropiane

Shqipëria ka bërë disa përparime në fushën e **rrjeteve të transportit**. Shqipëria vazhdoi të marrë pjesë në mënyrë aktive në Observatorin e Transportit të Europës Juglindore dhe të zbatojë Memorandumin e Mirëkuptimit për zhvillimin e Rrjetit Kryesor të Transportit Rajonal të Europës Juglindore.

Përsa i përket rrjetit të infrastrukturës rrugore, është pranë përfundimit të korridoreve rrugore kryesore, duke dhënë kështu një kontribut të madh në zhvillimin e rrjeteve infrastrukturore të Ballkanit, me synim integrimin e tyre të ardhshëm në Rrjetet e Transportit Transeuropian. Kanë përparuar punimet në korridorin veri-jug rreth 400km mes kufijve të Greqisë dhe Malit

të Zi. Është hapur autostrada që lidh Kosovën me korridorin veri-jug dhe Portin e Durrësit. Megjithatë, shqetësim mbetet mirëmbajtja e pamjaftueshme rrugore.

Nuk ka përparim të raportuar në infrastrukturën e rrjetit hekurudhor.

Infrastruktura portuale po përmirësohet. Po shtohet kapaciteti i terminalit të portit në Durrës dhe kanë nisur përgatitjet për zgjerimin e skelave. Infrastruktura e portit të Vlorës po rehabilitohet. Porti i Durrësit dhe porti privat i Vlorës, *Petrolifera*, janë tashmë të lidhur me rrjetin hekurudhor. Kanë nisur përgatitjet për të përmirësuar skelën e portit të Shëngjinit. Është përgatitur një Strategji e Porteve Bregdetare e cila rekomandon që aktivitetet e rënda portuale në qytetin e Durrësit të zhvendosen në Porto Romano.

Përsa i përket **rrjeteve energjetike**, ka kufizime për sa i përket interkonjeksionit. Linja e transmetimit të fuqisë së lartë 400 kV për interkonjeksionin me Malin e Zi u bë funksionale në janar 2011. Përgatitjet për ndërtimin e linjës së transmetimit Elbasan-Tiranë kanë përparuar. Nuk ka zhvillime në lidhje me përgatitjen e strategjisë së gazit natyror.

Përfundim

Në tërësi, janë bërë disa përparime në fushën e rrjeteve transeuropiane. Megjithatë, transporti hekurudhor mbetet pak i zhvilluar dhe nevojiten përpjekje të mëtejshme për mirëmbajtjen e infrastrukturës së transportit.

4.22. Kapitulli 22: Politikat rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore

Përparim i kufizuar është bërë në fushën e **kuadrit legjislativ**. Ligji për zhvillimin rajonal, i cili do të themelojë politikën për zhvillimin rajonal, është ende duke u përgatitur. Qeveria miratoi ndarjen e Shqipërisë në tre rajone për qëllime statistikore në përputhje me kriteret e Nomenklaturës së BE-së për Njësitë Statistikore Territoriale (NUTS 2).

Mund të raportohen disa zhvillime në fushën e **kuadrit institucional**. Janë ngritur sipas ligjit njësitë e përfshira për zbatimin e Komponentit të I-rë IPA. Ato përbëhen nga një staf i vogël dhe janë trajnuar gjerësisht. Përveç bazës ligjore për strukturat e komponentëve III dhe IV të IPA-s miratuar në vitin 2010, autoritetet shqiptare miratuan në janar të 2011 vendimin për të realizuar strukturat e komponentit II të IPA-s. Për sa i përket përgatitjeve të komponentit IV, ka pasur përparim shumë të kufizuar. Mungon një përcaktim i qartë i përbërjes së ardhshme të strukturës operative.

Për sa i përket **kapaciteteve administrative**, janë bërë disa përparime dhe stafi kryesor që merret me Komponentët III dhe IV të IPA-s është i përfshirë gjithashtu në zbatimin e komponentit të I-rë IPA. Megjithatë, duhen bërë përpjekje të mëtejshme për të forcuar kapacitetet administrative adekuate, sidomos në ministrinë e linjës. Mbetet për t'u bërë analiza e ngarkesës së punës në ministrinë e linjës për të vlerësuar kërkesat për stafin që nevojitet për

zbatimin e komponentëve II, III dhe IV të IPA-s. Njësia Qendrore e Financimit dhe Kontraktimit (CFCU) nuk ka rekrutuar ende stafin minimal që kërkohet për zbatimin e komponentit të I-rë IPA. Mbetet për t'u bërë analiza e ngarkesës së punës për të vlerësuar kërkesat për stafin që nevojitet në Njësinë Qendrore për Financim dhe Kontraktim në lidhje me përfshirjen e tyre në zbatimin e komponentëve II, III dhe IV të IPA-s.

Është kryer trajnimi për menaxhimin financiar, prokurimin, parregullsitë dhe auditimin e Njesisë Qendrore për Financim dhe Kontraktim, Fondin Kombëtar dhe Autoritetin e Auditimit. Ka filluar vlerësimi i nevojave për trajnim që do të çojë në përgatitjen e planeve trajnuese për 2011 dhe 2012.

Për sa përket **programimit**, janë bërë disa përparime. Në muajin shkurt 2011 u përgatit projekt dokumenti i Kuadrit të Koherencës Strategjike dhe u paraqit në Komisionin European për komente. Projekt Programet Operacionale për komponentët III dhe IV të IPA-s janë përgatitur dhe dërguar në Komisionin European për komente në muajin prill 2011. Vlerësimi *ex-ante* për këto Programe Operacionale është duke vazhduar. Cilësia e draft dokumenteve të programimit nuk plotëson ende kërkesat e IPA III dhe IV. Përfshirja e partnerëve socialë në proces dhe zbatimi i parimit të partneritetit ka qenë e pakët për komponentin IV. Duhet të bëhen përpjekje për të ngritur dhe zhvilluar projekte prioritare

Në lidhje me **monitorimin dhe vlerësimin**, mund të raportohet përparim i kufizuar meqenëse mekanizmat dhe sistemet kombëtare për matjen e cilësisë dhe impakti i programeve të zhvillimit janë duke funksionuar.

Në fushën e **menaxhimit dhe kontrollit financiar** mund të raportohen disa përparime. Ministri i Financës miratoi Rregulloret e Autoritetit të Auditimit (AA). Plani i miratuar për rekrutimet e AA parashikon rekrutimin e 5 inspektorëve shtesë për vitin 2011. Stafii i auditimit të tanishëm të AA është i certifikuar ose në procesin e certifikimit.

Përfundim

Në tërësi, ka përparime të kufizuara në fushën e zhvillimit rajonal dhe koordinimin e fondeve strukturore. Nevojiten ende përpjekje të mëdha për ngritjen e kapaciteteve të nevojshme institucionale dhe administrative për të zhvilluar projekte prioritare në fushën e zhvillimit rajonal. Përgatitjet në këtë fushë janë ende në një fazë të hershme.

4.23. Kapitulli 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore (shiko edhe Kriterin Politik)

Përparimi ka qenë i kufizuar për sa i përket plotësimit të kuadrit ligjor për reformën në gjyqësor. Strategjia për Reformën në Gjyqësor dhe Plani i Veprimit u miratuan në korrik, në konsultim me një grup të gjerë interesi. Ato formojnë një bazë të mirë për aktivitetet e reformës. Zbatimi sapo ka filluar dhe kërkon akordimin e burimeve të duhura njerëzore dhe financiare, si dhe bashkëpunim të shëndoshë ndërinstitutional.

Në lidhje me *pavarësinë* e **gjqësorit** nuk është bërë përparim. Pavarësia e Gjykatës së Lartë duhet të garantohet, duke përfshirë rishikimin e sistemit të tanishëm të emërimeve, për të shmangur politizimin. Paanshmëria dhe pavarësia e Gjykatës Kushtetuese duhen të garantohet, duke përfshirë zbatimin e një procesi të duhur për emërimin dhe seancat dëgjimore të gjyqtarëve në parlament, larg ndikimeve politike.

Për sa i përket *llogaridhënies* në sistemin gjyqësor, imuniteti i plotë që gëzojnë gjyqtarët mbetet një nga faktorët kryesorë që pengon hetimin e rasteve të mundshme të korrupsionit në sistemin gjyqësor. Korrupsioni i përhapur është faktor kyç që pengon llogaridhënien e gjyqësorit. Ministria e Drejtësisë (MD) dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD) kanë miratuar një Memorandum Mirëkuptimi për të adresuar mbivendosjen e kompetenca të inspektimit mes inspektorateve të të dy institucioneve, si masë e përkohshme deri në miratimin e një ligji të ri për KLD-në.

Përparim i kufizuar është bërë në lidhje me *efikasitetin* e sistemit gjyqësor. KLD-ja miratoi ndryshime në sistemin e vlerësimit të gjyqtarëve si dhe ka bërë përmirësime në arsyetimet e vendimeve për emërimet; përveç kësaj, është krijuar Komisioni i transferimeve, ngritjes në detyrë dhe emërimit të gjyqtarëve. Megjithatë, efektshmëria e sistemit të ri të vlerësimit duhet të verifikohet në praktikë. Reformat për ligjin për Gjykatën e Lartë që synojnë përmirësimin e efikasitetit janë vonuar. Kushtet e punës në gjykata janë përgjithësisht ende të dobëta dhe seancat shpesh zhvillohen në zyrat e gjyqtarëve, çka pengon transparencën dhe efikasitetin. Buxheti vjetor për sistemin gjyqësor mbetet i pamjaftueshëm.

Menaxhimi i gjykatave vazhdon të jetë i dobët për shkak të mungesës së burimeve njerëzore dhe financiare, veçanërisht në gjykatat e rrethit të shkallës së parë. Numri i çështjeve të akumuluar në pritje për t'u shqyrtuar është ende problematik. Vonesat e paarsyeshme i çështjeve gjyqësore për shkak të shtyrjes së procedurave gjyqësore nga mungesa e avokatëve apo gjyqtarëve, vazhdojnë të jenë veçanërisht shqetësuese. Sistemi i kompjuterizuar për menaxhimin e çështjeve dhe caktimin e rastësishëm të çështjeve penale apo civile, është vendosur në shumicën e zyrave gjyqësore, por jo në të gjitha.

Në shkurt 2011 u miratua Ligji i ri për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe aktet e tij nënligjore, që janë në linjë me standardet e BE-së. Megjithatë, ligje të rëndësishme që kërkojnë shumicë me 3/5 në parlament, presin ende të miratohen, si për shembull ligji për gjykatat administrative dhe ndryshimet në Kodin Penal. Ligje të tjera të rëndësishme që kërkojnë 3/5 si ligji për administratën gjyqësore dhe ligji për Konferencën Gjyqësore Kombëtare ende duhen përgatitur dhe paraqitur në parlament.

Ekzekutimi i vendimeve të gjykatave është i dobët, veçanërisht në rastet ku institucionet shtetërore janë palë e paditur. Sistemi i ri i përmbarrimit privat ka filluar të funksionojë, por ende nevojiten përmirësime në menaxhimin e çështjeve për përmbarruesit.

Disa përparime janë bërë në lidhje me politikën qeveritare në luftën kundër **korruptionit**. Në qershor 2011 u miratua një plan veprimi i ri kundër korrupsionit për periudhën 2011-2013, i cili përmban plane veprimi të përmirësuar për secilën ministri dhe agjenci shtetërore.

Zbatimi i planeve të veprimit të miratuara më parë ka vazhduar.

Për sa i përket kuadrit ligjor, janë bërë disa përparime në zbatimin e rekomandimeve të Grupit të Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO) në lidhje me çështjen e inkriminimit dhe financimit të partive politike. Rekomandimet për kriminalizimin janë zbatuar pjesërisht, ndërsa rekomandimet për financimin e partive politike janë zbatuar të gjitha me përjashtim të njërës.

Në qershor 2011, GNP (Grupi Ndërmintoror i Punës) miratoi rregulloret e brendshme të funksionimit të tij, të Grupit Teknik ndërministror dhe të Sekretariatit Teknik të GNP-së, me synim përcaktimin e një ndarjeje më të qartë të përgjegjësive mes organeve relevante si dhe përmirësimin e koordinimit të strategjisë kundër korrupsionit. Një departament i ri i kontrollit të brendshëm u krijua brenda Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave. Përveç kësaj, bashkëpunimi ndërinstytucional është përmirësuar me nënshkrimin e memorandumeve të mirëkuptimit ndërmjet si Departamentit të Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Anti-Korrupsionit (DKBAA) dhe Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive (ILDKP) me Këshillin e Lartë të Drejtësisë (KLD) dhe një OJF kundër korrupsionit. Janë marrë disa masa të kufizuara për rritjen e ndërgjegjësimit.

Mungesa ka në mekanizmat e propozuar dhe në kapacitetin administrativ të institucioneve përgjegjëse që duhet të sigurojnë monitorimin e duhur të zbatimit të planit të veprimit kundër korrupsionit. DKBAA, në veçanti, nuk është forcuar mjaftueshëm dhe aftësia e saj për të koordinuar politikatat kundër korrupsionit mbetet e kufizuar. Raportimet dhe sidomos statistikat për korrupsionin mbeten të pamjaftueshme.

Një sërë agjencish hetimore dhe të zbatimit të ligjit vazhdojnë të vuajnë nga mungesa e burimeve njerëzore dhe infrastrukturës teknike. Njësitë e Përbashkëta Hetimore, megjithëse vazhdojnë të jenë instrumente të dobishme për hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit, kanë burime njerëzore dhe pajisje teknike të pamjaftueshme. ILDKP-ja, e cila luan rol të rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit, ka burime të kufizuara për të ndërmarrë inspektime të zgjeruara dhe kontrole të plota të deklarimit të pasurive nga zyrtarët. Megjithëse ka pasur përmirësime të mëtejshme në bashkëpunimin mes agjencive të ndryshme, përfshirë trajnimet e përbashkëta, shpesh mungon shkëmbimi efikas dhe në kohën e duhur i informacionit.

Hetimet proaktive si pjesë e hetimeve sistematike, të fokusuara dhe mbi baza kërcënimi në fusha dhe raste të mundshme korrupsioni, janë tejet të pamjaftueshme në Shqipëri. Pengesë serioze për hetime efikase dhe të suksesshme mbetet imuniteti i plotë i zyrtarëve të lartë. Imuniteti i zyrtarëve të lartë rrallë hiqet dhe mungesa e konfidencialitetit në rastin e heqjes së imunitetit, pengon seriozisht efikasitetin dhe suksesin e hetimeve. Sipas rekomandimeve të Komisionit të Venecias, kufizimi i imunitetit si për gjyqtarët, ashtu edhe për deputetët, kërkon ndryshimin e dispozitave kushtetuese përkatëse. Hetimet për rastet e mundshme të korrupsionit pengohen edhe nga mungesa e aksesit në regjistra të ndryshëm (p.sh. regjistri i mjeteve motorike dhe regjistri i tokës) të agjencive hetimore dhe të zbatimit të ligjit, si dhe nga mungesa e një regjistri qendror të llogarive bankare.

Zbatimi i masave kundër korrupsionit mbetet i pamjaftueshëm dhe korrupsioni i pranishëm në shumë sektorë mbetet problem veçanërisht serioz. Pak përparim është bërë në zhvillimin e një vijimësie (historiku) solide të hetimeve proaktive, ndjekjeve penale dhe dënimeve në rastet e korrupsionit në të gjitha nivelet. Hetimet e rasteve të korrupsionit, sidomos në nivelet e larta, janë të rralla.

Gjatë vitit 2010, Shqipëria ka zgjeruar kuadrin ligjor dhe institucional që përcakton **të drejtat themelore**, kryesisht me anë të miratimit të Ligjit për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës. Megjithatë, ende ka boshllëqe të konsiderueshme, veçanërisht për personat me aftësi të kufizuara dhe për sistemin gjyqësor për të miturit. Në vitin 2010, numri i ankesave të dorëzuara te Avokati i Popullit arriti në 1651, që përbën një rënie prej 54% krahasuar me vitin 2009, ku shumica e ankesave (10%) kishin për objekt sistemin gjyqësor shqiptar. Funksonimi i institucioneve të të drejtave të njeriut has pengesa për shkak të postit të Avokatit të Popullit që vazhdon të mbetet vakant si dhe rekrutimeve në vazhdim në Zyrën e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Përveç kësaj, ende nuk është garantuar akordimi i burimeve të mjaftueshme për sigurimin e pavarësisë së plotë të këtyre organeve.

Për sa i përket *parandalimit të torturës dhe keqtrajtimit*, janë bërë disa përparime në sistemin e vuajtjes së dënimit, por ka ende shqetësime për arrestimet dhe ndalimet nga policia. Janë hartuar ndryshimet në manualin për rregullat e trajtimit dhe sigurimin e të arrestuarve dhe të ndaluarve në njësitë policore. Megjithatë, zbatimi i garancive procedurale ndaj përdorimit të tepërt të forcës nga oficerët e policisë nuk është garantuar dhe vazhdojnë të raportohen raste të keqtrajtimit gjatë arrestimeve, marrjes në pyetje dhe mbajtjes në polici. Trajtimi i të akuzuarve me sëmundje mendore duhet përmirësuar. Shqetësim serioz mbetet mungesa e një zgjidhjeje të përshtatshme dhe të përhershme për sistemimin e personave nën trajtim të detyrueshëm.

Disa përparime janë bërë në *sistemin e burgjeve* dhe disa qendra burgimi po ndërtohen apo rinovohen, me qëllimin për t'iu përafëruar standardeve europiane. Janë bërë përpjekje për forcimin e kapacitetit të personelit dhe njohjen e tyre me të drejtat e njeriut, veçanërisht për trajtimin e grupeve të pambrojtura. Shërbimi i Provës vazhdon të zhvillohet, por burimet e këtij shërbimi për të përballuar ngarkesën gjithnjë e në rritje të rasteve mbeten të kufizuara. Godinat e vjetra të disa institucioneve të vuajtjes së dënimit janë në gjendje të mjerueshme; shpesh nuk ka ngrohje, edhe në disa prej pjesëve të rinovuara. Gjithashtu, ekziston shqetësimi se procedurat e ekzaminimit mjekësor përpara sistemimit në institucion dhe masat e konfidencialitetit për kartelat mjekësore nuk ndiqen në mënyrë konsistente.

Përparimi ka qenë i kufizuar në lidhje me *aksesin në organet e drejtësisë*. Është krijuar Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike, janë miratuar aktet nënligjore, por ligji nuk po zbatohet plotësisht. Duhet të përgatiten mekanizmat e duhur për caktimin objektiv të çështjeve për avokatët.

Përparim i kufizuar është bërë në fushën e *lirisë së shprehjes*. Parimi i proporcionalitetit të gjobave në rastet e medias apo gazetarëve, nuk zbatohet sistematikisht. Legjislacioni bazë për nxitjen e lirisë së medias nuk është miratuar ende dhe pavarësia editoriale vazhdon të pengohet nga interesat politike dhe të biznesit.

Liria e tubimit dhe e organizimit është respektuar në përgjithësi, por dhuna që çoi në vrasjen e katër demonstruesve në janar përbën shqetësim serioz. Agjencia për shoqërinë civile ka filluar lëvrimin e fondeve për organizatat e shoqërisë civile. Megjithatë, kapaciteti i shumicës së organizatave vazhdon të jetë i dobët dhe ato varen shumë nga donacionet. *Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe besimit* vazhdon të respektohet dhe Protestantizmi është njohur si feja e pestë zyrtare.

Disa përparime janë bërë në fushën e të *drejtave të grave dhe barazisë gjinore*. Nga ana e politikave, ka pasur disa zhvillime me miratimin në qershor 2011 të strategjisë së re kombëtare për barazinë gjinore dhe reduktimin e dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, dhe krijimin në 17 bashki të mekanizmit kombëtar të referimit për dhunën në familje. Megjithatë, gratë shqiptare vazhdojnë të diskriminohen në lidhje me aksesin në fusha të caktuara dhe nuk janë të përfaqësuara sa duhet në tregun e punës dhe në politikë. Gjatë zgjedhjeve vendore të majit 2011, kuota gjinore nuk u respektua në të gjithë vendin.

Një hap i rëndësishëm legjislativ u mor për zgjerimin e mbrojtjes së të *drejtave të fëmijëve* me miratimin e Ligjit për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës. Ky ligj mbetet për t'u zbatuar plotësisht nëpërmjet funksionimit efektiv të organeve të parashikuara sipas ligjit. Përparimi në trajtimin e *personave vulnerabël nga ana sociale dhe/ose personave me aftësi të kufizuara* mbetet i pamjaftueshëm. Kuadri ligjor nuk është plotësuar dhe zbatimi i strategjisë kombëtare për personat me aftësi të kufizuara vazhdon të jetë i ngadaltë.

Përparim të kufizuar ka pasur në lidhje me zbatimin e *politikave kundër diskriminimit*. Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka organizuar disa aktivitete ndërgjegjësimi dhe trajnimi për të shpërndarë informacion rreth Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe mundësitë e apelimit te Komisioneri. Megjithatë, numri i ankimeve të dorëzuara pranë Komisionerit është i vogël dhe kapaciteti i zyrës duhet forcuar më shumë. Gjithashtu, në përgjithësi dispozitat e këtij ligji njihen pak nga qytetarët dhe profesionistët, veçanërisht nga niveli vendor. Shqipëria mbledh të dhëna mbi krimet dhe incidentet e nxitura nga urrejtja, por nuk i bën ato publike. Gjatë periudhës raportuese, nuk ka pasur dënime për krimet me bazë racizmin apo ksenofobinë.

Të drejtat e punës dhe e bashkimit në sindikata janë respektuar në përgjithësi dhe janë bërë përpjekje për përmirësimin e funksionimit të Këshillit Kombëtar të Punës. Megjithatë, mbeten për t'u miratuar kritere të qarta për anëtarësimin.

Ndërkohë që miratimi dhe zbatimi i një strategjie koherente kombëtare dhe plani veprimi për *të drejtën e pronës* është përparësi kyçe e Opinionit që po mbetet pezull, fragmentimi i përgjegjësive dhe mungesa e koordinimit mes institucioneve po pengon zbatimin efikas të politikave dhe ka krijuar pasiguri juridike si dhe rrezik sistematik për korrupsion.

Kuadri ligjor për *respektimin dhe mbrojtjen e minoriteteve dhe të të drejtave kulturore* nuk është zgjeruar. Megjithëse marrëdhëniet ndëretnike kanë vazhduar të jenë përgjithësisht të mira, ka pasur njëfarë përkeqësimi në klimën e minoriteteve që mund të shpjegohet me përgatitjet për censusin e popullsisë që do të përfshijë pyetje fakultative për origjinën etnike

dhe përkatësinë fetare. Komiteti Shtetëror i Minoriteteve mbetet i dobët dhe dallimet mes grupeve me përkatësi të ndryshme shkaktojnë diferencime në praktikë. Janë ndërmarrë nisma pozitive për nxitjen e arsimimit të romëve, megjithëse ky komunitet vazhdon të përballet me kushte shumë të vështira jetese dhe diskriminim të shpeshtë. Zbatimi i mekanizmave të politikave në këtë fushë mbetet i ulët.

Ministria e Brendshme ka miratuar Rregulla të reja të Brendshme për Mbrojtjen e të Dhënave dhe Sigurinë Publike, që synojnë të përcaktojnë procedurat për *mbrojtjen e të dhënave personale* të administruara nga Policia e Shtetit. Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave ka vazhduar të zbatojë Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave ka miratuar disa udhëzime, përfshi mbrojtjen e të dhënave personale në media. Gjithashtu, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë dhe të Arsimit dhe Shkencës si dhe me Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare. Megjithatë, roli i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave minohet ngaqë nuk i kërkohet mendim sistematikisht për disa akte juridike kyçe.

Nuk ka pasur asnjë zhvillim në lidhje me të **drejtat e shtetasve të BE-së**; Ligji për të Huajt nuk është ndryshuar për t'iu dhënë përparësi qytetarëve të BE-së për sa i përket kërkesës së tregut të punës.

Përfundim

Në përgjithësi, megjithëse Shqipëria ka bërë disa përpjekje për zhvillimin e legjislacionit në këtë fushë, ende ka boshllëqe domethënëse. Përveç kësaj, një sfidë e rëndësishme për Shqipërinë mbetet zbatimi i mekanizmave legjislativë dhe të politikave, të cilët vazhdojnë të jenë përgjithësisht të pamjaftueshëm. Përputhshmëria me standardet europiane dhe me *acquis* në fushën e sistemit gjyqësor dhe të të drejtave themelore është ende në fazë të hershme.

4.24. Kapitulli 24: Drejtësia, liria dhe siguria

Janë bërë disa përpjekje në fushën e **migrimit**. Vazhdon të zbatohet pa probleme Marrëveshja e Ripranimit. Në 2010, u regjistruan 52 919 raste kthimi, kryesisht nga Greqia. Strategjia dhe Plani i Veprimtë për emigrantët e kthyer po zbatohet me sukses, por është e nevojshme të përmirësohet analiza e riskut dhe monitorimi i flukseve të imigrimit. Strategjia Kombëtare e Migrimit nuk është zbatuar plotësisht deri në fund të vitit 2010. Kuadri legjislativ duhet të vihet plotësisht në linjë me *acquis*. Përgatitjet në këtë fushë kanë avancuar në masë të moderuar.

Janë bërë disa përpjekje në fushën e **azilit**. Deri në shtator 2011, janë pranuar 78 refugjatë dhe 30 azil kërkues. Funksionon kuadri ligjor dhe institucional. Megjithatë, legjislacioni nuk është plotësisht në linjë me *acquis*, dhe rishikimi aktual i legjislacionit nuk ka përfunduar. Nuk janë dhënë dokumente identifikimi deri tani për refugjatët ose për personat që kanë mbrojtje shtesë. Përgatitjet në këtë fushë duhet të përshpejtohen.

Janë bërë disa përparime në fushën e **politikës së vizave**. Shqipëria vazhdon të zbatojë regjim pa viza për qytetarët e disa vendeve joanëtare të BE-së që bëjnë pjesë në listën negative të Rregullores 539/2001. Regjimi shqiptar i vizave nuk është i harmonizuar plotësisht me kërkesat e BE-së. Përgatitjet në këtë fushë duhet të vazhdojnë.

Liberalizimi i vizave për Shqipërinë u dha në 15 dhjetor 2010 dhe aplikohet për personat me pasaporta biometrike që udhëtojnë në hapësirën Schengen. Ky vendim u bazua në përparimin e konsiderueshëm në fushën e drejtësisë, lirisë dhe sigurisë si dhe plotësimit të kushteve specifike të përcaktuara në udhërrëfyesin për liberalizimin e vizave. Regjimi i lëvizjes pa viza është zbatuar pa probleme deri tani. Megjithatë, është vënë re një numër relativisht i vogël azilkërkuesish dhe emigrantësh të parregullt në zonën Schengen. Për të siguruar zbatimin në vazhdimësi të angazhimeve të ndërmarra, është ngritur një mekanizëm për monitorimin pas liberalizimit të vizave. Komisioni ia paraqiti raportin e tij të parë të monitorimit Parlamentit Europian dhe Këshillit në qershor 2011.

Përparim ka pasur në fushën e **kufijve të jashtëm dhe zonës Schengen**. Janë nënshkruar marrëveshje mes Kosovës dhe Shqipërisë dhe ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë Marrëveshjet që mundësojnë patrullime të përbashkëta dhe të sinkronizuara të kufijve nga policia. Policia Kufitare dhe e Migracionit (PKM) që tashmë është departament i strukturuar qartë brenda Policisë së Shtetit, me burime dhe pajisje teknike të mjaftueshme, vazhdon të bëjë trajnime. Procedurat Standarde të Operimit tani funksionojnë. Ka vazhduar përmirësimi i infrastrukturës në pikat e kalimit kufitar (PKK). 11 pika të kalimit kufitar u morën në dorëzim nga Policia Kufitare dhe Doganat ndërmjet periudhës nëntor 2010 dhe janar 2011. Të 24 pikat e kalimit kufitar janë të lidhura në kohë reale me sistemin TIMS (sistemi i mbikëqyrjes së vendkalimeve kufitare), duke siguruar akses në databazën kombëtare për dokumentet e udhëtimit, dhe në databazën e Interpolit për personat e kërkuar. Shqipëria ka pasur përparim edhe në ngritjen e kapaciteteve të vlerësimit të riskut.

Përmirësimi i mbikëqyrjes ndërinstitucionale të kufijve blu ka vazhduar pa probleme. Moratoriumi për skafet është ende në fuqi. Duhet të zbatohet mbulimi i plotë i mbikëqyrjes së bregdetit. Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare ka nevojë për akordime financiare për të siguruar funksionimin e saj.

PKM ka akses të kufizuar në Sistemin MEMEX (sistemi i analizës së informacionit kriminal). Nevojitet shtrirja më tej e këtij sistemi në pikat e kalimit kufitar për të rritur zhvillimin e policimit mbi bazë 'inteligjence', Kapacitetet e PKM-së për vlerësimin e kërcënimeve duhet të forcohen. Përpjekje të mëtijshme të përbashkëta nevojiten për të luftuar kundër të gjitha llojeve të krimit ndërkufitar, përfshi trafikimin e automjeteve të vjedhura. Gjithashtu, duhet të përmirësohen kapacitetet e mbikëqyrjes së kufirit të gjelbër dhe kontrollit në brendësi të vendit. Përgatitjet në këtë fushë janë në rrugën e duhur.

Ka pasur disa përparime në fushën e **bashkëpunimit gjyqësor për çështjet civile dhe penale**. Në lidhje me bashkëpunimin gjyqësor në çështjet penale, Shqipëria ka nënshkruar dhe ratifikuar Protokollin e Tretë Shtesë të Konventës Europiane "Për Ekstradimin" që përmban rregulla të thjeshtuara për ekstradimin. Bashkëpunimi me Eurojust-in ishte i mirë. Shqipërisë i duhet të fokusojë përpjekjet e saj, sidomos në fushën e mbrojtjes së të dhënave,

për të qenë e aftë të lidhë një marrëveshje bashkëpunimi me Eurojust. Përgatitjet në këtë fushë po avancojnë.

Në fushën e **bashkëpunimit policor dhe luftës kundër krimit të organizuar**, kjo e fundit është ndërmjet prioriteteve kyç të Opinionit të Komisionit. Marrëveshjet e bashkëpunimit për shkëmbimin e informacionit u nënshkruan me Mbretërinë e Bashkuar dhe Italinë. Shqipëria ka rritur konfiskimin e aseteve kriminale. Agjencia për administrimin e aseteve të konfiskuara ka filluar nxjerrjen në ankand të aseteve. Përdorimi i agjentëve të fshehtë dhe masave speciale të hetimit është rritur gjithashtu. Duhet të garantohet zbatimi i kuadrit ligjor ekzistues, sidomos që me hyrjen në fuqi të të ashtuquajturit ligji “anti-mafia”.

Policia duhet të rrisë kapacitetet e saj që të sigurojë prova të sigurta për gjurmimin e transaksioneve të dyshimta. Procedurat e përbashkëta standarde të punës ndërmjet policisë dhe prokurorisë do të rrisin më tej bashkëpunimin dhe besimin ndërmjet tyre. Aktet nënligjore të ligjit për policinë gjyqësore janë miratuar dhe lypset të zbatohen.

Përdorimi i sistemit MEMEX ka përmirësuar shkëmbimin e të dhënave në Policinë e Shtetit. Ka pasur përparime në kodimin e të dhënave arkivore, të cilat mbeten të paplota. Sistemi përmban të dhëna të policisë, por jo informacion për hetimet e kryera nga shërbimi i prokurorisë. Megjithatë, përgjimet e linjës telefonike dhe përdorimi i agjentëve të fshehtë është kufizuar në nivelin qendror. Duhet të rriten kapacitetet e ‘inteligjencës’ për të përmirësuar cilësinë e provave. Nevojitet një sistem i besueshëm për raportimin e statistikave. Nuk funksionon një sistem i sigurt për trajtimin e telefonatave. Për organet e zbatimit të ligjit, nevojitet të zhvillohet një sistem i shëndoshë për menaxhimin e çështjeve.

Duhet të mbështeten më shumë kapacitetet operationale të laboratorit mjekoligjor, policimin e fshehtë dhe shërbimet për mbrojtjen e dëshmitarit. Për sa i përket rendit publik, është e nevojshme të zhvillohen kapacitetet raportuese të oficerëve të vijës së parë dhe më tej të inspektorëve dhe kryeinspektorëve për të rritur ose zhvilluar hetimet proaktive.

Për sa i përket burimeve njerëzore, është miratuar një strategji diversiteti; megjithatë numri i policeve femra që zënë pozicione të rangut të lartë nuk është rritur. Transferimeve u mungon transparenca dhe shpesh nuk janë bërë në bazë merite. Sistemi i Menaxhimit të Burimeve të Informacionit duhet të shfrytëzohet më tej dhe lypset të garantohet mirëmbajtja e tij. Lidhja ndërmjet zhvillimit të karrierës dhe trajnimeve në shërbimet e policisë duhet të forcohet.

Trafikimi i qenieve njerëzore vazhdon të jetë fushë shqetësuese. Zyra e Koordinatorit Kombëtar të anti-trafikimit ka rritur angazhimin, dhe masat politike dhe operative janë rritur identifikimin dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit. Në shkurt 2011, u miratua plani kombëtar i veprimit për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Veç kësaj, qeveria ka filluar të japë mbështetje financiare për qendrat ku strehohen viktimat. Shqipëria mbetet vend i origjinës për trafikimin për qëllime të shfrytëzimit seksual dhe punës së detyruar.

Duhet të zbatohet një përjasje shumëdisiplinore për adresimin e trafikimi të qenieve njerëzore. Duhet të përmirësohet identifikimi i viktimave, dhe të gjithë personat që hyjnë në kontakt me to, duhet të kenë trajnimin e duhur. Në këtë drejtim, vendimtare është që

Mekanizmi Kombëtar i Referimit të jetë efektiv dhe funksional, për të mbrojtur, ndihmuar dhe mbështetur viktimat e trafikimit, sidomos fëmijët. Në përgjithësi, është bërë përparim në këtë fushë, por kapacitetet e agjencive të zbatimit të ligjit dhe bashkëpunimi ndërkombëtar duhet të forcohen ndjeshëm.

Një ndryshim i ligjit të parandalimit të pastrimit të parave u miratua në mars, duke marrë parasysh rekomandimet MONEYVAL, dhe përmirësimin e kapaciteteve për zbulimin e transaksioneve të dyshimta bankare. Duhet të rritet bashkëpunimi ndërinstitucional në luftën kundër pastrimit të parave dhe përpjekje të mëtejshme duhet të bëhen për të adresuar nivelin e ulët të raportimit të transaksioneve të dyshimta nga sektori bankar dhe jobankar. Zbatimi i kuadrit ligjor ekzistues duhet të rritet dhe mjetet dhe ekspertiza e TI të agjencive relevante duhet të forcohen. Cilësia e Raporteve të Transaksioneve të Dyshimta vazhdon të mbetet sfidë. Kapacitetet e autoriteteve të zbatimit të ligjit për hetimin e pastrimit të parave dhe krimit financiar mbeten të dobëta.

Shqipëria ka qenë aktive në bashkëpunimin ndërkombëtar të policisë. Bashkëpunimi me Europol-in ka qenë i mirë. Një linjë e sigurt ndërmjet Shqipërisë dhe Europol-it është vënë në funksionim që nga qershori i 2011. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për mbrojtjen e të dhënave personale, me qëllim që Shqipëria të jetë e aftë të nënshkruajë një marrëveshje operative me Europol-in. Në tërësi, përgatitjet në këtë fushë janë duke avancuar, por kërkohet të rriten përpjekjet për përmirësimin e teknikave të vlerësimit të riskut, hetimeve pro-aktive, si dhe ngritja e një historiku solid të hetimeve, ndjekjeve penale dhe dënimeve.

Ka pasur disa përparime në fushën e **luftës kundër terrorizmit**. Në janar 2011, Shqipëria bëhet anëtare e Iniciativës rajonale për bashkëpunimin ndërkombëtar të policisë për luftën kundër terrorizmit. Përgatitjet në këtë fushë po avancojnë në masë të mjaftueshme.

Ka pasur disa përparime në **bashkëpunimin në fushën e drogave**. Është përmirësuar bashkëpunimi me Qendrën Europiane të Monitorimit për Drogat dhe Narkomanisë, me lançimin e një studimi për drogat dhe konsumimin e alkoolit.

Janë bërë disa përpjekje në drejtim të hetimit dhe ndjekjes penale të çështjeve të trafikimit të drogës, dhe autoritetet i kushtojnë vëmendje çështjes së kultivimit të drogës. Bashkëpunimi me agjencitë e zbatimit të ligjit është i mirë. Prodhimi dhe trafikimi i drogave vazhdojnë të mbeten çështje shqetësuese. Shqipëria vazhdon të jetë prodhuesi kryesor i kanabisit në rajon. Shqetësim është pakësimi i kapjes së sasisë së drogës krahasuar me vitet e kaluara. Kërkohet zhvillimi i mëtejshëm i metodave të hetimit për të kryer hetime komplekse. Strategjia kombëtare për drogat ka skaduar në fund të 2010. Kapacitetet administrative për zbatimin e strategjisë së ardhshme duhet të zhvillohen më tej. Përgatitjet në këtë fushë kanë avancuar në masë moderuar.

Ka pasur disa përparime në fushën e **bashkëpunimit doganor**. Drejtorja e Përgjithshme e Doganave ka vazhduar bashkëpunimin e mirë dhe shkëmbimin e informacionit me strukturat e saj homologe në rajon, në vendet e BE-së dhe gjetkë. Ka pasur një rritje kapacitetesh për të zbuluar dhe ndëshkuar mashtrimin dhe futjen kontrabandë të mallrave të paligjshme.

Përdorimi më sistematik i treguesve të performancës dhe vlerësimit të riskut do të ishte një zhvillim pozitiv. Përgatitjet në këtë fushë janë duke përparuar.

Për masat kundër **falsifikimit të euros**, shikoni Kapitullin 32- *Kontrolli Financiar*.

Përfundim

Shqipëria ka bërë përparime në fushën e drejtësisë, lirisë dhe sigurisë. Udhëtimi i lirë pa viza në zonën Schengen hyri në fuqi në dhjetor 2010 për qytetarët shqiptarë me pasaporta biometrike. Është bërë përparim në luftën kundër krimit të organizuar, sidomos nëpërmjet bashkëpunimit të mirë ndërkombëtar dhe zbatimit të ligjit 'anti-mafia', përfshi konfiskimin e aseteve kriminale. Duhet të shtohen përpjekjet për zbatimin me efikasitet të kuadrit legjislativ dhe forcimin e luftës kundër krimit të organizuar, që është një nga prioritetet kyç të Opinionit të Komisionit. Kjo përmban ngritjen graduale të një historiku solid të besueshëm të hetimeve pro-aktive, prokurorisë dhe, kur është e përshtatshme, të dënimeve. Masat për rritjen e ekspertizës dhe autoritetin e hetuesve dhe bashkëpunimin e agjencive të zbatimit të ligjit duhet të vazhdojnë të ndiqen. Lufta kundër trafikimit të drogës, pastrimit të parave, trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtja e viktimave të saj duhet të intensifikohet dhe të kryhet sistematikisht, si dhe kuadri ligjor për konfiskimin e aseteve kriminale duhet të garantohet sistematikisht.

4.25. Kapitulli 25: Shkenca dhe kërkimi

Në fushën e **politikës së kërkimit shkencor**, është miratuar Strategjia e Novacionit dhe Transferimit të Teknologjisë të Biznesit për periudhën 2011-2016, me qëllim rritjen e kapaciteteve të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM) shqiptare që të zhvillojnë, të përdorin, të përshtatin dhe të komercializojnë teknologjinë, gjë që kontribuon në Bashkimin e Novacionit. Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit (AKTI) e themeluar në 2010, tashmë është funksionale. Niveli i investimeve në kërkim shkencor është akoma shumë i ulët (më pak se 0.2% e PBB-së në vitin 2010).

Në lidhje me pjesëmarrjen e Shqipërisë në **programin kuadër (FP7) kërkimor** të BE-së, AKTI ka rritur kapacitetet dhe ka rritur ndërgjegjësimin dhe informimin për pjesëmarrjen në programet kërkimore me BE-në dhe me partnerë të tjerë ndërkombëtarë. AKTI ka organizuar trajnime, seminare dhe ditë informimi për FP7, si dhe ka përdorur edhe rrugët e komunikimit elektronik për qëllimin e përhapjes së informacionit.

Kapacitetet administrative janë përmirësuar me emërimin e Pikave Kombëtare të Kontaktit (PKK) dhe përfaqësuesve në shumicën e komiteteve të menaxhimit të FP7. PKK-të kanë marrë pjesë në trajnime dhe aktivitete të ndryshme të organizuara nga Komisioni Europian për zgjerimin e kontakteve.

Është rritur numri i aplikimeve, por numri i projekte-propozimeve të suksesshme FP7 që marrin financim mbetet shumë i ulët. Shqipëria duhet të vazhdojë përpjekjet për zbatimin e

Memorandumit të Mirëkuptimit FP7 dhe për monitorimin nga afër të pjesëmarrjes në të. Përpjekje të mëtejshme duhen për ndërtimin e kapitalit njerëzor (Veprimet Marie Curie), përfshirjen e NVM-ve në kërkim dhe novacion, si dhe për ekselencën shkencore në përgjithësi.

AKTI është bërë anëtare e Rrjetit të Evropës Qendrore dhe Juglindore për Kërkimin, Inovacionin dhe Biznesin që ka për qëllim të nxitë dhe të lehtësojë bashkëpunimin ndërmjet institucioneve publike dhe private, duke u fokusuar në kërkimin dhe zhvillimin brenda dhe jashtë BE-së. AKTI u bë gjithashtu anëtare e Shoqatës Europiane të Administratorëve dhe Menaxherëve të Kërkimit (EARMT). Shqipëria po ndërton qendrën kombëtare LIFE-WATCH si pjesë e Konsorciumit European të Infrastrukturës Kërkimore (ERIC).

Përsa i përket integritimit në **Hapësirën Europiane të Kërkimit** (ERA), zbatimi i Strategjisë kombëtare të Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (STI) 2009-2015 ka qenë relativisht i ngadaltë. Ngritja e qendrave të ekselencës është ende në fazë shqyrtimi dhe janë marrë masa të kufizuara për të rritur lëvizshmërinë e shkencëtarëve. Databaza e shkencëtarëve që punojnë në Shqipëri është përditësuar, por duhet të krijohet databaza e shkencëtarëve shqiptarë që punojnë jashtë vendit. Shqipëria ka emëruar delegatët vëzhgues në të gjithë organet drejtuese të ERA-s, por nuk po merr pjesë rregullisht për shkak të mungesës së kapaciteteve administrative. Sasia e investime në kërkim shkencor është e vështirë për t'u monitoruar për shkak të mungesës së statistikave të besueshme për shkencën dhe teknologjinë.

Përfundim

Në tërësi, Shqipëria ka bërë shumë për rritjen e bashkëpunimit kërkimor me BE-në dhe aktorët e tjerë, por nuk ka marrë masa të mjaftueshme për të forcuar kapacitetet kërkimore në nivel kombëtar. Me krijimin e AKTI-t, janë përmirësuar kapacitetet e nevojshme administrative për pjesëmarrjen në FP7. Kërkohen përpjekje të përqendruara për të lehtësuar integrimin e Shqipërisë në Hapësirën Europiane të Kërkimit, si rritja e investimeve kushtuar kërkimit në sektorin publik dhe privat, si edhe forcimi i kapitalit njerëzor. Duhet të fillojnë përgatitjet për të kontribuar në Bashkimin e Novacionit.

4.26. Kapitulli 26: Arsimit dhe kultura

Ka pasur disa përparime në fushën e **arsimit, formimit profesional dhe rinisë**. Me akreditimin e agjencive të certifikuara trajnuese, ka pasur zhvillime të mëtejshme në fushën e trajnimit të mësuesve. Inspektorati Kombëtar i Arsimit Parauniversitar ka filluar të kryejë inspektime në arsimin parauniversitar. Është ngritur Agjencia Kombëtare e Provimeve që jep ndihmë dhe vlerëson administrimin e provimeve kombëtare. Kjo Agjenci është përgjegjëse edhe për mbledhjen e të dhënave për Programin e Vlerësimit Ndërkombëtar të Nxënësve (PISA) për vitin 2012. Pjesëmarrja e Shqipërisë në edicionin e fundit të PISA-s ndihmon për të identifikuar boshllëqet në reformën e arsimit.

Janë miratuar ndryshimet në Ligjin për Arsimin dhe Formimin Profesional (AFP), me qëllim përafrimin me standardet e BE-së në lidhje me AFP formale dhe joformale, nxënien gjatë gjithë jetës, licencimin e mësuesve/trajnesve dhe arsimin tretësor. Programet mësimore të përgatitura rishtas për AFP ofrojnë më tepër fleksibilitet dhe i janë përshtatur nevojave specifike të kategorive vulnerabel të studentëve.

Është miratuar Ligji për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve dhe janë marrë disa masa për zbatimin e tij. Këshilli Kombëtar u mandatua si organ këshillimor për zbatimin e Kornizës së Kualifikimeve dhe u ngrit Njësia Zbatuese e Kornizës së Kualifikimeve. Janë bërë disa përparime në lidhje me kuadrin institucional për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë privat.

Shqipëria filloi të marrë pjesë në programin e BE-së "Europa për Qytetarët". Shqipëria ka organizuar ditë informimi dhe seminare për të rritur pjesëmarrjen që deri tani ka qenë e kufizuar. Promovimi i mundësive në kuadrin e Programit "Rinia në Veprim" ka ardhur në rritje. Ka pasur më tepër shpërndarje informacioni për programet e BE-së në fushën e arsimit të lartë, konkretisht Erasmus Mundus, Jean Monnet, Marie Curie dhe Tempus. Nevojitet forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve për të shtuar numrin e aplikimeve të suksesshme për fonde Tempus.

Në fushën e **kulturës**, është miratuar një strategji e re për trashëgiminë kulturore.

Përfundimi

Në tërësi, ka pasur disa përparime në përafrimin me Standardet Europiane në fushën e arsimit, sidomos në zhvillimin e AFP-së. Nevojiten përpjekje për të maksimizuar përfitimet nga programet e hapura për Shqipërinë që të çohen përpara reformat, sidomos në arsimin e lartë. Duhet të vazhdohet t'i kushtohet vëmendje kapaciteteve të qeverisjes së mirë, me qëllim që të bëhet menaxhim efikas i programeve të decentralizuara në fushën e arsimit dhe formimit profesional.

4.27. Kapitulli 27: Mjedisi

Për sa i përket **mjedisit**, janë bërë disa përparime në fushën e legjislacionit horizontal. Është miratuar ligji për Mbrojtjen e Mjedisit dhe ligji i ri për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedisi. Është miratuar edhe ligji për Lejet e Mjedisit, por evokimi i disa dispozitave të Qendrës Kombëtare të Licencimit ngjall shqetësim për pajtimin e tij me standardet europiane. Transpozimi i legjislacionit për vlerësimin mjedisor strategjik nuk ka ecur përpara. Nuk ka pasur përparim në fushat e aksesit në drejtësi dhe lehtësimin e pjesëmarrjes së publikut, të cilat mbeten relativisht të dobëta.

Nuk ka pasur përparim në lidhje me *cilësinë e ajrit*. Cilësia e ajrit monitorohet në të gjitha qytetet kryesor, por metodat dhe pajisjet e dobëta nuk gjenerojnë të dhëna konsistente. Me ndihmën e një projekti të BE-së pranë Ministrisë së Mjedisit, është përgatitur plani për menaxhimin e ajrit në Tiranë, por Bashkia e Tiranës ende nuk ka nisur zbatimin e tij.

Disa përparime janë bërë në *menaxhimin e mbetjeve*. Është miratuar Strategjia Kombëtare e Mbetjeve. Megjithatë, Ligji për Menaxhimin e Mbetjeve ende nuk është miratuar. Nuk ekziston ndonjë procedurë për menaxhimin dhe kontrollin e landfillëve, dhe vendgrumbullimet e pakontrolluara mbeten vendi kryesor për hedhjen e mbetjeve. Autoritetet duhet të monitorojnë me kujdes zbatimin e vendimit për importimin e mbetjeve për qëllime riciklimi.

Nuk ka pasur përparim në fushën e *cilësisë së ujit*. Transpozimi dhe zbatimi i legjislacionit kyç të BE-së është në fazë të hershme. Strategjia kombëtare për ujësjellës-kanalizimet dhe Ligji për ujin ende nuk janë miratuar. Grumbullimi i centralizuar i ujërave të përdorur ekziston vetëm në qytetet e mëdha. Aktualisht funksionojnë vetëm dy impiante trajtimi të ujërave të përdorur. Katër impiante të tjera janë ndërtuar, por ende nuk janë vënë në punë. Nuk ka asnjë plan për të identifikuar zonat e ndjeshme dhe për të vlerësuar cilësinë e ujit të tyre, përfshi cilësinë e ujërave të përdorur të shkarkuar nga impiantet industriale.

Përparim modest është bërë në fushën e *mbrojtjes së natyrës*. Në vitin 2010, edhe dy zona të tjera u shpallën zona të mbrojtura, duke rritur sipërfaqen e zonave të mbrojtura nga 12.57% në 13.17%. Nuk ka zhvillime të raportuara për transpozimin dhe zbatimin e legjislacionit të BE-së për natyrën dhe as për përgatitjet për krijimin e rrjetit NATURA 2000.

Disa përparime janë arritur në fushën e *kontrollit të ndotjes industriale dhe menaxhimit të riskut*. Transpozimi i Direktivës për Kontrollin dhe Parandalimin e Integruar të Ndotjes dhe i Direktivës për Impiantet e Mëdha të Djegies ka përparuar me miratimin e Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit.

Nuk ka përparim të raportuar në lidhje me politikat e *ndotjes akustike*.

Janë bërë disa përparime në lidhje me *mbrojtjen civile*, ku Shqipëria me mbështetjen e disa donatorëve po punon për vendosjen e një numri qendror emergjencash, si edhe për masat e parandalimit dhe kontrollit të përmytjeve.

Përsa i përket **ndryshimeve klimatike**, Shqipëria ka bërë përparim të kufizuar në zhvillimin e politikës së përgjithshme. Shqipëria nuk ka një Strategji kombëtare për ndryshimet klimatike për të adresuar sfidat e zbutjes dhe adaptimit me ndryshimet klimatike. Ndërgjegjësimi për klimën është i dobët në të gjitha nivelet.

Në rrafshin ndërkombëtar, Shqipëria e mbështet Marrëveshjen e Kopenhagenit, por nuk ka marrë përsipër zotime për pakësimin e shkarkimeve të gazeve serrë (GHG). Shqipëria po përgatit Komunikatën e tretë Kombëtare për Konventën e OKB-së për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC). Shqipëria nuk iu bashkua qëndrimin të BE-së në seancën e 16-të të Grupit të Punës *ad hoc* për Angazhimet e Mëtejshme në kuadër të Protokollit të Kiotos dhe në seancën e 14-të të Grupit të Punës *ad hoc* për Aksionin Bashkëpunues Afatgjatë në kuadrin e UNFCCC-së. Shqipëria vazhdon të zbatojë Protokollin e Montrealit për substancat që hollojnë shtrezën e ozonit, por duhen bërë hapa të mëtejshëm për të harmonizuar

legjislacionin e BE-së. Vendi ka marrë pjesë në mënyrë aktive në çështjet klimatike në kuadrin e Rrjetit Mjedisor Rajonal për Aderim.

Shqipëria është në fazë shumë të hershme për sa i përket përgatitjes dhe miratimit të *acquis* për ndryshimet klimatike, ndërkohë që qeveria po kryen analiza boshllëqesh. Nuk janë bërë hapa konkretë për të marrë përsipër një zotim për pakësimin/kufizimin e gazeve serrë (GHG) me qëllim zbatimin e *acquis*, sidomos të Skemës së Shkëmbimit të Shkarkimeve të BE-së, si edhe për t'iu bashkuar nismës së BE-së për Ndarjen e Përpjekjeve (*Effort-Sharing*). Për më tepër, kërkohen përpjekje për të arritur konvergencën me Vendimin e BE-së për Mekanizmin Monitorues.

Për sa i përket **kapaciteteve administrative**, në Ministrinë e Mjedisit është krijuar Sektori i Ujit, Ajrit dhe Ndryshimeve Klimatike, ku një punonjës merret me çështjet e ndryshimeve klimatike. Ekziston një sistem për inspektimet dhe lejet mjedisore. Megjithatë, sistemi nuk përmbush kërkesat e *acquis*. Kapacitetet administrative, si edhe burimet teknike dhe financiare për harmonizimin me *acquis* dhe zbatimin e politikës dhe legjislacionit të BE-së për mjedisin dhe ndryshimet klimatike, mbeten të dobëta.

Përfundim

Në tërësi, ka pasur përparim të pakët në zhvillimet legjislative dhe harmonizimin e legjislacionit mjedisor me *acquis*. Zbatimi dhe sundimi i ligjit duhet të përmirësohet në të gjithë sektorët. Në lidhje me ndryshimet klimatike, harmonizimi nuk ka përparuar dhe duhen përpjekje të mëtejshme për të forcuar kapacitetet administrative. Mungesa e ndërgjegjësimit publik dhe moskonsultimi i duhur i nismave legjislative pengojnë transparencën dhe sundimin e ligjit. Bashkëpunimi ndërinstitucional për mbrojtjen e mjedisit dhe çështjet e ndryshimeve klimatike mbetet i dobët. Integrimi i aspekteve mjedisore në të gjithë sektorët e tjerë, duke përfshirë një procesi vlerësimi të shëndoshë mjedisor në nivel strategjik dhe nivel projekti, mbetet i dobët. Përgatitjet në fushën e mjedisit janë akoma në një fazë të hershme, ndërsa përgatitjet në fushën e ndryshimeve klimatike janë në fazë shumë të hershme.

4.28. Kapitulli 28: Mbrojtja e konsumatorit dhe e shëndetit

Janë bërë disa përparime në fushën e **mbrojtjes së konsumatorit**. Janë përcaktuar kriteret për organizimin dhe funksionimin e qendrave të këshillimit të konsumatorëve nga shoqatat e konsumatorit, ndërsa Banka e Shqipërisë ka marrë vendime për transparencën e produkteve dhe shërbimeve bankare dhe financiare, si edhe për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekare. Për sa i përket zbatimit të ligjit, Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve (KMK) ka vlerësuar rastet e shkeljeve potenciale dhe ka vendosur sanksione administrative. Operatorët kanë zbatuar shumicën e vendimeve të KMK-së dhe kjo e fundit është informuar për pagimin e gjobave.

Në fushën e *sigurisë ushqimore*, Ligji për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore që përaftron dispozitat përkatëse të Direktivës për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve, po diskutohet në parlament. Për sa i përket *mungesës së sigurisë*, Ligji për mbrojtjen e konsumatorit është ndryshuar me qëllim që të rregullohen aspekte të caktuara të mbrojtjes së konsumatorit, të përforcohet pavarësia dhe asnjësia e Komisionit për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe të rritet niveli i gjobave.

Janë bërë disa përparime në fushën e **shëndetit publik**. Është miratuar Ligji për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, me synim përmirësimin e standardeve të financimit të shëndetësisë.

Disa përmirësime janë bërë në fushën e *duhanit*. Instituti i Shëndetit Publik (IShP) organizoi një fushatë ndërgjegjësimi dhe janë përgatitur programe trajnimi për mjekët e familjes. Në Autoritetin Shëndetësor Rajonal në Tiranë është krijuar një shërbim i ri për të inkurajuar njerëzit që të lënë duhanin dhe për të këshilluar përdoruesit e alkoolit mbi rreziqet dhe dëmet e alkoolit. Ligji aktual që ndalon duhanpirjen në mjedisi publike nuk po zbatohet plotësisht.

Përparim i mirë është bërë me *sëmundjet ngjitëse*. Imunizimi me vaksinim pneumokokal ka filluar dhe synon të ulë infeksionet te fëmijët dhe vdekshmërinë foshnjore. Janë organizuar dy seminare për të prezantuar vaksinat ndaj HPV dhe Rotavirus dhe janë përgatitur planet përkatëse të veprimtimit. Pediatri, epidemiologët dhe doktorët e tjerë në mbarë vendin janë trajnuar për vaksinat e reja. Programi dhe databaza e regjistrimit kombëtar elektronik të vaksinimit janë përgatitur, përfshi mbulimin me vaksinim, menaxhimin e stokut dhe reaksionet anësore. Është përforcuar Laboratori i Gripit dhe është përgatitur plani për vaksinimin e grupeve të riskut kundër gripit. Mikrobiologët shqiptarë janë trajnuar për biosigurinë dhe biosigurimin. Në tetor 2010, Instituti i Shëndetit Publik përgatiti udhëzime për kontrollin e infeksioneve spitalore.

Për sa i përket zbatimit të *Rregullores Ndërkombëtare të Shëndetit (RrNSh)*, Instituti i Shëndetit Publik është caktuar pikë fokale dhe institucion koordinues. Në mbarë vendin, epidemiologët, mjekët dhe profesionistët e shëndetit publik janë trajnuar për emergjencat dhe RrNSh. Pritet miratimi i akteve nënligjore për t'iu garantuar të drejtën e shëndetit personave dhe fëmijëve me HIV/AIDS dhe personave në rrezik.

Është miratuar Ligji për transplantimin e *indeve, të qelizave dhe të organeve*, që synon të garantojë standardet e cilësisë dhe sigurisë gjatë transplanteve.

Përparim është bërë në fushën e *shëndetit mendor*. Janë forcuar kapacitetet administrative me ngritjen e njësive të specializuara në të gjitha drejtoritë rajonale të shëndetit.

Janë ngritur disa qendra rezidenciale dhe qendra ditore plotësisht funksionale në Tiranë, Shkodër e Vlorë, dhe kujdesi institucional i shëndetit mendor është përmirësuar. Trajnimi i doktorëve të përgjithshëm për shëndetin mendor po vazhdon. Megjithatë, nevojitet më tepër personel i kualifikuar dhe burimeve financiare për të garantuar shërbime komunitare të shëndetit mendor me cilësi të lartë dhe të fokusuar në riaftësim.

Pavarësisht një sërë masash lehtësuese, *pabarazia e shëndetit* vazhdon. Autoritetet shëndetësore në Tiranë kanë mbështetur aktivitetet e imunizimit, përfshi shkuarjen derë më derë për fëmijët dhe familjet rome, kanë mbështetur zhvillimin e kapaciteteve të ofruesve të kujdesit shëndetësor me qëllim që kategoritë vulnerabël të imunizohen, si edhe shërbimet e kujdesit shëndetësor për fëmijët. Megjithatë, mungojnë të dhëna të besueshme për sa i përket kujdesit shëndetësor për lindjet e foshnjave rome dhe lindjet e nënave rome që ushqejnë fëmijët me gji. Jo të gjitha kategoritë kanë akses në kujdesin shëndetësor parësor në përgjithësi, sidomos grupet e marginalizuara dhe të rinjtë (të rinjtë e infektuar me HIV/AIDS, të rinjtë përdorues të drogës dhe minoriteti rom).

Është hartuar Strategjia kombëtare për parandalimin dhe kontrollin e *kancerit*, e cila është konsultuar me të gjithë aktorët kryesorë të përfshirë në luftën kundër kancerit. ISHP ka kryer aktivitete në fushën e vlerësimit të nevojave për kujdes shëndetësor parësor, krijimin e hartës së shërbimeve, forcimin e sektorëve të shëndetit publik në nivel vendor për të përfshirë shëndetin riprodhues, kancerin dhe materialet ndërgjegjësuese. Është miratuar Strategjia kombëtare për parandalimin dhe minimizimin e dëmeve nga *alkooli* dhe plani i veprimit 2011-2015. Klinika për trajtimin e varësisë alkoolike ka filluar të ofrojë shërbime terapeutike dhe qendra e parë e trajtimit të të alkoolizuarve është hapur në Tiranë. Profesionistët shqiptarë që merren me trajtimin e varësisë janë trajnuar për reduktimin e kërkesës për *drogë*. Përveç publikimit të raportit kombëtar për drogat, është riaktivizuar qendra informative kombëtare për drogën.

Përfundim

Në tërësi, janë bërë disa përpertime në përafrimin me *acquis* dhe forcimin e mbrojtjes së konsumatorit, si edhe në fushën e shëndetit publik, sidomos në lidhje me sëmundjet ngjitëse dhe infrastrukturën e shëndetit mendor. Në përgjithësi, Shqipëria duhet të vazhdojë përpjekjet për forcimin e kapaciteteve dhe zbatimin e ligjit, si edhe për përafrimin e legjislacionit të këtyre dy fushave me *acquis*. Në fushën e shëndetit mendor, kërkohen përpjekje të mëtejshme për të forcuar masat kundër duhanit dhe për të adresuar pabarazitë shëndetësore.

4.29. Kapitulli 29: Bashkimi doganor

Janë bërë përpertime në **legjislacionin doganor**. Shqipëria miratoi tarifat doganore për vitin 2011 në linjë me detyrimet e MSA-së dhe me ndryshimet e Nomenklaturës së Kombinuar të BE-së. Përgatitjet për aderimin në Konventën e Sistemit të Harmonizuar po vazhdojnë. Megjithatë, kodi doganor dhe dispozitat zbatuese të tij nuk janë ende në linjë me legjislacionin e BE-së. Janë përmirësuar procedurat për zhdoganimin e mallrave të udhëtarëve, por duhen përpjekje të mëtejshme për të thjeshtuar procedurat dhe për të lehtësuar tregtinë, përfshi futjen e konceptit të operatorit të autorizuar. Drejtoria për Mbrojtjen e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale (DPI) ka nisur veprimtarinë e saj dhe ka përgatitur dhe publikuar një manual dhe udhëzimet për mbrojtjen e DPI-së. Megjithatë, zbatimi i ligjit për DPI mbetet i mangët dhe kapacitetet në këtë fushë janë të dobëta.

Përdorimi i metodës transaksion në vlerësimin doganor u rrit në 85%, por duhen bërë përpjekje të mëtejshme për të ulur përdorimin e çmimeve të referencës.

Janë bërë disa përparime në lidhje me **kapacitetet administrative dhe operacionale**. Bashkëpunimi ndërinstytucional është përmirësuar, sidomos bashkëpunimi me policinë për automjetet e vjedhura si dhe me agjencinë kombëtare për vendet eksportuese në lidhje me mallrat me përdorim të dyfishtë. Është realizuar shkëmbimi i informacionit me vendet fqinje përmes Sistemit të Shkëmbimit Elektronik Sistemik të të Dhënave (SEEDS). Janë bërë disa përmirësime në Teknologjia e Informacionit (TI) me rritjen e kapacitetit të sistemit Asycuda World si dhe me blerjen e serverëve për ngritjen e një qendre të re operative. Megjithatë, kërkohen ende përpjekje për ta sjellë sistemin TI në përputhje të plotë me kërkesat e BE-. Infrastruktura në pikat e kalimit kufitar është përmirësuar, por kërkohen përpjekje të mëtejshme në këtë drejtim. Ka pasur një shtim të lehtë të inspektimeve në ambientet e operatorëve ekonomikë, por ekziston nevoja për zhvillim sistematik të kontrolleve pas-zhdoganimit.

Janë krijuar dy drejtori të reja: një drejtori për borxhin dhe anti-kontrabandën dhe tjetra për hetimin e brendshëm dhe anti-korrupsionin. Drejtorja e Përgjithshme e Doganave ka miratuar një Plan Integriteti dhe personeli është trajnuar për etikën, por duhen bërë përpjekje të mëtejshme, pasi perceptimi i publikut për korrupsionin në administratën doganore është ende i lartë. Plani i Menaxhimit të Ndryshimeve në Biznes ende nuk është miratuar. Duhet përpjekje të mëtejshme në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore për rritjen e transparencës si dhe për të krijuar një sistem vlerësimi zyrtar. Nuk ka pasur përparim përse i përket dhënies së statusit të nëpunësit civil punonjësve të administratës doganore. Qendra e Trajnimit e Administratës Tatimore dhe Doganore (Akademia) ende nuk ka filluar punën, gjë që pengon aktivitetet trajnuese. Forcimi i kapaciteteve të 'inteligjencës' kërkon vëmendje të mëtejshme. Profilet e riskut janë përditësuar dhe përqindja e kontrolleve fizike ka rënë nga 14% në 13%. Megjithatë, duhet përcaktuar më mirë objektivat për profilet e riskut, të përmirësohen kontrollet me bazë rrisht dhe të thjeshtohen procedurat e aplikuar për të lehtësuar tregtinë e ligjshme duke pakësuar inspektimet fizike. Vazhdon puna për zbatimin e planit të zhvillimit për Laboratorin Doganor.

Përfundim

Janë bërë disa përparime në fushën e bashkimit doganor. Zhvillime pozitive raportohen në lidhje me harmonizimin legjislativ dhe kapacitetet administrative, sidomos me kapacitetet operative dhe TI. Megjithatë, kërkohen përpjekje për përafrimin e standardeve të BE-së, përfshi vlerësimin dhe përdorimin e procedurave të thjeshtuara dhe lehtësimin e tregtisë. Kapacitetet e zbatimit të ligjit dhe menaxhimi i burimeve njerëzore mbeten të pamjaftueshme dhe sistemet TI nuk janë plotësisht në përputhje me kërkesat e BE-së. Në tërësi, përgatitjet në këtë fushë kanë avancuar në masë të moderuar.

4.30. Kapitulli 30: Marrëdhëniet me jashtë

Ka pasur disa përparime në përafrimin me *acquis* në fushën e **politikës së përbashkët tregtare**. Shqipëria vazhdoi të zvogëlojë tarifat doganore në përputhje me dispozitat e MSA-së dhe më 1 janar u arrit liberalizimi i plotë.

Në përgjithësi, vendi ka vazhduar të koordinohet me Komisionin Europian dhe të përafrojë politikat dhe qëndrimet me ato të BE-së për vendet e treta dhe me ato të organizmave ndërkombëtare, në veçanti me Organizatën Botërore të Tregtisë. Përparim i mirë është bërë në zbatimin e angazhimeve të OBT-së.

Nuk ka pasur zhvillime të veçanta për të raportuar përvoja të përket *kredive të eksportit*. Shqipëria ka bërë përparim në përafrimin e *acquis* me miratimin në muajin shkurt, të legjislacionit për zbatimin e plotë të listës së teknologjive dhe *mallrave me përdorim të dyfishtë*. Përparim modest është arritur në forcimin e burimeve njerëzore dhe kapaciteteve administrative në fushën e politikës tregtare. Zbatimi i planit të trajnimit për politikat tregtare dhe Politikën e Përbashkët Tregtare të BE-së ka mbetur mbrapa krahasuar me afatet e përcaktuara.

Përvoja të përket **marrëveshjeve dypalëshe me vendet e treta**, Shqipëria ratifikoi protokollin shtesë për liberalizimin e plotë të tregtisë së produkteve bujqësore në kuadër të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA). Për Shqipërinë në nëntor 2010 hyri në fuqi marrëveshje e tregtisë së lirë me EFTA-n. Në qershor 2011, Shqipëria nënshkroi konventën Pan-Euro-Med për akumulimin diagonal të rregullave të origjinës. Në gusht hyri në fuqi kumulimi diagonal i rregullave të origjinës me Turqinë.

Nuk ka progres për të raportuar në **politikën e zhvillimit** dhe **ndihmës humanitare**.

Përfundim

Ka pasur disa përparime në fushën e marrëdhënieve me jashtë. Shqipëria nënshkroi Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë me EFTA-n dhe ajo luan një rol konstruktiv dhe aktiv brenda CEFTA-s. Shqipëria i koordinon qëndrimet e saj në OBT me ato të BE-së. Kapacitetet institucionale në marrëdhëniet me jashtë mbeten të pamjaftueshme. Në tërësi, përgatitjet në këtë fushë kanë avancuar në masë të moderuar.

4.31. Kapitulli 31: Politika e jashtme, e sigurisë dhe e mbrojtjes

Dialogu politik konstant ndërmjet BE-së dhe Shqipërisë ka vazhduar të mbulojë çështjet e politikës së jashtme. (*Për marrëdhëniet e fqinjësisë me vendet e tjera aspirante dhe Shtetet anëtare, shikoni seksionin 2.3 të Kriteri Politik*).

Për sa i përket **politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë (PPJS)**, Shqipëria gjatë periudhës raportuese ka mbajtur qëndrim të njëjtë, kur i është kërkuar, me 64 nga 67 deklaratave të BE-së dhe vendimeve të Këshillit (95% harmonizim).

Në lidhje me *masat kufizuese*, Shqipëria ka bërë harmonizimin me shumicën e masave kufizuese të paraqitura nga Vendimet e Këshillit

Nuk ka zhvillime të raportuara për sa i përket *parandalimin e konfliktit*.

Në lidhje me *mospërhapjen*, Shqipëria ka avancuar me përafrimin e *acquis* duke miratuar legjislacion në shkurt që mundëson zbatimin e plotë të listës së teknologjive dhe mallrave me përdorim të dyfishtë. Shqipëria aktualisht mban Presidencën e “Konventës së OKB-së për ndalimin e përdorimit, magazinimit, prodhimit dhe transferimit të minave anti-njeri dhe për shkatërrimin e tyre”. Për sa i përket *armëve të vogla dhe të lehta*, nuk raportohen zhvillime. Puna vazhdon për krijimin e regjistrimit *online* për armët dhe municionet nën administrimin e Policisë së Shtetit. Qeveria miratoi Planin e Veprimit për eliminimin e municioneve të tepërta të Forcave të Armatosura të Shqipërisë.

Shqipëria vazhdoi të *bashkëpunojë në mënyrë aktive me organizatat ndërkombëtare* (OKB, OSBE, Këshilli i Europës, etj.). Shqipëria mbajti deri në maj Presidencën e MARRI-t (Nisma Rajonale për Migracionin, Azilin dhe Refugjatët) deri në maj.

Për *masat e sigurisë*, Shqipëria ende nuk ka lidhur një marrëveshje sigurie me BE-së për shkëmbimin dhe mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar.

Shqipëria po tregon angazhim të vazhdueshëm me pjesëmarrjen *në operacionet ushtarake dhe të menaxhimit të krizave civile*, në kuadrin e **politikës së përbashkët të sigurisë dhe mbrojtjes**. Shqipëria vazhdoi të marrë pjesë në misionin EUFOR/Althea në Bosnjë-Hercegovinë (71 vetë personel ushtarak dhe 11 vetë xhenierë dhe eliminim eksplozivi). Në fund të vitit 2010, Shqipëria finalizoi pjesëmarrjen në operacionin BE NAVFOR-Atalanta në Somali.

Përfundim

Shqipëria ka bërë përparim në marrëdhëniet dypalëshe dhe shumëpalëshe dhe po përparon me harmonizimin legjislativ me *acquis* në fushën e politikës së përbashkët të sigurisë dhe mbrojtjes. *Në tërësi*, përgatitjet në këtë fushë janë të konsoliduara mirë.

4.32. Kapitulli 32: Kontrolli financiar

Përparim i mirë është bërë në fushën e **kontrollit të brendshëm financiar publik** (KBFP). Është krijuar kuadri ligjor bazë për KBFP si dhe funksionon inspektimi i centralizuar buxhetor. Ligji për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) si dhe ndryshimet në Ligjin për Auditimin e Brendshëm hynë në fuqi në fillim të vitit 2011. Aktet nënligjore po

përgatiten. Po ashtu, Ligji për Inspektimin Financiar hyri në fuqi në fillim të vitit 2011. Krijimi i Drejtorisë së Inspektimit Financiar Publik pranë Ministrisë së Financave si dhe rekrutimi i inspektorëve financiarë publikë *ad-hoc* është në proces.

Zbatimi i MFK-së është ende në fazë të hershme. Njësia Qendrore e Harmonizimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (NjQH/MFK), me mbështetjen e ekspertëve, ka përgatitur një plan zbatimi të MFK-së në sektorin publik. Janë organizuar disa seminare rajonale informimi dhe sensibilizimi për konceptet e reja të MFK-së. Nevojiten nisma të mëtejshme të nivelit të lartë për sensibilizimin e drejtuesve dhe trajnime për nëpunësit civilë në lidhje me zbatimin e KBFP-së. Duhet bërë përpjekje për të forcuar kapacitetet administrative të auditimit të brendshëm, përdorimin e metodologjive të ndryshme të auditimit si dhe të ndjekjen nga niveli drejtues i gjetjeve të auditimit.

Përparim është bërë në fushën e **auditimit të jashtëm**. Ndryshimet në Ligjin për Kontrollin e Lartë të Shtetit (KLSH) për ta harmonizuar plotësisht me standardet INTOSAI janë duke u përgatitur. KLSH po zhvendos gradualisht natyrën e punës nga auditimi i tipit inspektues, në auditim financiar dhe të performancës në linjë me standardet INTOSAI. Është përgatitur plani i trajnimit për punonjësit e KLSH-së për vitin 2011 dhe janë organizuar disa trajnime. Nevojiten përmirësime të mëtejshme në lidhje me raportimin në Parlament dhe me efektivitetin e ndjekjes nga ana e Parlamentit e raporteve audituese të KLSH-së.

Shumë pak përparime janë bërë për sa i përket **mbrojtjes së interesave financiare të BE-së**. Drejtoria e Inspektimit Financiar Publik e krijuar me VKM të shkurtit 2011, do të veprojë njëherësh si Shërbimi i Koordinimit kundër Mashtrimit dhe si pikë kontakti me Zyrën Europiane Kundër Mashtrimit.

Për sa i përket **mbrojtjes së euros nga falsifikimi**, autoritetet shqiptare vazhdojnë të bashkëpunojnë me OLAF (Zyra Europiane kundër Mashtrimit), duke marrë pjesë në mënyrë aktive në programin Pericles. Në veçanti, ata organizuan “Konferencën e Europës Juglindore 2010” në Tiranë dhe morën pjesë në një takim me ECEG (Grupi i Ekspertëve kundër Falsifikimit të Euros) në Bruksel.

Përfundimi

Në tërësi, janë bërë përparime në fushën e KBFP-së dhe në auditimin e jashtëm. Nevojiten përpjekje të mëdha për forcimin e kapaciteteve administrative të të gjitha institucioneve përgjegjëse për kontrollin të brendshëm. Mbeten të miratohen ndryshimet në Ligjin e KLSH-së për ta sjellë kuadrin ligjor plotësisht në linjë me standardet INTOSAI. Përparim i kufizuar është bërë në fushat që kanë të bëjnë me mbrojtjen e interesave financiare të BE-së.

4.33. Kapitulli 33: Dispozitat financiare dhe buxhetore

Nuk ka pasur zhvillime të rëndësishme në lidhje me **burimet vetjake tradicionale, burimet e TVSH-së dhe burimet GNI (të ardhurat kombëtare bruto)**. Për përparimin në fushat e tyre,

shikoni kapitujt 16 - *Tatimet*, 18 - *Statistikat*, 29 - *Bashkimi Doganor* dhe 32 - *Kontrulli financiar*.

Për sa i përket **infrastrukturës administrative**, janë ngritur institucionet në fushat përkatëse që ndikojnë tërthorazi në sistemin e burimeve vetjake. Megjithatë, përveç forcimit të mëtejshëm të këtyre institucioneve, kërkohet një strukturë koordinuese plotësisht funksionale që të sigurojë llogaritjen e saktë, parashikimin, mbledhjen, pagimin, kontrollin e burimeve vetjake si dhe raportimin në BE në lidhje me zbatimin e rregullave për burimet vetjake.

Përfundimi

Në këtë kapitull nuk ka përparim të veçantë për të raportuar. Në tërësi, nuk ka divergjenca domethënëse ndërmjet sistemit shqiptar dhe sistemit të BE-së për sa i përket parimeve bazë dhe institucioneve në fushat përkatëse që ndikojnë në zbatimin e saktë të rregullave për burimet vetjake. Në momentin e duhur, duhet të ngrihet një organ koordinues që të strukturojë dhe të drejtojë përgatitjet e para-anëtarësimit në fushën e burimeve vetjake.

Shtojca Statistike

TË DHËNA STATISTIKORE (më 30.09.2011)

Shqipëria

Të dhëna bazë	Shënim	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Popullsia (në mijë)		3 058	3 063	3 084	3 103	3 120	3 135	3 149	3 153	3 170	3 185	:
Sipërfaqja totale (km ²)		28 750	28 750	28 750	28 750	28 750	28 750	28 750	28 750	28 750	28 750	28 750
Llogaritë Kombëtare												
Llogaritë Kombëtare	Shënim	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) (milion ALL)		523 043	583 369	622 711	694 098	751 022	814 797	882 209	967 670	1 089 293	1 151 020p	:
PBB (milion euro)		3 945	4 541	4 705	5 048	5 883	6 561	7 168	7 828	8 8870	8 716e	:
PBB (euro për frymë)		1 289	1 477	1 521	1 622	1 881	2 088	2 275	2 476	2 788	2 728p	:
PBB (sipas Fuqisë Blerëse për frymë (FBS)		:	:	:	:	:	5 000	5 500	5 800	6 500	6 500	:
PBB në Fuqi Blerëse për Frymë (BE-27 = 100)		:	:	:	:	:	22	23	23	26	28	:
Rritja reale e PBB-së (norma e rritjes së vëllimit të PBB-së, ALL, % ndryshim nga viti i kaluar		6.7	7.9	4.2	5.8	5.7	5.7	5.4	5.9	7.5	3.3p	3.9p
Rritja e Punësimit (llogaritë kombëtare, % ndryshim nga viti i kaluar)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Rritja e Prodhueshmërisë së Punës: rritja e PBB për person të punësuar (ndryshim në % nga viti i kaluar)		8.0	30.3	7.7	7.6	10.8	8.1	7.8	-9.4	19.0	4.4	:
Rritja e kostos për njësi punë (llogaritë kombëtare, %ndryshim nga viti i kaluar)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Prodhueshmëria e Punës (PBB në Fuqi Blerëse për person të punësuar, BE-27 = 100)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Vlera bruto e shtuar nga sektorët kryesorë (%)												
Bujqësia dhe peshkimi		25.5	23.6	23.4	23.5	22.3	20.6	19.4	19.0	18.7	18.8	:
Industria		7.8	7.3	6.9	8.7	10	10.6	11.1	9.4	9.8	9.9	:
Ndërtimi		8.3	10.4	12.0	13.7	13.9	13.8	14.3	14.8	14.9	14.2	:
Shërbimet		58.5	58.6	57.6	54.0	53.8	55.0	55.2	56.8	56.6	57.1	:
Shpenzimet e Konsumit Final, si përqindje e PBB-së (%)		86.0	80.9	86.0	86.1	89.0	88.9	87.4	90.4	89.5	:	:
Formacioni i kapitalit fiks bruto, si përqindje e PBB-së (%)		31.7	38.4	37.9	40.5	37.2	37.0	39.0	38.7	38.1	:	:
Ndryshime në inventarë, si përqindje e PBB-së (%)		2.4	1.3	0.8	-1.8	-3.8	-1.2	-2.8	-2.4	-0.9	:	:

Eksportet e mallrave dhe shërbimeve, kundrejt PBB (%)		17.9	18.4	19.6	20.4	22.0	22.8	24.9	28.1	29.4	:	
Importet e mallrave dhe shërbimeve, kundrejt PBB (%)		38.1	39.0	44.3	45.1	44.4	47.5	48.5	54.8	56.0	:	

Industria	Shënim	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Indeksi i vëllimit të prodhimit industrial (2000=100)		:	:	:	98.2	100.2	100.0	104.4	90.8	117.9	116.5	139.6

Norma e Inflacionit	Shënim	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Indeksi i Çmimit të Konsumit (CPI), % ndryshim nga viti paraardhës)		4.2	3.5	1.7	3.3	2.2	2.0	2.5	3.1	2.2	2.3	3.6

Bilanci i pagesave	Shënim	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Bilanci i pagesave: totali i llogarive korrente (milion euro)		-185	-316	-444	-350	-340	-589	-471	-831	-1 370	-1 346	-1 056
Llogaria korrente e bilancit të pagesave: bilanci tregtar (milion euro)		-897	-1 149	-1 218	-1 177	-1 277	-1 477	-1 659	-2 104	-2 431	-2 304	-2 083
Llogaria korrente e bilancit të pagesave: shërbimet neto (milion euro)		12	100	-8	-72	-41	-140	-32	13	69	121	182
Llogaria korrente e bilancit të pagesave: të ardhura neto (milion euro)		115	150	116	132	138	131	209	217	55	-101	-77
Llogaria korrente e bilancit të pagesave: transfera korrente neto (milion euro)		586	583	667	767	839	897	1 011	1 043	937	938	922
nga këto transfera qeveritare (milion euro)		105	31	41	53	61	61	43	60	31	27	45
Investime të Huaja Direkte neto (IHD) (milion euro)		157	231	141	157	267	209	250	470	620	680	818
Investime të Huaja Direkte (IHD) jashtë shtetit (milion euro)		0	0	0	0	-11	-3	-8	-11	-55	-26	-10
nga këto IHD nga ekonomia raportuese e BE-27 (milion euro)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Investimet të Huaja Direkte (IHD) në ekonominë raportuese (milion euro)		157	231	141	157	278	213	259	481	675	706	827
nga këto IHD të BE-27 në ekonominë raportuese (milion euro)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	

Financat Publike	Shënim	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Deficiti qeveritar/teprica, kundrejt PBB (%)		-7.6	-6.9	-6.1	-4.9	-5.1	-3.5	-3.3	-3.5	-5.5	-7.0	-3.0
Borxhi qeveritar, kundrejt PBB (%)		60.2	58.5	63.9	61.5	58.3	56.8	56.8	54.8	53.9	:	:
Treguesit Financiarë	Shënim	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010

Borxhi i huaj bruto i ekonomisë, kundrejt PBB (%)		17	17.2	22.1	25.1	23.4	25.1	26.2	26.7	34.8	38.3	41.4
Borxhi i huaj bruto i ekonomisë, kundrejt eksportit total (%)	1)	94.9	93.1	112.5	103.5	106.0	110.0	105.0	95.0	118.0	134.0	128.0
Oferta e parasë: M1 (kartëmonedha, monedhat, depozitat ditore, (milion euro)		936	1 113	1 102	1 033	1 332	1 801	1 969	1 963	2 303	2 154	1 999
Oferta e parasë: M2 (M1 plus depozitat me maturim deri 2 vjet, mln euro)		1 995	2 376	2 430	2 555	3 080	3 434	3 879	4 094	4 520	4 378	4 387
Oferta e parasë: M3 (M2 plus instrumentet e tregtueshme , milion euro)		2 475	3 069	3 083	3 225	3 942	4 614	5 415	6 129	6 643	6 599	7 114
Kreditimi total i institucioneve financiare monetare për banorët rezidentë (konsoliduar) (milion euro)		175	217	302	381	566	1 007	1 590	2 377	3 227	3 335	3 506
Normat e interesit: norma ditore e parasë, bazë vjetore (%)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Normat e interesit e huadhënies (një vit), bazë vjetore (%)	2)	24.0	11.9	15.0	12.2	15.5	12.4	12.9	11.7	11.8	12.5	11.3
Normat e interesit të depozitave (një vit), bazë vjetore (%)	3)	8.0	7.8	8.5	8.3	6.6	5.1	5.2	5.7	6.9	6.8	6.4
Kursi i këmbimit mesatar vjetor - 1 euro = ... lek		132.580	128.470	132.360	137.510	127.670	124.190	123.080	123.620	122.800	132.060	137.790
Indeksi efektiv i kursit të shkëmbimit (2000=100)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	
Vlerat e aktiveve në rezerva (përfshi arin) (milion euro)		654	834	800	800	1 024	1 209	1 368	1 477	1 694	1 650	1 904
Tregtia me jashtë												
	Shënim	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Vlera e importeve: të gjithë mallrat, tërë partnerët (në milion euro)		1179.6	1485.7	1590.2	1648.1	1849.2	2101.4	2435.0	3065.0	3569.4	3260.7	3471.7
Vlera e eksporteve: të gjithë mallrat, tërë partnerët (në milion euro)		283.1	340.5	349.2	395.4	484.5	529.1	631.3	786.3	921.1	779.8	1169.2
Bilanci tregtar: të gjithë mallrat, tërë partnerët (milion euro)		-896.5	-1145.3	-1240.9	-1252.7	-1364.7	-1572.3	-1803.7	-2278.8	-2648.3	-2480.9	-2302.6
Termet tregtarë (indeksi i çmimit të eksporteve / importeve),		100.2	101.5	99.9	98.2	99.0	80.3	100.6	98.1	96.0	97.6	98.4
Përqindja e eksportit me BE-27 si përqindje e eksporteve totale (%)		93.1	91.2	92.7	93.8	90.9	89.4	88.6	83.1	79.7	84.7	70.0
Përqindja e importit nga BE-27 si përqindje e importeve totale (%)		80.6	80.3	77.0	74.3	70.5	67.2	65.5	59.9	60.7	64.9	64.6
Demografia												
	Shënim	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Rritja natyrale: ndryshimi natyral (lindje minus vdekje) (për 1000 banorë)		11.4	12.5	9.5	9.3	8.1	7.2	5.5	5.9	6.3	:	:
Vdekshmëria foshnjore: vdekjet e fëmijëve nën 1 vjeç në 1000 lindje gjallë		11.9	10.8	10.2	8.4	7.8	7.6	7.4	6.2	6.0	:	:
Jetëgjatësia: meshkuj (vite)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Jetëgjatësia: femra (vite)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Tregu i Punës												
	Shënim	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010

Popullsia (15-64): popullsia në moshë 15-64 (mijë)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Aktiviteti ekonomik (15-64): pjesa e pop. 15-64 vjeç ekonomikisht aktive (mijë)	4)	1283.3	1101.1b	1092.5	1089.3	1088.2	1085.4	1084.5	1373.1b	1271.4	1331.9	:
Punësimi (15-64): pjesa e popullsisë në moshë 15-64 e punësuar (mijë)	4)	1 068.2	920.6b	920.1	926.2	931.2	932.1	935.1	1 188.3b	1 103.5	1 147.8	:
Norma e aktivitetit ekonomik (15-64): % e popullsisë 15-64 vjeç ekonomikisht aktive	4)	66.2	62.1b	61.8	59.7	58.8	57.8	53.6	65.2b	61.9	61.9	:
Norma e punësimit (15-64): pjesa e popullsisë 15-64 vjeç të punësuar (%)	4)	55.1	51.9n	52.1	50.7	50.3	49.7	46.2	56.4b	53.8	53.4	:
Meshkuj të moshës (15-64) vjeç të punësuar (%)	4)	66	64.0b	63.9	62.6	61.2	60.0	58.8	63.6b	63.0	64.3	:
Femra të moshës (15-64) vjeç të punësuar (%)	4)	44.1	39.6b	39.7	39.1	38.9	38.8	38.1	49.3b	45.6	43.6	:
Përqindja e popullsisë në moshë më të madhe (55-64): pjesa e popullsisë e moshës 55-64 e punësuar %		:	:	:	:	:	:	:	46.6	44.0	48.9	:
Punësimi sipas sektorëve kryesorë (%)												
Bujqësia	4) 5)	71.8	57.7b	57.7	58.2	58.5	58.5	58	47.9	44.6	44.1	:
Industria	4) 5)	5.4	7.7b	7.6	7.2	8.1	7.9	8.0	10.4	9.3	10	:
Ndërtimi	4) 5)	1.2	6.1b	6.1	6.0	5.5	5.5	5.7	8.2	8.5	9.9	:
Shërbimet	4) 5)	21.5	28.5b	28.6	28.5	27.9	28.1	28.3	33.5	37.6	36.0	:
Papunësia: krahu i punës i papunë (%)	6)	16.8	16.4	15.8	15.0	14.4	14.1	13.8	13.5b	13.0	13.8	:
Meshkuj të papunë të krahut të punës (%)	6)	14.9	14.2	13.6	12.9	12.4	12.1	11.8	14.4b	12.5	12.2	:
Femra të papuna të krahut të punës (%)	6)	19.3	19.9	19.1	18.2	17.5	17.2	16.8	12.2b	13.5	15.9	:
Papunësia e personave < 25 vjeç: krahut të punës <25 i papunë (%)	6)	:	:	26.8	:	:	:	:	20.1b	27.2	27.2	:
Papunësia afat-gjatë: % e krahut të punës në papunësi për 12 muaj a më shumë (%)	6)	:	:	:	:	:	:	:	9.4b	8.5	9.1	:
Kohezioni Social												
	Shënim	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Rrogat mesatare mujore nominale (lek)		14 963.0	17 218.0	19 659.0	21 325.0	24 393.0	26 808.0	28 822.0	33 750.0	36 537.0	40 874.0	:
Indeksi i rrogave reale (indeksi i rrogave nominale pjesëtuar me CPI) (2000=100)		:	11.6	21.1	27.8	42.8	53.3	60.9	83.1	91.7	109.8	:
Braktisja e hershme e shkollës - pjesa e popullatës e moshës 18-24 vjeç që nuk ka përfunduar arsimin e mesëm dhe që aktualisht nuk merr arsimim ose formim profesional (%)		:	:	:	:	:	:	:	42.0	39.0	:	:

Standardi i jetesës	Shënim	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Numri i automjeteve për 1000 banorë		37.4	43.6	48.2	56.4	60.9	62.2	71.4	75.2	83.3	88.2	:
Numri i abonimeve në shërbimin celular për 1000 banorë		:	120.8	259.4	370.6	403.6	488.0	606.5	736.5	935.0	1 306.9	:
:												
Infrastruktura	Shënim	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Dendësia e rrjetit hekurudhor (linja në funksionim, për 1000 km ²)		13.9	14.3	15.0	15.0	15.0	15.1	15.0	13.9	13.9	13.9	13.9
Gjatësia e autostradave (mijëra km)		:	:	:	0.0	0.0	0.0	:	:	:	:	:
:												
Novacioni dhe kërkimi shkencor	Shënim	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Shpenzimet për burime njerëzore (shpenzimet publike për arsimin, në raport me PBB (%))		3.1	3.3	3.0	3.1	3.2	3.2	3.1	3.2	3.5	3.4	:
* Shpenzimet e brendshme bruto për kërkimin shkencor dhe zhvillimin, në raport me PBB (%))		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Përqindja e familjeve që kanë akses në internet në shtëpi (%)		:	:	:	:	:	1.5	:	:	3.4	:	:
:												
Mjedisi	Shënim	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
* Totali i shkarkimeve të gazeve serë, CO ₂ ekuivalent (tonë, 1990=100)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Intensiteti energjetik i ekonomisë (kg i ekuivalentit naftë për 1000 euro Pbb0)		400.5	386.5	356.3	370.6	384.0	366.5	328.9	306.6	:	:	:
Përqindja e energjisë së rinovueshme në konsumimin e energjisë elektrike (%)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Transport rrugor mallrash si përqindje e transportit total tokësor të mallrave (%) (% tonë-km)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
:												
Energjia	Shënim	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Prodhimi parësor i të gjithë produkteve të energjisë (mijë TOE (ekuivalenti i një Ton Naftë))		987	933	896	1 012	1 178	1 149	1 237	1 080	1 159	:	:
Prodhimi parësor i naftës së papërpunuar (mijë TOE)		314	335	308	359	443	418	500	564	578	:	:
Prodhimi parësor i antracitit dhe linjitit (mijë TOE)		20	15	5	19	19	15	15	15	20	:	:
Prodhimi parësor i gazit natyror (mijë TOE)		12	8	8	12	9	10	10	16	8	:	:

Importet neto të të gjitha produkteve të energjisë (mijë TOE)		858	1 001	965	1 043	1 080	1 130	826	1 020	1 033	:	:
Konsumimi i brendshëm bruto i energjisë (mijë TOE)		1 845	1 934	1 861	2 055	2 258	2 279	2 156	2 130	2 119	:	:
Prodhimi/gjenerimi i energjisë(mijë GWh)		4.7	3.7	3.2	4.9	5.5	5.5	5.6	3.0	3.9	5.2	
Bujqësia												
Indeksi i vëllimit të prodhimit bujqësor për mallrat dhe shërbimet (çmimet e prodhuesit, viti pararendës =100)	Shënim	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Sipërfaqja totale bujqësore e përdorur (mijëra hektarë)		1 144	1 139	1 140	1 121	1 122	1 077	1 120	1 121	1 146	1 164	:
Blegtori: gjedh (mijëra kokë, fundi i periudhës)		728	708	690	684	654	655	634e	577	541	494	493
Blegtori: derra (mijëra kokë, fundi i periudhës)		103	106	114	132	143	147	152e	147	161	160	164
Blegtori: bagëti të imta (mijëra kokë, fundi i periudhës)		3 045	2 933	2 773	2 919	2 739	2 701	2 770e	2 729	2 620	2 540	2 581
Prodhimi dhe përdorimi i qumështit në fermë (qumështi total, mijëra tonë)		948	984	1 010	1 060	1 064	1 076	1 102e	1 016	1 040	1 045	1 070
Prodhimi i të mbjellave: drithëra (përfshi orizin) (mijëra tonë, prodhimi i korrur)		566	503	519	489	499	511	508	494	609	:	662
Prodhim i të mbjellave: panxhar sheqeri (mijëra tonë, prodhim i korrur)		42	39	39	50	40	40	:	:	:	0	0
Prodhim i të mbjellave: perimet (mijëra tonë, prodhim i korrur)	7)	620	677	669	675	678	685	688	672	715	730	860

: = nuk ka

p = provizore

e = vlerë e llogaritur

b = thyerje ose ndërprerje në seri

* = tregues "Europe 2020"

Për IHD janë përdorur konvencionet e bilancit të pagesave. Për IHD jashtë shtetit, shenja minus do të thotë se investimi i bërë jashtë shtetit nga ekonomia raportuese e tejkaloj investimin e larguar në këtë periudhë, kurse një shifër pa shenjë do të thotë se largimi i investimeve tejkaloj investimet. Për IHD në ekonominë raportuese, një shifër pa shenjë do të thotë që investimet në ekonominë mbi të cilën raportohet tejkalojnë investimin larguar, ndërsa, një shenjë minus tregon që investimi i larguar tejkaloj investimet.

Fundshënime:

- 1) Disbursimi i Borxhit të Vonuar/pa paguar (DOD) rezervat kumulative përfshin borxhin publik të jashtëm dhe borxhin me garanci publike, por që nuk përfshin kreditë nga FMN. Eksportet totale janë llogaritur sipas koncepteve të llogarive kombëtare.
- 2) Normat mesatare e ponderuar për huat e reja 12-mujore në muajin përkatës, me maturim 12-mujor.
- 3) Normat e interesit të depozitave përfaqësojnë normën e ponderuar mesatare të depozitave të sapopranuara në muajin përkatës, me maturim 12-mujor.
- 4) Ndryshim i burimit të të dhënave administrative 2001-2006 (informacion vetëm për popullsinë meshkuj të moshës 15-59 dhe të popullsisë femra të moshës 15-54); nga 2007 e më pas të dhënat e Anketës së Fuqisë Punëtore.
- 5) Të dhënat janë dhënë sipas Nace rev 1.1.
- 6) Të dhëna administrative 2000-2006; të dhëna nga 2007 e më pas i referohen të dhënave të Anketës së Fuqisë Punëtore.
- 7) Përfshi shalqirin.